



RAPORT MONITORIMI JANAR – DHJETOR 2020

STRATEGJIA E DREJTËSISË PËR TË MITUR

www.drejtesia.gov.al

Tabela e Përmbajtjes

I. Informacion Përmbledhës mbi Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur 2018-2021 dhe Planit të Veprimit.	4
1.1 Hyrje	4
1.1 Metodologjia e monitorimit	8
II. Progresi i Strategjisë së Drejtësisë Për të Mitur	10
2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës	10
Marrëveshjet e bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkive në Republikën e Shqipërisë.	12
Kuadri infrastrukturor për të Miturit në konflikt me ligjin	13
2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritit evropian	15
2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit.....	16
2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit.....	20
III. Progresi i lidhur me objektivat strategjike dhe aktivitetet	20
3.1 Objektivi 1: Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi.	21
3.2 Objektivi 2: Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit.	24
3.3 Objektivi 3: Parandalimi i ri-përfshirjes të të miturve/të rinjve në krime.....	277
3.4 Objektivi 4: Rishoqërimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin.	29
3.5 Objektivi 5: Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të mitur.	32
3.6 Krahasim mbi Progresin e zbatimit të Planit të Veprimit për vitet 2019 dhe 2020	35
IV. Histori Sukesi dhe zbatimi i projekteve dhe programeve ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale për të mitur	39
Ndihma juridike për të miturit	39
Kuvendi për të miturit	42
Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit nga Kuvendi	42
Veprimtaria e Grupit të Deputetëve “Miq të Fëmijëve” gjatë vitit 2020	42
4.1 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit	57
4.2 Konkluzione dhe rekomandime	58
V. Risqet/Risku dhe hapat për tu adresuar	594
5.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit	59
5.2 Hapat e radhës.....	60

LISTA E SHKURTIMEVE

ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
AS	Akademia e Sigurisë
DAP	Departamenti i Administratës Publike
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
KLGI	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KDIMDHP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KKD	Komisioneri kundër Diskriminimit
KM	Këshilli i Ministrave
KSHB	Komiteti Shqiptar i Birësimeve
MD	Ministria e Drejtësisë
MB	Ministria e Brendshme
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
RSH	Republika e Shqipërisë
SHM	Shkolla e Magjistraturës
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PP	Prokuroria e Përgjithshme
UP	Urdhri i Psikologut
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave

I. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI STRATEGJINË E DREJTËSISË PËR TË MITUR 2018-2021 DHE PLANIT TË VEPRIMIT.

1.1 Hyrje

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve është një ndër prioritetet kyçe të Ministrisë së Drejtësisë, e jetësuar në Programin e Qeverisë Shqiptare nën objektivin madhor: *“Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin, duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale”*.

Ministria e Drejtësisë, mbështetur në kuadrin ligjor vendës dhe ndërkombëtar që rregullon fushën e të drejtave të fëmijëve vlerëson se interesi më i lartë i fëmijës është një parim i rëndësishëm i cili duhet të gjejë zbatim së pari; në të drejtën penale, por edhe atë administrative dhe civile. Ky vlerësim gjen konkretizim në angazhimin për hartimin dhe finalizimin e një dokumenti të nevojshëm politikash për të miturit në konflikt me ligjin, të shoqëruar me një plan veprimi me prioritete, objektiva, masa dhe indikatorë gjithëpërfshirës, të matshëm dhe që kanë impakt të plotë në përmirësimin e të gjithë sistemit të drejtësisë që trajton çështjet e të miturve.

Mbrojtja e të drejtave të të miturve nëpërmjet garantimit të ofrimit të shërbimeve në sistemin gjyqësor ka qenë një nga rregullimet bazë të paketës më të fundit ligjore të normimit të sistemit të drejtësisë, në kuadër të reformës në drejtësi. Konkretisht, të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël dhe garantimi i procedurave ligjore të shpejta, efektive dhe cilësore ka qenë synimi më i rëndësishëm i reformës në sistemin e drejtësisë penale, e konkretizuar kjo me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, si edhe një sërë normash të tjera materiale e procedurale.

Kjo paketë ligjore, lidhur me të drejtat e të miturve ka pasur në fokus përmirësimin e mëtejshëm të përmbajtjes dhe formës në mënyrën e trajtimit të të miturve në sistemin gjyqësor, si dhe trajtimin e specializuar që u ofrohet të miturve në komunitet duke i ofruar mbështetje nga njëra anë subjektit të veprës penale që në këtë rast është i mitur dhe nga ana tjetër viktimës dhe dëshmitarit të mitur. Ndër të tjera, fasha e mbrojtjes ligjore është zgjeruar duke përfshirë në këto rregulla edhe të rinjtë deri në moshën 21 vjeç.

Për sa më sipër, si dhe në vazhdim të detyrimit institucional për garantimin e të drejtave të të miturve prezantohet për herë të parë dokumenti politik *“Strategjia e Drejtësisë për të Mitur”*, i shoqëruar me planin e veprimit për periudhën afatgjatë 2018–2021. Strategjia e Drejtësisë për të

Mitur është hartuar në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2017–2020, si dhe Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020. Miratimi i Dokumentit të Strategjisë dhe i Planit të Veprimit ka qenë një ndër masat e parashikuara në udhërrëfyesin e prioritetit nr. 5, “*Të drejtat e njeriut*”, masa 4.8.1, “*Përfshirja e veprimeve në fushën e drejtësisë për të miturit në strategjitë dhe planet e veprimit që trajtojnë të drejtat e fëmijëve*”, të miratuar me vendimin nr. 330, datë 28.5.2014, të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013*”, si dhe në dokumentin e Planit të Masave Afatshkurtra të planifikuara për përmbushjen e 5 Prioriteteve të Komisionit Evropian për Shqipërinë, e përfshirë në prioritetin nr. 5, “*Të drejtat e njeriut*”, rekomandimi nr.3, “*Legjislacioni mbi drejtësinë për të miturit duhet përshtatur me standardet ndërkombëtare*”. Shërbimet për viktimat e dhunës në familje duhen përmirësuar në kualitet, masë, mundësi aksesit dhe mbulim gjeografik.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018, i prezantuar më 17 prill 2018, thekson shprehimisht se: “*Strategjia e Drejtësisë për të Miturit që përfshin edhe drejtësinë për të miturit dhe aksesin e barabartë në drejtësi të fëmijëve është ende në pritje të miratimit*”.

Për hartimin e këtij dokumenti është ngritur me urdhrin nr. 966, datë 3.2.2016, të Ministrit të Drejtësisë, “*Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit*”, grupi i punës i përbërë nga ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë. Strategjia e Drejtësisë për të Miturit dhe plani i saj i veprimit janë hartuar nën ekspertizën profesionale të UNICEF-it dhe ka reflektuar gjetjet dhe rekomandimet e dhëna në të gjitha dokumentet kombëtare dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Qëllimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2018–2021 është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktimat, dëshmitar të veprave penale, të miturit nën moshë për t’u ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore, kryesisht atyre penale, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve.

Strategjia përmban një qasje ndërdisiplinore që do të integrohet me të gjitha dokumentet e tjera ekzistuese kombëtare, e shoqëruar me aktivitete konkrete, gjurmimin e çështjeve me të mitur që kanë kryer vepra penale.

Në kuadër të reformës në drejtësi është miratuar ligji nr. 37/2017, datë 30.3.2017, “*Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur*” dhe ligji nr. 18/2017 “*Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve*” që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në datën 1 janar 2018 hyri në fuqi ligji nr. 37/2017, datë 30.3.2017, “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” i cili përmban norma të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grup-mosha 18 deri në 21 vjeç. Ky ligj përbën një risi dhe zhvillon standardet e legjislacionit shqiptar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në tërësi dhe të të miturve në konflikt me ligjin në veçanti. Kodi është një ligj i veçantë për shkak të përmbajtjes së tij, pasi përmbledh të gjitha dispozitat që referojnë të miturin në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe ligje të tjera referuese të sistemit të drejtësisë penale për të mitur. Ky Kod siguron përfrimin e legjislacionit shqiptar me direktivën 2011/93/BE datë 13.12.2011, përveç përputhjes me standardet ndërkombëtare dhe rajonale. Në zbatim të plotë të këtij Kodi janë parashikuar një seri masash në Planin e Veprimit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur.

Kështu, në sektorin e drejtësisë, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve trajtohet në 3 drejtime kryesore:

- *Përmirësimi i aksesit në drejtësi;*
- *Informim dhe edukim ligjor; dhe*
- *Parandalim, riintegrim dhe rehabilitim.*

Strategjia e Drejtësisë për të Mitur 2018-2021 dhe Plani i saj i Veprimit është miratuar nga Këshilli i Ministrave me Vendimin nr.541, datë 19.09.2018.

Vizioni i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit është “*Përmirësimi i Drejtësisë për të Mitur që garanton një drejtësi miqësore për fëmijë dhe që mbron interesin më të lartë të tyre*”. Prioritetet në realizimin e vizionit strategjik fokusohen në qasjen tek një drejtësi miqësore për të mitur e cila i referohet sistemeve të drejtësisë të cilat garantojnë respektimin dhe implementimin efektiv të të drejtave të fëmijëve duke nënkuptuar drejtësi të aksesueshme, të përshtatshme me moshën, të shpejtë, efektive, të përshtatur dhe të fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve, ku përfshihet e drejta për proces të rregullt, e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për të kuptuar procedurat, si dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, integritetit dhe dinjitetit të fëmijës.

Ky vizion është në të njëjtën linjë me vizionin mbi sektorin e drejtësisë të deklaruar në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, ku thuhet se: “*Shqipëria, një vend i bazuar tek shteti ligjor, garantuese e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, me një sistem drejtësie të hapur dhe të barabartë që garanton drejtësi për të gjithë*” dhe me vizionin e deklaruar nga Strategjia

Ndërsektoriale e Drejtësisë 2017–2020, ku thuhet se: *“Forcimi i shtetit ligjor është një kusht themelor për konsolidimin e demokracisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm politik, ekonomik dhe social në vend. Suksesi i reformave të drejtësisë varet në shkallë të madhe nga ndërveprimi mes institucioneve të pavarura gjyqësore dhe bashkëpunimi i ngushtë me palët e interesuara dhe shoqërinë civile”*.

Qëllimi i Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit 2018-2021 është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit në konflikt me ligjin, viktima, dëshmitarë të veprave penale, të miturit nën moshë për t’u ndjekur penalisht dhe të miturit pjesëmarrës në proceset gjyqësore kryesisht atyre penale, nëpërmjet implementimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve. Strategjia përmban një qasje ndërdisiplinore që do të integrohet me të gjithë dokumentet e tjera ekzistuese kombëtare, e shoqëruar me aktivitete konkrete.

Strategjia e Drejtësisë për të Miturit evidenton domosdoshmërinë për përmirësim në fushat e mëposhtme:

- *Përmirësimet legislative të normave që rregullojnë sektorin e drejtësisë për të mitur;*
- *Përmirësimet infrastrukture të institucioneve mbështetëse të drejtësisë për të mitur;*
- *Rritje të kapaciteteve të profesionistëve që merren me të miturit.*

Strategjia ka **pesë objektiva strategjike të nivelit të lartë**, të cilat janë:

1. **Objektivi strategjik 1.** *“Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi”*.
2. **Objektivi strategjik 2.** *“Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit”*.
3. **Objektivi strategjik 3.** *“Parandalimi i ri-përfshirjes në krime të të miturve/të rinjve në krime”*.
4. **Objektivi strategjik 4.** *“Rishoqërimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin”*.
5. **Objektivi strategjik 5.** *“Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të miturit”*.

Objektivat Strategjike do të adresohen nëpërmjet politikave të mirëmenduara dhe të programuara me qëllim dhënien e impaktit pozitiv dhe të qëndrueshëm në respektimin, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në marrëdhënie me organet e sistemit të drejtësisë.

1.1 Metodologjia e monitorimit

Në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 166, dt. 5.10.2017 “*Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Ministrisë së Drejtësisë*”, në Ministrinë e Drejtësisë është ngritur Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, pranë Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë e cila është struktura përgjegjëse për procesin monitorues dhe për hartimin e Raporteve të Monitorimit të Strategjive.

Drejtorja e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave kryen koordinimin me të gjitha institucionet përgjegjëse, si dhe më pas vijon me hartimin e raportit të monitorimit.

Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2018-2021 dhe përbën raportin e monitorimit për vitin 2020. Ky raport mbulon periudhën nga 1 janar 2020 deri në 31 dhjetor 2020 dhe është hartuar mbi bazën e kontributit të dhënë nga të gjitha institucionet e përfshira në Planin e Veprimit 2018-2021 në zbatim të SDM. Me qëllim monitorimin lidhur me arritjet, progresin/sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë nëpërmjet raportimit të pikave të kontaktit është siguruar informacion nga çdo institucion përgjegjës lidhur me zbatimin e masave të parashikuara në planin e veprimit të SDM-së. Çdo institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo politike dhe aktiviteti, buxhetin e alokuar, problemet e hasura dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Qëllimi është që të kemi informacion mbi arritjet e progresit dhe sfidat drejt përmbushjes së objektivave të strategjisë.

Monitorimi i Strategjisë ka konsistuar në dy faza kryesore:

1. *Raportimi i institucioneve nëpërmjet pikave të kontaktit mbi zbatimin e masave për të cilat janë përgjegjëse;*
2. *Raportimi nga Ministria e Drejtësisë mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij.*

Secili institucion ka raportuar mbi nivelin e zbatimit të çdo qëllimi politike, objektivi specifik dhe masash të realizuar (*mbi bazë aktivitetesh të kryera*), buxhetin e parashikuar për vitin raportues, buxhetin e alokuar për periudhën e raportimit, problemet e hasura, hapat e mëtejshme dhe vlerësimin e progresit të strategjisë në tërësi. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektivash strategjik/specifik dhe masa/aktivitete të parashikuara.

Vlerësimi i progresit të zbatimit të SDM-it për këtë periudhë raportimi është kryer nga Sektori i Monitorimit, Jetësimit të Prioriteteve dhe Statistikave, përmes analizës së të dhënave të përcjella nga institucionet raportuese duke iu përmbajtur metodës së analizës së parashikuar në Vendimin

nr.290, datë 11.4.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Bazës të të Dhënave Shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS)” dhe Urdhrit nr.157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Analiza e të dhënave është bërë në përputhje me aktet e sipërcituara dhe strukturës orientuese për monitorimin e strategjive dhe planeve të veprimit.

- **Së pari**, me qëllim dhënien e një rezultati jo vetëm sasior, por edhe cilësor të nivelit të zbatimit të masave (*realizimi i produkteve*) është kryer vlerësimi i objektivave përkundrejt masës.
- **Së dyti**, është analizuar realizimi i objektivave strategjike përmes përlogaritjes së realizimit të masave (*realizimi i produkteve*).

Një vlerësim më i përgjithshëm përmblendhës është kryer gjithashtu për realizimin e strategjisë në tërësi për këtë periudhë raportimi.

Pas hartimit të draft raportit, Ministria e Drejtësisë në mbështetje të procesit të monitorimit dërgon dokumentin për konsultim pranë institucioneve raportuese, shoqërisë civile, si dhe publikon draftin në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, ku caktohet dhe një adresë elektronike për marrjen e komenteve. Në përfundim të procesit konsultues, Ministria e Drejtësisë kryen reflektimin e komenteve/sugjerimeve relevante mbi draft raportin e monitorimit para se të miratohet nga Komiteti Drejtues Sektorial/Mekanizmi Institucional.

Ecuria e progresit në periudhën që monitorohet klasifikohet në këto kategori:

- *E zbatuar/E realizuar*:Institucionet kanë raportuar statusin “**E zbatuar**” për ato masa/aktivitete të cilat janë përmbushur.
- *Pjesërisht e zbatuar/Në proces*:Institucionet kanë raportuar statusin “**Pjesërisht e zbatuar/ Në proces**” për ato masa/aktivitete të cilat në periudhën e raportimit kanë pasur zbatim të pjesshëm dhe/apo që vijojnë të jenë në zbatueshmëri prej tyre.
- *E porealizuar/Pa zbatuar*:Janë raportuar ato masa/aktivitete të cilat nuk kanë regjistruar zhvillim për periudhën raportuese.

Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht on-line për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin. Gjithashtu, gjatë hartimit të Raportit janë marrë në konsideratë dy elementë të rëndësishëm:

1. Raportimi për zbatimin e masës/aktivitetit nga institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e saj duke vlerësuar dhe mirëpritur dhe kontributet e institucioneve të tjera bashkëvepruese;
2. Në Raportin e rradhës lidhur me elementët e metodologjisë së IPSIS kërkohet adresimi i tyre për plotësimin e hendekut midis Planit të Veprimit dhe formatit të IPSIS.

Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhura, si dhe duke e llogaritur në mesateren e ponderuar.

II. PROGRESI I STRATEGJISË SË DREJTËSISË PËR TË MITUR

Prioritetet në realizimin e vizionit strategjik fokusohen në qasjen te një *drejtësi miqësore për të mitur* e cila u referohet sistemeve të drejtësisë të cilat garantojnë respektimin dhe implementimin efektiv të të drejtave të fëmijëve, duke pasur parasysh parimet e mëposhtme dhe duke mbajtur në konsideratë nivelin e pjekurisë së fëmijës dhe rrethanat e çështjes. E ndarë në komponentë nënkupton drejtësi të aksesueshme, të përshtatshme me moshën, të shpejtë, efektive, të përshtatur dhe të fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve, ku përfshihet e drejta për proces të rregullt, e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për të kuptuar procedurat, si dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, integritetit dhe dinjitetit të fëmijës.

2.1 Reforma të implementuara me sukses në vitin përkatës

Në kuadër të Reformës në Drejtësi është miratuar ligji nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”, që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve për trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Më **1 Janar 2018** hyri në fuqi ligji nr. 37/2017, datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” i cili përmban norma të posaçme ligjore lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose çdo masë tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale, si dhe rregulla për të rinjtë nga grupmosha 18 deri në 21 vjeç. Ky ligj përbën një risi dhe zhvillon standardet e legjislacionit shqiptar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në tërësi dhe të të miturve në konflikt me ligjin në veçanti. Kodi është një ligj i veçantë për shkak të përmbajtjes së tij pasi përmbledh të gjitha dispozitat që referojnë të

miturin në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, si dhe ligje të tjera referuese të sistemit të drejtësisë penale për të mitur. Ky Kod siguron përafrimin e legjislacionit shqiptar me Direktivën 2011/93/BE datë 13.12.2011, përveç përputhjes me standardet ndërkombëtare dhe rajonale. Në zbatim të plotë të këtij Kodi janë parashikuar një seri masash në Planin e Veprimit të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur.

Mbrojtja dhe garantimi i të drejtave të të miturve është një ndër prioritetet kyçe të Ministrisë së Drejtësisë, e jetësuar në Programin e Qeverisë Shqiptare nën objektivin madhor “Zbatimi i reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit në konflikt me ligjin duke forcuar sistemin e drejtësisë restauruese dhe mbrojtjen efektive procedurale”. Ministria e Drejtësisë mbështetur në kuadrin ligjor vendas dhe ndërkombëtar që rregullon fushën e të drejtave të fëmijëve vlerëson se interesi më i lartë i fëmijës është një parim i rëndësishëm i cili duhet të gjejë zbatim së pari në të drejtën penale, por edhe atë administrative dhe civile.

Mbrojtja e të drejtave të të miturve nëpërmjet garantimit të ofrimit të shërbimeve në sistemin gjyqësor ka qenë një nga rregullimet bazë të paketës më të fundit ligjore të normimit të sistemit të drejtësisë, në kuadër të reformës në drejtësi. Konkretisht, të miturit në sistemin e drejtësisë penale përbëjnë një kategori vulnerabël dhe garantimi i procedurave ligjore të shpejta, efektive dhe cilësore ka qenë synimi më i rëndësishëm i reformës në sistemin e drejtësisë penale, e konkretizuar kjo me miratimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Ligjin për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. Gjithashtu janë miratuar gjashtë Vendime të Këshillit të Ministrave, urdhëra dhe udhëzime, si dhe një projekt vendim duke garantuar në këtë drejtim mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Për më tepër në vijim të **Urdhrit Nr. 75, datë 09.06.2020 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përmirësimin e sistemit të parandalimit dhe adresimit të dhunës ndaj të miturve”**, pranë Ministrisë së Drejtësisë janë ngritur dy grupe pune, lidhur me:

- *Analizën e problematikave të dhunës në familje;*
- *Për përmirësimin e sistemit të parandalimit dhe adresimit të abuzimit seksual ndaj të miturve.*

Përsa sa më sipër, është analizuar legjislacioni në fuqi bazuar dhe në rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë, si dhe hapat që do ndiqen në vijimësi të këtij procesi.

Marrëveshjet e bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkive në Republikën e Shqipërisë.

Bashkëpunimi ndërinstitucional ndërmjet hallkave të sistemit të drejtësisë me strukturat e pushtetit lokal ka rëndësi thelbësore në plotësimin e kuadrit institucional për zbatimin në praktikë të legjislacionit për drejtësinë për të miturit. Në kuadër të Reformës së Drejtësisë Miqësore për të Miturit, Ministria e Drejtësisë ka vijuar me procesin për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me pushtetin vendor, ku gjatë vitit 2020 janë nënshkruar gjithsej **15 marrëveshje**. Ministria e Drejtësisë është duke vijuar e bashkërenduar punën edhe me bashkitë e tjera në vend, me qëllim nënshkrimin e marrëveshjeve edhe me këto bashki për trajtimin e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin, ndaj të cilëve është dhënë masa alternative e shmangies nga dënimi dhe ndjekja penale.

Qendrat multidisiplinare pranë Bashkive me të cilat janë nënshkruar marrëveshjet janë funksionale dhe të hapura për çdo referim të mundshëm të rasteve nga Prokuroria dhe Gjykata. Aktualisht, në qendrat multidisiplinare ngrihen Grupet Teknike Ndërsektoriale (GTN), ku marrin pjesë Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF), psikologë, punonjës socialë, avokatë, mjekë dhe të tjerë profesionistë të fushave sipas rastit, pasi bëhet vlerësimi i nevojave të të miturit. Në rastet kur prokuroria jep masat e shmangies dhe i mituri duhet të mbikqyret nga Shërbimi i Provës, specialisti përkatës merr pjesë në GTN dhe në trajtimin e rastit sipas nevojave përkatëse. Llojet e shërbimeve të ofruara për të miturit në konflikt me ligjin janë të ndryshme duke përfshirë këshillimin individual dhe familjar, aktivitete sociale, edukative, sensibilizuese, etj; si dhe çdo lloj ndihme tjetër që GTN vlerëson se i mituri ka nevojë.

Objekti i nënshkrimit të këtyre marrëveshjeve mes palëve është vendosja e bashkëpunimit midis dy institucioneve për realizimin dhe mbikqyrjen e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale dhe dënimi për të miturit në konflikt me Ligjin.

Me nënshkrimin e marrëveshjes **Palët** bien dakord të bashkëpunojnë me qëllim zbatimin e masave të shmangies për të miturit në konflikt me ligjin nëpërmjet:

- i) *Ofrimit të tërësisë së shërbimeve sociale për të miturit tek Qendrat Sociale në varësi të Bashkisë;*
- ii) *Organizimit dhe pjesëmarrjes së punonjësve të Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Shërbimit të Provës në trajnime të përbashkëta me qëllim forcimin e kapaciteteve profesionale të strukturave të shërbimeve mbështetëse në këtë proces;*

- iii) *Lehtësimi* të ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes për të miturit në konflikt me ligjin dhe familjes së tij, kur kjo kërkohet prej tyre;
- iv) *Promovimi* të modelit të drejtësisë miqësore me të miturit në konflikt me ligjin duke organizuar në ambientet e qendrës aktivitete sensibilizuese, edukative, argëtuese dhe aktivitete të tjera në përshtatje me nevojat e të miturit.

Vlen të theksohet se Ministria e Drejtësisë ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me OJF në lidhje me programet e drejtësisë restauruese për të miturit të cilat synojnë në modelimin e shërbimeve për riintegrimin e fëmijëve në konflikt me ligjin si dhe në forcimin dhe rritjen e kapaciteteve të organeve përgjegjëse për zbatimin e këtij modeli. Modeli i shërbimeve riintegruese do të zhvillohet në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e Drejtësisë, Bashkinë e Tiranës, Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, Qendrat e Formimit Profesional, etj.

Kuadri infrastrukturor për të Miturit në konflikt me ligjin

Krijimi i institucioneve të reja në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit si kusht për plotësimin e infrastrukturës së nevojshme për të vënë në zbatim aktet nënligjore, masat alternative të dënimit si dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri është një nga hallkat më të rëndësishme me qëllim realizimi.

Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë është angazhuar në ngritjen e institucioneve të reja si:

- ***Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve:*** Institucion ky i konceptuar si një mekanizëm në varësi të Ministrisë së Drejtësisë që do të hartojë programe parandaluese dhe do të mbikqyrë për një periudhë 6-mujore të miturit pas përfundimit të dënimit. Në dhjetor të vitit 2020 ka filluar shpallja e vendeve vakante në DAP për rekrutimin e stafit për Qendrën e Parandalimit të Krimeve për të Miturit dhe të Rinjtë, si dhe finalizimin e përshkrimeve të punës sipas formatit të përcaktuar. Aktualisht, MD ka përfunduar dokumentacionin i cili normon funksionimin e brendshëm të këtij institucioni si dhe në bashkëpunim me DAP ka vijuar procedurat e rekrutimit të stafit të tij.
- ***Institucioni i Edukimit dhe Rehabilitimit të të Miturve:*** Institucion i konceptuar si një mekanizëm pranë të cilit do të zbatohen programet e rehabilitimit dhe riintegrimin për të miturit që janë dënuar nga gjykata me dënimin e kufizimit të lirisë. Është miratuar Vendimi nr. 233, datë 17.04.2019 i Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e rregullimeve të veçanta lidhur me funksionimin e mjediseve të nivelit të sigurisë së tyre dhe standardet e programeve*

të edukimit e të rehabilitimit, në rastet e kufizimit të lirisë së të miturve”. Institucioni i Kufizimit të Lirisë do të funksionojë si një institucion gjysëm i hapur, ku të miturve do t’iu kufizohet liria e veprimt/levizjes në atë masë që parandalohet kryerja e veprave penale prej tyre dhe veçanërisht synohet riintegrimi dhe rishoqërimi i të miturit në komunitet. Lidhur me funksionimin e këtij institucioni MD ka përfunduar procedurat që lidhen me pjesën arkitekturore të projektit dhe vendit ku do të ngrihet ky institucion. Gjithashtu, ka përfunduar draft dokumentacioni i brendshëm për vënien në funksion të këtij institucioni. Ngritja dhe funksionimi i këtij institucioni do t’i shërbejë trajtimit të të miturve në përputhje me standardet më të larta të mbrojtjes së të drejtave të tyre duke synuar edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve në konflikt me ligjin. Përsa i përket Institutit është ngritur grupi i punës i cili ka hartuar termat e referencës për zhvillimin dhe projekt dizenjimin e institutit. Projekti është paraqitur tek donatorët e huaj dhe pranë Ministrisë së Financave për mundësi financimi. Në vijim është mbyllur procedura e tenderimit dhe është shpallur fitues bashkimi i operatorëve “D & C Partners + Net Group” Sh.p.k.

Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e UNICEF ka vënë në funksionim *Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur*, detyrim ligjor që rrjedh nga neni 136 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku përcaktohet se: *“Për mbajtjen e të dhënave të çështjeve penale që përfshijnë të miturit në konflikt me ligjin penal, të miturit viktime dhe dëshmitarë të veprave penale krijohet “Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”*, Kodi, si edhe VKM nr.149, datë 20.03.2019 të cilat ngarkojnë Ministrinë e Drejtësisë për administrimin e të dhënave të këtij sistemi. Për herë të parë, do të sigurohet unifikimi dhe kompjuterizimi i të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur në kohë reale, me qëllim krijimin e një baze statistikore që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave shtetërore për fëmijët. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ka si qëllim mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave të drejtësisë penale për të mitur nëpërmjet gjurmimit të të dhënave të ndjekjes penale e procedurave gjyqësore, si dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga institucionet e parashikuara në këtë vendim. Sistemi përmban të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit penal për të miturit, subjekte të këtij Kodi, të dhëna të cilat mbahen në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjatë muajve të parë të vitit 2020 është realizuar takimi i grupit të punës ndërmjet AKSHI-t, UNICEF-it dhe Ministrisë së Drejtësisë, për hartimin e termave të referencës, studimin e tregut dhe përcaktimin e kriterëve të veçanta për përmirësimin e sistemit aktual. Gjithashtu, ka vijuar komunikimi me AKSHI-n për hostimin e

sistemit dhe marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet MD-së dhe AKSHI-t, si dhe i janë përcjellë termat e referencës UNICEF-it.

Më pas UNICEF ka përzgjedhur ekspertët dhe konkretisht Qendrën CEMT me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të sistemit, sipas Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur. Në vijim, UNICEF dhe Qendra CEMT kanë realizuar takime të përbashkëta pune, workshope me të gjitha organet kompetente që do të jenë përdoruese të Sistemit si: Gjykata/Prokurori/Polici/Shërbim Prove/Burgje.

2.2 Impakti i implementimit të strategjisë në përputhje me agjendën e integritit evropian

✓ Progres Raporti 2018

Kodi i Drejtësisë Penale për Mitur në Mars 2017 siguroi pajtueshmërinë ‘de jure’ të Shqipërisë me standardet ndërkombëtare për drejtësinë për të mitur. Kodi duhet të plotësohet me legjislacionin dytësor. Miratimi i strategjisë “Drejtësia për të Mitur” që përfshin drejtësinë për të miturit dhe qasjen e barabartë në drejtësi për fëmijët është akoma në pritje. Ligji për Ndhmën Juridike i miratuar në Dhjetor 2017 synon të sigurojë aksesin e fëmijëve në ndihmën juridike. Ministria e Drejtësisë ka krijuar një seksion për drejtësinë penale për fëmijët dhe ka zhvilluar një sistem në internet për ndjekjen e rasteve të fëmijëve që kanë kryer vepra penale.

✓ Progres Raporti 2019

Kuadri legjislativ dhe politikat për drejtësinë për të mitur u forcuan me miratimin e Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë për të Mitur (2018-2021) në Shtator 2018. Strategjia përfshin zbatimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit. Strategjia bazohet në programet buxhetore të qeverisë. Zbatimi i strategjisë së re dhe Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit i miratuar në vitin 2017 do të kërkojë një zhvendosje në kulturën administrative, ndërtimin e konsiderueshëm të kapaciteteve, infrastrukturën e përshtatur posaçërisht, krijimin e shërbimeve të komunitetit dhe koordinimin ndër-disiplinor / ndër-institucional në atë qendror dhe të nivelit lokal. Ka akoma boshllëqe strukturore në drejtësinë për të mitur në Shqipëri. Në shkurt të vitit 2019 ishin 31 të mitur në Qendrën e Paraburgimit në Kavajë për të Mitur.

✓ Progres Raporit 2020

Kuadri ligjor në fushat e të drejtave të fëmijëve dhe drejtësisë për të mitur është përmirësuar gjithashtu me akte nënligjore. Shqipëria ka avancuar kornizën e politikave dhe ka ndërmarrë hapa

për të forcuar kapacitetet institucionale për të adresuar pengesat e ndryshme që hasin fëmijët shqiptarë në aksesin në drejtësi. Në kuadrin e zbatimit të Kodit për të Mitur dhe Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur 2018-2021, aktet nënligjore të nevojshme u miratuan me gjashtë Vendime të Këshillit të Ministrave në 2019.

Me qëllim trajtimin e të miturve me masa alternative në qendrat sociale multidisiplinare u nënshkruan 11 marrëveshje të reja për bashkëpunim lokal në vitin 2019, duke sjellë numrin e përgjithshëm të marrëveshjeve të bashkëpunimit në 18 bashki. Të gjitha këto bashki kanë krijuar strukturat përkatëse/qendrat multidisiplinare të cilat janë funksionale dhe mund të trajtojnë të miturin në konflikt me ligjin.

Qendra e Paraburgimit për të Mitur në Kavajë do të shndërrohet në një Institut Multidisiplinar për Rehabilitimin e të Miturve pas një vendimi të Prillit 2019. Numri i të miturve aktualisht në qendër është 25, nga të cilët tre autorë të dënuar. Për më tepër, "*Qendra e Parandalimit të Krimin për të Miturit dhe të Rinjtë*" u krijua në maj të vitit 2019. Qendra është konceptuar si një mekanizëm vartës i Ministrisë së Drejtësisë që do të zhvillojë programe parandaluese dhe mbikqyr një të mitur për një periudhë gjashtëmujore pas përfundimit të dënimit.

Gjithashtu Strategjia është në përputhje me kërkesat dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për sa i përket përbushjes së 5 prioritetëve lidhur me anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

2.3 Komponentët që kanë nevojë për adresimin me qëllim përmirësimin e implementimit

Plani i Veprimit 2018-2021 përbëhet nga 5 objektivat strategjike dhe përmban në total 25 aktivitete. ***Për vitin 2020, në Strategji janë parashikur për t'u zhvilluar 24 aktivitete.*** Me qëllim monitorimin e zbatimit të masave të ndërmarra, përsa i përket përbushjes së objektivave strategjike, procesi i monitorimit është kryer në nivel objektiv.

Objektivi strategjik 1: "Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi".

Strategjia parashikon se aksesin në drejtësi do të garantohet duke dhënë rezultate konkrete të matshme me:

- *Numrin e strukturave dhe i profesionistëve që ofrojnë ndihmë juridike;*
- *Numrin e mjediseve të rikonstruara në përshtatje me nevojat e të miturve;*
- *Numrin e aktiviteteve sensibilizuese për drejtësinë për të miturit.*

Ky aspekt lidhet me kapacitetin e të miturve për t'i aksesuar shërbimet e drejtësisë për të miturit dhe përfshin ndërgjegjësimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas si aktivite konkrete të cilat do të konkretizohen në kapitullin vijues.

Objektivi strategjik 2: “Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit”.

Duke mbajtur në konsideratë detyrimin e vendit për të respektuar dhe për të garantuar të drejtat e parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, strategjia ka parashikuar aktivitete konkrete me qëllim garantimin e kësaj të drejte për të miturit e përfshirë në procese gjyqësore. Në fokus të strategjisë është garantimi i gjykimit brenda një kohe të arsyeshme, përmirësimi i kuadrit ligjor që normon të drejtat e fëmijëve dhe mbështetja e të miturit në çdo proces nga profesionistë të trajnuar dhe të specializuar.

Strategjia parashikon se ky objektivi do të garantohet duke dhënë rezultate konkrete, në lidhje me:

- *Numrin e seksione të vetë specjializuara për të miturit në gjykata dhe prokurori;*
- *Numrin e profesionistëve të trajnuar për çështjet e drejtësisë për të miturit;*
- *Numrin e institucioneve që hedhin të dhëna në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit;*
- *Numrin e akteve ligjore/nënligjore të miratuara në fushën e drejtësisë për të miturit.*

Objektivi strategjik 3: “Parandalimi i ri-përfshirjes në krime të të miturve/të rinjve në krime”.

- *Për realizimin e këtij objektivi planifikohet të analizohen faktorët e riskut dhe masat mbrojtëse. Duke pasur parasysh se kjo është strategjia e parë për drejtësinë për të mitur, objektivi fokusohet në mënyrë të veçantë tek ngritja dhe vënia në funksionim e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, si dhe tek programet për parandalimin e ripërfshirjes së të miturve në vepra penale (recidivizmit) të cilat do të kenë në qendër të vëmendjes mbështetjen për fëmijët dhe familjet, veçanërisht, fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale dhe grupeve në risk apo të cënueshme (vulnerabël).*
- *Parandalimi i krimit është zgjidhja më e mirë për fëmijët, familjet e tyre, komunitetet dhe shoqërinë në tërësi.*

Objektivi strategjik 4: “Rishoqërimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin”.

Qëllimi i këtij objektivi është rehabilitimi i të miturve, inkurajimi dhe zhvillimi, në kuptim të përgjegjësisë së të miturit, e ndjenjës së respektimit të të drejtave të të tjerëve, nxitja dhe mundësimi i zhvillimit të shëndoshë fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror i të miturit dhe për ta përgatitur atë që të rikthehet në shoqëri. Strategjia parashikon që realizimin e këtij objektivi ta masë nëpërmjet:

- Numrit të fëmijëve dhe të familjeve të përfshira në programet e riintegrit;
- Numrit të fëmijëve të dënuar me burgim dhe me masa alternative;
- Numrit të fëmijëve ndaj të cilëve janë zbatuar masat alternative të shmangies nga ndjekja penale.

Objektivi strategjik 5: “Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të miturit”.

Vlerësohet se kusht thelbësor për implementimin në mënyrën e duhur dhe efektive të të drejtave dhe garancive të fëmijëve është:

- Bashkëpunimi, ndërveprimi dhe bashkërendim i institucioneve dhe i autoriteteve në nivel qendror dhe vendor të përfshira në administrimin e drejtësisë për të mitur.
- Rrjedhimisht, strategjia parashikon ngritjen dhe funksionimin e rrjetit ndërinstytucional në nivel qendror dhe funksionimin e komunitetit të praktikantëve në nivel vendor.


Statuasi i zbatimit sipas Objektivave Strategjike

Objektivat Strategjike	Të zbatuara	Pjesërisht të zbatuara/në proces	Të pazbatuara
Statuasi i zbatimit të Objektivit Strategjik 1	0	1	0
Statuasi i zbatimit të Objektivit Strategjik 2	0	2	0
Statuasi i zbatimit të Objektivit Strategjik 3	0	1	0
Statuasi i zbatimit të Objektivit Strategjik 4	0	3	0
Statuasi i zbatimit të Objektivit Strategjik 5	2	0	0
TOTALI	1	4	0

Për periudhën janar-dhjetor 2020, në total për pesë Objektivat Strategjike **rezultojnë:**

- ✓ **1 i realizuar plotësisht;**

✓ **4 pjesërisht të zbatuara/në proces**, të raportuara nga institucionet përgjegjëse.



Për periudhën janar – dhjetor 2020 nga 24 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë janë realizuar 15 prej tyre, 7 janë ende në proces zbatimi, 2 aktivitete të porealizuara. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit është në nivelin 62% për aktivitetet të cilat janë të realizuara, 30% për aktivitetet në proces, 8% për aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet.

Në periudhën janar - dhjetor 2020 me shkallë zbatueshmërie të pjesshme (50%) rezultojnë të jenë 4 Objektivat Strategjikë nga institucionet përgjegjëse. Me shkallë zbatueshmërie të plotë (100%) rezulton një objektiv (objektivi nr.5).

Për periudhën e ardhshme kërkohet që të vijohet me ecurinë e zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara për realizimin e tyre në kohë dhe me produktet e planifikuara. Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2018 - 2021, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

- Raportim cilësor sipas metodologjisë IPSIS nga institucionet e përfshira në Planin e Veprimit.
- Gjithëpërfshirja e aktorëve të cilët ofrojnë kontribut në fushën e drejtësisë penale për të mitur dhe grupeve të interesit gjatë fazave të raportimit, konsultimit dhe monitorimit.
- Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse, nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional.

- Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të përcaktuara.
- Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit pranë Drejtorive të Financës, të institucioneve përkatëse, përpara momentit të raportimit pranë Ministrisë së Drejtësisë.
- Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse/OSHC-ve të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.

2.4 Ekzekutimi i përgjithshëm i buxhetit

Sipas Strategjisë, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të masave/aktiviteteve të Planit të Veprimit 2018 - 2021, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi buxhetin e planifikuar për vitin raportues dhe buxhetin e përdorur në bazë të aktivitetit të kryer. Nga analiza për masat/aktivitetet e raportuara për vitin 2020, buxheti i përdorur rezulton se:

- *Financimi për periudhën janar-dhjetor të vitit 2020 nga buxheti i shtetit është në shumën 0 lekë (pa raportuar nga institucionet përgjegjëse).*
- *Financimi për periudhën janar-dhjetor të vitit 2020 nga donatorët është në shumën 35,817 lekë.*

Shumë aktivitete të kryera gjatë kësaj periudhe raportimi, janë në “*kosto administrative*” për shkak të zhvillimit të tyre on-line në kushtet e pandemisë, të mundësuar këto dhe të mbuluara nga kapacitetet njerëzore dhe financiare të institucioneve zbatuese duke mos paraqitur kosto shtesë për institucionet zbatuese, në përputhje me parashikimin e bërë në Planin e Veprimit.

III. PROGRESI I LIDHUR ME OBJEKTIVAT STRATEGJIKË DHE AKTIVITETET

Strategjia ka identifikuar **5 objektiva strategjike të SDM-së për vitet 2018-2021** për arritjen e të cilave duhet të përmbushë objektivat specifike që duhen arritur deri në vitin 2021, vizionin e saj dhe konkretizimin e tyre që do të bëhet nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit. Ky kapitull përshkruan progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së secilit objektiv të Strategjisë dhe

pasqyron grafikisht statusin e zbatimit të Strategjisë për periudhën *janar – dhjetor 2020*. **Për vitin 2020, Strategjia parashikon për t’u përmbushur 24 masa.**

3.1 Objektivi 1: Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi.

Strategjia parashikon se aksesin në drejtësi do të garantohet duke dhënë rezultate konkrete të matshme me: i) numrin e strukturave dhe profesionistëve që ofrojnë ndihmë juridike; ii) numrin e mjediseve të rikonstruara në përshtatje me nevojat e të miturve dhe iii) numrin e aktiviteteve sensibilizuese për drejtësinë për të miturit. Ky aspekt lidhet me kapacitetin e të miturve për t’i aksesuar shërbimet e drejtësisë për të miturit dhe përfshin ndërgjegjësimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas, aktivitetet konkrete të të cilave do të konkretizohen në kapitullin vijues.

Numri i aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 1

Janar – Dhjetor 2020		
Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit 1	Numri i aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 1
Të realizuara	2	67%
Në proces	1	33%
Të porealizuara	0	0%
Totali	3	100%



Përqindja e statusit të aktiviteteve



Rezulton se nga 3 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 1 për vitin 2020, janë realizuar 2 prej tyre dhe 1 është ende në proces zbatimi nga institucioni përgjegjës. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektivi është në nivelin 67% për aktivitetet të cilat janë të realizuara, 33% aktivitetet në proces.

Për përllogaritjen e realizimit të objektivit strategjik 1, sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të aktiviteteve është përdorur formula si më poshtë:

$$NR\ 1 = \frac{TP\ Akt\ 1\ (100\%) + TP\ Akt\ 2\ (100\%) + TP\ Akt\ 3\ (50\%)}{3\ TP\ Akt} \times 100\% = 83.3\%$$

Niveli i realizimit të *Objektivit 1. Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës së aktiviteteve për periudhën janar - dhjetor 2020 është **83.3%**.

Shkalla e realizimit të objektivit strategjik 1 për këtë periudhë raportimi në lidhje me zbatimin e aktiviteteve është **mirë** (51-85 për qind e aktiviteteve të realizuara).

Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2020.

- ✓ DNJF ka plotësuar kuadrin ligjor për ndihmën juridike me miratimin e dy akteve më të fundit në shtator të 2020 si dhe miratimin e Rregullores së Brendshme. Gjithashtu, është bërë i mundur miratimi i ndryshimeve ligjore të propozuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, konkretisht në Urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë.

- ✓ DNJF ka vijuar me aktivitete të ndryshme me fokus të miturit dhe kategori të tjera të veçanta sipas ligjit, si dhe publikimin e materialeve të vizibilitetit me karakter informues/ndërgjegjësues. Është hartuar gjithashtu manuali i thjeshtëzuar për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, kriteret dhe subjektet përfitues. Faqja zyrtare e DNJF-së www.ndihmajuridike.gov.al si dhe faqet zyrtare në rrjetet sociale janë funksionale dhe ofrojnë informacione rreth shërbimeve falas që mundësohen dhe garantoen nga shteti.
- ✓ Gjatë vitit 2020, punonjësit e qendrave kanë qenë pjesë e disa trajnimeve të zhvilluara nga DNJF me mbështetjen e UNDP. Trajnimet janë fokusuar në aspektet praktike të ligjit nr.111/2017, sipas kategorive specifike. Gjithashtu, DNJF ka zhvilluar disa Webinare të cilat kanë patur në fokus aspekte të veçanta dhe problematika të përcjella nga punonjësit gjatë ofrimit të ndihmës juridike.
- ✓ Dhoma Kombëtare e Avokatisë (DHKA), në bashkëpunim me Organizatën *Terre des Hommes* kanë përgatitur udhëzues dhe trajnim mbi Drejtësinë Miqësore për të Miturit, veçanërisht rolin e Avokatit në Përdorimin e Programeve të Drejtësisë Restauruese dhe Masave të Shmangies. Në tetor 2020 u zhvillua trajnimi me avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga Shteti, ku kanë marrë pjesë **25 avokatë**.
- ✓ Në prokuroritë e shkallës së parë janë marrë masa për përshtatjen e mjediseve/zyrave për ti bërë miqësore për të miturit, duke shfrytëzuar maksimalisht mjediset në dispozicion. Vetëm në prokuroritë Tiranë, Vlorë e Gjirokastrë, nuk është bërë e mundur por shfrytëzohen ambientet e krijuara posaçërisht në komisariatet e policisë.
- ✓ U mundësua ngritja e katër ambienteve miqësore për intervistimin e të miturve në strukturat policore të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër. Gjithashtu, rezulton se janë përshtatur shtatë ambiente miqësore për intervistimin e të miturve në strukturat vendore të policisë Berat, Gjirokastrë, Dibër, Kukës, Fier, Sarandë, Korçë.
- ✓ Realizimi i seancave informative me fëmijët e arsimit të detyruar dhe të mesëm në dy fushata sensibilizuese në fushën e parandalimit dhe zgjidhjes me “*metoda restauruese të konflikteve dhe njohjes së të drejtave dhe shërbimeve që përfitojnë të miturit autorë, viktimë dhe dëshmitarë të veprave penale*” nga UNICEF në bashkëpunim me Save the Children, zyrat vendore arsimore dhe qendrat komunitare në Berat dhe Gjirokastrë.
- ✓ Në kuadër të situatës së krijuar të shkaktuar nga Covid-19, Strukturat e Mbrojtjes së Fëmijëve ndërmorrën një sërë masash të menjëhershme duke ofruar mbështetje, ndërgjegjësim dhe informim ndaj fëmijëve dhe familjeve të tyre rreth situatës së krijuar.
- ✓ Avokati i Popullit në drejtim të promovimit të të drejtave të fëmijëve ka luajtur rol proaktiv duke patur si qëllim ndërgjegjësimin, këshillimin dhe informimin e tyre.


- ✓ Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në përmbushje të funksionit mbrojtës dhe parandalues ka ushtruar detyrën e tij duke monitoruar në vazhdimësi *online* institucionet ku privohet liria. Monitorimi dhe kontaktet me Institutin e të Miturve Kavajë kanë qenë intensive duke zbatuar protokollin e caktuar për masat anti Covid-19.
- ✓ Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë ka realizuar aktivitete sensibilizuese, ndërgjegjësuere dhe informuese në shkollat e arsimit bazë me qëllim njohjen e të drejtave të të miturve autorë në konflikt me ligjin, viktimë apo dëshmitarë.
- ✓ Rezulton se deri më tani, gjatë punës së tij, Komsioneri ka trajtuar raste ankesash dhe ka iniciuar hetime *ex-officio* lidhur me problematikat e të miturve. Gjithashtu, Komsioneri ka organizuar dhe ka marrë pjesë në takime ndërgjegjësuere, ku në fokus kanë qenë fëmijët e ngjuar, rom dhe egjiptian, si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

3.2 Objektivi 2: Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit.

Duke mbajtur në konsideratë detyrimin e vendit për të respektuar dhe garantuar të drejtat e parashikuara nga Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut, strategjia ka parashikuar aktivitete konkrete me qëllim garantimin e kësaj të drejte për të miturit e përfshirë në procese gjyqësore. Në fokus të strategjisë është garantimi i gjykimit brenda një kohe të arsyeshme, përmirësimi i kuadrit ligjor që normon të drejtat e fëmijëve dhe mbështetja e të miturit në çdo proces nga profesionistë të trajnuar dhe specializuar. Strategjia parashikon se ky objektivi do të garantohet duke dhënë rezultate konkrete në lidhje me: i) numrin e seksioneve të speciaiziluara për të miturit në gjykata dhe prokurori; ii) numrin e profesionistëve të trajnuar për çështjet e drejtësisë për të miturit; iii) numrin e institucioneve që hedhin të dhëna në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Miturit dhe iv) numrin e akteve ligjore/nënligjore të miratuara në fushën e drejtësisë për të miturit.

Numri i aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 2

Janar–Dhjetor 2020		
Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit 2	Numri i aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 2
Të realizuara	5	71%
Në proces	2	29%
Të porealizuara	0	0%
Totali	7	100%



Rezulton se nga 7 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për objektivin 2 janë realizuar 5 prej tyre, 2 janë ende në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është në nivelin 71 % për aktivitetet të cilat janë të realizuara, 29 % e aktiviteteve në proces.

Për përlogaritjen e realizimit të objektivit strategjik 2, sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të aktiviteteve është përdorur formula si më poshtë:

$$\text{NR 2} = \frac{\text{TP Akt 1 (100\%)} + \text{TP Akt 2 (100\%)} + \text{TP Akt 3 (50\%)} + \text{TP Akt 4 (100\%)} + \text{TP Akt 5 (50\%)} + \text{TP Akt 6 (100\%)} + \text{TP Akt 7 (100\%)}}{7 \text{ TP Akt}} \times 100\% = 85.7\%$$

Niveli i realizimit të *Objektivit 2. Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës së aktiviteteve për periudhën janar - dhjetor 2020 **është 85.7%**.

Shkalla e realizimit të objektivit strategjik 1 për këtë periudhë raportimi në lidhje me zbatimin e aktiviteteve është **mirë** (51-85 për qind e aktiviteteve të realizuara).

Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2020.

- ✓ Shkolla e Magjistraturës ka zhvilluar 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese për çështjet e të miturve. Në aktivitetet e zhvilluara janë trajnuar gjithsej *112 persona*.
- ✓ Në kuadër të procesit të rregullt ligjor, Këshilli i Lartë Gjyqësor me Udhëzimin nr. 79, datë 30.05.2019, udhëzon Gjykatat e Shkallës së Parë dhe ato të Apelit të juridiksionit të përgjithshëm që të caktojnë së paku 3 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose viktimë nga vepra penale.
- ✓ Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e UNICEF ka vënë në funksionim Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili për herë të parë do të sigurojë unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur në kohë reale, me qëllim krijimin e një baze statistikore që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave shtetërore për fëmijët.
- ✓ UNICEF përmes bashkëpunimit me Save the Children dhe fonde të MPJ të Norvegjisë ka trajnuar 62 profesionistë të disiplinave të ndryshme lidhur me menaxhimin ndër-sektorial të rasteve të fëmijëve të shoqëruara me asistencë teknike për profesionistët e strukturave të mbrojtjes së fëmijës dhe të drejtësisë për të mitur në nivel vendor, në Berat dhe Gjirokastrë.
- ✓ Shërbimi i Provës ngriti grupin e punës mbi dhënien e kontributit për ngritjen e Sistemit. Grupi i Punës ka marrë pjesë në disa takime me ekspertët. Gjithashtu, ai zhvilloi dy aktivitete në kuadër të Programit Shqiptar-Suedez për Drejtësinë për të Mitur: trajnimi mbi përdorimin e vlerësimit të Riskut dhe Nevojave dhe aktivitete mentorimi.
- ✓ Specialistë dhe lektorë nga Akademia e Sigurisë kanë marrë pjesë në dy seminare “*Për hartimin e kurrikulave mbi teknikat e intervistimit të të miturve*”. Në përfundim të seminareve u mundësua hartimi i programit mësimor dhe kurrikulës së një trajnimi dy javor për “*Teknikat e intervistimit shkencor të të miturve*”.
- ✓ Këshilli i Lartë i Prokurorisë në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, vijuan me trajnimin e prokurorëve dhe forcimin e seksioneve për të miturit në prokurori, si dhe trajnimin vazhdues të oficerëve të policisë gjyqësore.
- ✓ Janë krijuar seksione në 11 Prokurori të Shkallës së Parë me juridiksion të përgjithshëm.

- ✓ Përgjatë vitit 2020 është bërë e mundur trajnimi i 80% të stafit të Institucionit për të Mitur në Kavajë, sipas kurrikulës së hartuar me mbështetjen e KiE në vitin 2018 – 2019.
- ✓ Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka hartuar programin mësimor dhe Kurrikulën “Për teknikat shkencore të intervistimit të të miturve”.
- ✓ Përgjatë vitit 2020 Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve ka bërë të mundur trajnimin në masën 80% të specialistëve, më shumë se vitin 2019, sipas kurrikulës së trajnimit.
- ✓ Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka organizuar takim online mes ASHMDF, UNICEF dhe punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve, si dhe takime në 5 bashki për promovimin e Udhëzuesit për pjesëmarrjen e fëmijëve, të miratuar me Urdhër të Ministrit të MSHMS. Në këto takime kanë marrë pjesë NJMF, mësues, psikologë shkollor, punonjës social nga qendrat e ndryshme të shërbimeve sociale në bashki.
- ✓ UNICEF ka mbështetur Ministrinë e Drejtësisë për ngritjen e infrastrukturës së Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur. Për këtë UNICEF, Ministria e Drejtësisë dhe AKSHI hartuan Termat e Referencës, specifikimet teknike dhe kostuan përshtatjen e prototipit dhe mirëmbajtjen e sistemit.



3.3 Objektivi 3: Parandalimi i ri-përfshirjes të të miturve/të rinjve në krime.

Për realizimin e këtij objektivi planifikohet të analizohen faktorët e riskut dhe masat mbrojtëse. Duke pasur parasysh se kjo është Strategjia e parë për Drejtësinë për të Mitur, objektivi fokusohet në mënyrë të veçantë tek ngritja dhe vënia në funksionim e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve si dhe tek programet për parandalimin e ripërfshirjes së të miturve në vepra penale (*recidivizmit*) të cilat do të kenë në qendër të vëmendjes mbështetjen për fëmijët dhe familjet, veçanërisht fëmijët nën moshën e përgjegjësisë penale dhe grupeve në risk apo të cënueshme. Parandalimi i krimit është zgjidhja më e mirë për fëmijët, familjet e tyre, komunitetet dhe shoqërinë në tërësi.

Janar–Dhjetor 2020		
Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit 3	Numri i aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 3
Të realizuara	1	25%
Në proces	1	25%
Të përealizuara	2	50%

Totali	4	100%
---------------	----------	-------------

Numri i aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 3



Rezulton se nga 4 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për këtë objektiv, 1 është realizuar, 1 është ende në proces zbatimi dhe 2 aktivitete të perealizuara nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv

është në nivelin 25% për aktivitetet të cilat janë të realizuara, 25% për aktivitete në proces dhe 50% për aktivitete të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet përgjegjëse.

Për përlogaritjen e realizimit të objektivit strategjik 3, sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të aktiviteteve është përdorur formula si më poshtë:

$$\text{NR 3} = \frac{\text{TP Akt 1 (100\%)} + \text{TP Akt 2 (50\%)} + \text{TP Akt 3 (0\%)} + \text{TP Akt 4 (0\%)}}{4 \text{ TP Akt}} \times 100\% = 37.5\%$$

Niveli i realizimit të *Objektivit 3. Parandalimi i ri-përfshirjes së të miturve/të rinjve në krime* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës së aktiviteteve për periudhën janar - dhjetor 2020 është **37.5%**.

Shkalla e realizimit të objektivit strategjik 3 për këtë periudhë raportimi në lidhje me zbatimin e aktiviteteve është **mjaftueshëm** (31-50 për qind e aktiviteteve të realizuara).

Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2020.

- ✓ Ministria e Drejtësisë ka vijuar procesin e punës për krijimin dhe funksionimin e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve.
- ✓ Zyra e Komisionerit dhe stafi i shkollës realizuan një cikël trajnues gjatë muajit Janar 2020, për njohjen me parimet kryesore të garantimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.
- ✓ Janë miratuar draft programe rehabilituese, edukuese, integruese për trajtimin e të miturve, 6 muaj para përfundimit të lirimit dhe 6 muaj ndjekje pas lirimit. Programet janë hartuar nga asistenca teknike e ofruar nga UNICEF.
- ✓ Departamenti i Administratës Publike ka miratuar përshkrimet e punës për pozicionet në strukturë të Qendrës Për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Gjithashtu, ka hartuar metodologjinë e klasifikimit për pozicionet e punës të QPKMR në përputhje me VKM Nr.142 datë 12.3.2014, i ndryshuar deri në fund të dhjetorit 2020. DAP ka shpallur në faqen zyrtare 13 pozicione pune sipas strukturës së QPKMR (3 përgjegjës sektori dhe 10 specialist).


3.4 Objektivi 4: Rishoqërimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin.

Strategjia synon riintegrimin dhe përfshirjen sociale të të miturve autorë të veprave penale dhe përfshirjen efektive të tyre në komunitet. Qëllimi i këtij objekti është rehabilitimi i të miturve, inkurajimi dhe zhvillimi, në kuptim të përgjegjësisë së të miturit, e ndjenjës së respektimit të të drejtave të të tjerëve, nxitja dhe mundësimi i zhvillimit të shëndoshë fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror i të miturit dhe për ta përgatitur atë që të rikthehet në shoqëri.


Strategjia parashikon që realizimin e këtij objekti ta masë nëpërmjet: i) numrit të fëmijëve dhe të familjeve të përfshira në programet e ri-integrimit; ii) numrit të fëmijëve të dënuar me burgim dhe me masa alternative dhe numrin e fëmijëve ndaj të cilëve janë zbatuar masat alternative të shmangies nga ndjekja penale.

Numri i aktiviteteve në zbatim sipas objektit 4

Janar - Dhjetor 2020		
Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektit 4	Numri i aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektit 4
Të realizuara	5	62%
Në proces	3	38%
Të porealizuara	0	0%
Totali	8	100%



Përqindja e statusit të aktiviteteve



Rezulton se nga 8 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për këtë objekt, 5 janë realizuar dhe janë ende në proces zbatimi nga institucionet përgjegjëse 3 aktivitete të tjera. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objekt është në nivelin, 62% aktivitetet e realizuara dhe 38% aktivitetet të cilat janë në proces nga institucionet përgjegjëse.

Për përllogaritjen e realizimit të objektivit strategjik 4, sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të aktiviteteve është përdorur formula si më poshtë:

$$\text{NR 4} = \frac{\text{TP Akt 1 (100\%)} + \text{TP Akt 2 (50\%)} + \text{TP Akt 3 (100\%)} + \text{TP Akt 4 (50\%)} + \text{TP Akt 5 (100\%)} + \text{TP Akt 6 (50\%)} + \text{TP Akt 7 (100\%)} + \text{TP Akt 8 (100\%)}}{8 \text{ TP Akt}} \times 100\% = 81.3\%$$

Niveli i realizimit të *Objektivit 4. Rishoqërimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës së aktiviteteve për periudhën janar - dhjetor 2020 është **81.3%**.

Shkalla e realizimit të objektivit strategjik 4 për këtë periudhë raportimi në lidhje me zbatimin e aktiviteteve është **mirë** (51-85 për qind e aktiviteteve të realizuara).

Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2020.

- ✓ Këshilli i Lartë Gjyqësor në bashkëpunim të ngushtë me CSSP - Berlin Center for Integrative Mediation ka ngritur dy Qendra Ndërmjetësimi, në kuadër të projektit "*Forcimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri*". Qendra e Ndërmjetësimit në Durrës ka aktivizuar

aktivitetin në vitin 2019, ndërsa Qendra e Ndërmjetësimit në Tiranë është hapur në maj 2020 dhe gjatë vitit 2020 janë vetë-referuar 2 raste në Qendër, të cilat janë zgjidhur me sukses.

- ✓ Në kuadër të reformës së drejtësisë miqësore për të miturit, Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar **15 marrëveshje** bashkëpunimi me pushtetin vendor.
- ✓ Qendra (Zyra) e Zhvillimit për Drejtësinë Penale për të Miturit në Prokurori, përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, "Sida" po përgatit një manual udhëzues për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore për çështjet penale me të miturit në konflikt me ligjin si dhe modele të unifikuara aktesh procedurale edhe është draftuar edhe një material informues për njohjen e të miturit me masën alternative të shmangies, material që është duke u diskutuar me ekspertët e projektit "Sida".
- ✓ Të dhënat statistikore tregojnë se gjatë vitit 2020 nga NJMF në bashki raportohet *se janë marrë në mbrojtje 38 raste të fëmijëve në konflikt me ligjin.*
- ✓ Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë ka zhvilluar 13 trajnime/seminare në kuadër të drejtësisë penale për të mitur si dhe ka rritur bashkëpunimin mes shkollave dhe qendrave Komunitare Multifunkionale duke synuar ndërgjegjësimin për të parandaluar fenomenin e dhunës kundër të miturve dhe grave në grupet vulnerabël përmes përfshirjes në aktivitete artistike.
- ✓ Shërbimi i Provës ka caktuar 25 punonjës të cilët trajtojnë çështjet e të miturve në konflikt me ligjin.
- ✓ Me synim garantimin e një kuadri institucional që nxit dhe lehtëson edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve në institucionet e paraburgimit dhe burgimit, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka realizuar sesione informuese mbi të drejtat e të miturve dhe aplikimin e drejtësisë miqësore. Gjithashtu, gjatë vitit 2020 janë trajtuar me Plane të Individualizuara në total **50 të mitur.**
- ✓ UNICEF në partneritet me Save the Children ka bërë të mundur që 296 fëmijë të Beratit dhe Gjirokastrës të cilët ishin në konflikt ose kontakt me ligjin, të jenë pjesë e një serie shërbimesh këshillimi dhe mbështetjeje në procesin e tyre të mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegrimin në komunitet.


3.5 Objektivi 5: Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të mitur.

Vlerësohet se; kusht thelbësor për implementimin në mënyrën e duhur dhe efektive të të drejtave dhe garancive të fëmijëve është bashkëpunimi, ndërveprimi dhe bashkërendimi i institucioneve dhe autoriteve në nivel qendror dhe vendor të përfshira në administrimin e drejtësisë për të mitur.

Rrjedhimisht strategjia parashikon ngritjen dhe funksionimin e rrjetit ndërinstitucional në nivel qendror dhe funksionimin e komunitetit të praktikantëve në nivel vendor.

Numri i aktiviteteve në zbatim sipas objektivit 5

Janar - Dhjetor 2020		
Statusi i zbatimit të aktiviteteve të Objektivit 5	Numri i aktiviteteve	Përqindja ndaj totalit të Objektivit 5
Të realizuara	2	100%
Në proces	0	0%
Të porealizuara	0	0%
Totali	2	100%





Rezulton se nga 2 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për këtë objektiv janë realizuar nga institucionet përgjegjëse. Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit për këtë objektiv është 100 % realizuar.

Për përlogaritjen e realizimit të objektivit strategjik 5, sipas arritjes së vlerës vjetore të treguesit të aktiviteteve është përdorur formula si më poshtë:

$$\text{NR 5} = \frac{\text{TP Akt 1 (100\%)} + \text{TP Akt 2 (100\%)}}{2 \text{ TP Akt}} \times 100\% = 100\%$$

Niveli i realizimit të *Objektivit 5. Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të mitur* në lidhje me realizimin e treguesve të performancës së aktiviteteve për periudhën janar - dhjetor 2020 është **100%**.

Shkalla e realizimit të objektivit strategjik 3 për këtë periudhë raportimi në lidhje me zbatimin e aktiviteteve është **shumë mirë** (86-110 për qind e aktiviteteve të realizuara).

Informacioni i mëposhtëm për periudhën janar - dhjetor 2020.

- ✓ Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit institucional, Ministria e Drejtësisë më datë 17.12.2020 ka organizuar Konferencën “*Fuqizimi i sistemit të drejtësisë miqësore për të miturit në Shqipëri*”.
- ✓ KLGJ ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Administratën e Gjykatave Kombëtare në Suedi për mbështetjen e drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri. Projekti

shtrihet nën programin “*Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese dhe gjykatave shqiptare për të përmbushur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut lidhur me drejtësinë për të miturit, një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë*”.


- ✓ Është hartuar dhe miratuar Programi i Punës Nr.1737, datë 04.03.2020, “*Për zbatimin e masave dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga “Plani Kombëtar i Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019 – 2021*”, në të cilin janë parashikuar detyra konkrete për strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit.
- ✓ UNICEF ka mbështetur krijimin e dy grupeve të komunitetit të praktikantëve, përkatësisht në Berat dhe në Gjirokastrë për t’u bërë bashkë për trajtimin e rasteve të fëmijëve në konflikt ose në kontakt me ligjin.
- ✓ Ministria e Drejtësisë ka hartuar një plan pune të përbashkët me OJF dhe donatorë të ndryshëm të cilët ofrojnë shërbime të specializuara dhe trajnime në fushën e drejtësisë penale për të mitur me qëllim mbulimin dhe rakordimin e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në këtë strategji.
- ✓ Zyra e Komisionerit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar zhvilluan Fushatën Kombëtare “Luaj dhe mëso–Happy Onlife” që prej muajit tetor 2020 e në vijim. Gjithashtu, përgjatë periudhës tetor-dhjetor 2020 u zhvilluan 22 takime me karakter informativ dhe ndërgjegjësues në shkolla 9-vjeçare në 21 qytete të vendit.

3.6 Krahasim mbi Progresin e zbatimit të Planit të Veprimit për vitet 2019 dhe 2020


Në kuadër të ecurisë dhe zbatueshmërisë, më poshtë do të pasqyrohet progresi i arritur në drejtim të objektivave strategjike, objektivave specifike dhe masave/aktivitete të Planit i Veprimit 2018-2021.

Objektivat	Të realizuara	Në proces	Të porealizuara
TOTALI 2019	10	13	2
TOTALI 2020	15	7	2

Statusi i zbatimit të aktiviteteve për vitet 2019-2020



PROGRESI I ZBATIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT 2019-2020



Më konkretisht, ecuria e progresit në periudhën janar-dhjetor për vitin 2019 dhe 2020 është si më poshtë vijon:

- *Për periudhën janar – dhjetor 2019 nga 25 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë janë realizuar 10 prej tyre, 13 janë ende në proces zbatimi, 2 aktivitete të porealizuara.* Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit është në nivelin 40% për aktivitetet të cilat janë të realizuara, 52% për aktivitetet në proces, 8% për aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet.
- *Për periudhën janar – dhjetor 2020 nga 24 aktivitete të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë janë realizuar 15 prej tyre, 7 janë ende në proces zbatimi, 2 aktivitete të porealizuara.* Përqindja ndaj totalit të progresit të zbatimit të Planit të Veprimit është në nivelin 62% për aktivitetet të cilat janë të realizuara, 30% për aktivitetet në proces, 8% për aktivitetet të cilat do të zbatohen në vijim nga institucionet.

Për sa më sipër, konstatohet se aktivitetet e realizuara rezultojnë të jenë në rritje, aktivitetet në proces realizimi në rënie dhe aktivitetet e porealizuara rezultojnë të jenë të njëjta për të dyja vitet.

Bazuar në informacionin e sipërpërmendur, realizimi i objektivave për periudhën e raportimit Janar-Dhjetor 2020 është si më poshtë vijon:

- ❖ Dobët (Nga 0 në 30 për qind e masave të realizuara)
- ❖ Mjaftueshëm (Nga 31 në 50 për qind e masave të realizuara)
- ❖ Mirë (Nga 51 deri në 85 për qind e masave të realizuara)
- ❖ Shumë mirë (Nga 86 deri në 110 për qind e masave të realizuara)
- ❖ Tejkalluar – N/A objektiv (Nga 111 për qind e masave të realizuara dhe më lart)

Vlerësimi për progresin për çdo objektiv paraqitet në tabelën më poshtë:

Objektivat	Shkalla e Realizimit në %	Niveli i Tolerancës	Realizueshmëria
Objektivi 1: <i>“Garantimi i aksesit të të miturve në drejtësi.”</i>	83.3 %	51 në 85 për qind e masave të realizuara	Mirë
Objektivi 2 : <i>“Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit”</i>	85.7 %	86-110 për qind e masave të realizuara	Mirë
Objektivi 3 <i>“Parandalimi i ri-përfshirjes të të miturve/të rinjve në krime”</i>	37.5 %	31 në 50 për qind e masave të realizuara	Mjaftueshëm
Objektivi 4 <i>“Rishoqërim, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin”</i>	81.3 %	51 në 85 për qind e masave të realizuara	Mirë
Objektivi 5 <i>“Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të mitur”</i>	100%	Nga 86 deri në 110 për qind e masave të realizuara	Shumë mirë

IV.HISTORI SUKSESI (PËRMES MASAVE PRIORITARE) DHE ZBATIMI I PROJEKTEVE DHE PROGRAMEVE NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR

Ndihma juridike për të miturit

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më themelore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesimi në drejtësi¹ për të gjithë të miturit në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor.

Ligji nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”, në referim të nenit 11 të tij, tashmë i ka cilësuar të miturit si *subjekte të posaçme të cilët*² pavarsisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore dhe konkretisht:

- *Të miturit viktime të dhunës në familje;*
- *Të miturit viktime të abuzimit seksual dhe të miturit viktime të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;*
- *Viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;*
- *Fëmijët të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;*
- *Fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor.*

Forcimi i kapaciteteve dhe specializimi në sistemin e drejtësisë për të mitur: Duke ritheksuar edhe njëherë mbrojtjen e interesave më të lartë të fëmijëve është detyrim ligjor që juristët/avokatët që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike falas *të jenë të specializuar në sistemin e drejtësisë për të mitur*

¹*Reforma në Drejtësi* përpos të gjitha ndryshimeve madhore që solli në reformimin e sistemit të drejtësisë, *i kushtoi një rëndësi thelbësore aksesit në drejtësi të qytetarëve*, komponent ky shumë i rëndësishëm edhe në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian. *Ligji nr.111/2017 “Për Ndhmën Juridike të Garantuar nga Shteti”*, solli një reformim të thellë të sistemit të ndihmës juridike *duke sjellë një frymë të re sa i përket organizimit, funksionimit dhe ofrimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti*. Qëllimi kryesor i këtij ligji është dhënia e ndihmës juridike falas për të gjitha kategoritë, të cilat për shkak të kushteve në të cilat ndodhen e kanë të pamundur sigurimin e këtij shërbimi. I është kushtuar një vëmendje e veçantë kategorive përfituese duke patur në fokus *zgjerimin e rrethit të subjekteve si dhe sanksionimin e grupeve vulnerablë si përfitues të drejtpërdrejtë* nga sistemi i ndihmës juridike falas.

²Gjithashtu, duhet të theksojmë se ofrimi i ndihmës juridike falas për të miturit si kategori e posaçme ofrohet jo vetëm për shtetasit shqiptarë, por edhe për shtetasit e huaj, konkretisht, në nenin 10 të ligjit 111/2017, parashikohen si përfitues të ndihmës juridike falas edhe:

- Të miturit shtetas të huaj ose të miturit pa shtetësi të cilët qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të përkohshme ose të përhershme dhe janë të pajisur me leje qëndrimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt;
- Të miturit shtetas të huaj ose të miturit pa shtetësi që hyjnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që përfitojnë mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë ose bazuar në parimin e reciprocitetit;
- Të miturit azilkërkuar, si dhe ata që gëzojnë statusin e refugjatit apo që janë në proces ankimi të vendimeve administrative dhe/ose gjyqësore për refuzimin e aplikimit për azil ose revokimin e vendimit të statusit të refugjatit, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë.

përmes ndjekjes së trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme të organizuara nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas/Departamenti i Administratës Publike/Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Forcimi i kapaciteteve përmes përmirësimit të kuadrit profesional është një ndër prioritetet që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka në funksion të garantimit të një shërbimi juridik eficient dhe cilësor. Për këtë qëllim, Drejtoria është në bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerë ndërkombëtarë të cilët mbështesin³ Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas përmes implementimit të projekteve të ndryshme në këtë kuadër. Përmendim këtu: Soros, UNDP, Euralius etj.

Ndërgjegjësimi dhe edukimi ligjor i publikut⁴/ promovimi i sistemit të ndihmës juridike: Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitimin e saj përveçse një detyrimi ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017) është një nga komponentët më thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi, DNJF i ka kushtuar një vëmendje të shtuar zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukimit ligjor të publikut duke hartuar kalendarin e aktiviteteve si dhe një plan konkret pune. Përgjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti, DNJF ka zhvilluar disa aktivitete⁵ që kanë në fokus ndërgjegjësimin dhe edukimin ligjor të publikut, jo vetëm duke u përqëndruar tek sistemi i ndihmës juridike falas, por duke u ndalur edhe në informimin ligjor të publikut përmes faqes zyrtare të dedikuar të drejtorisë, rrjeteve sociale dhe videove informuese.

Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte dhe Aktiviteti “*Akresi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin*” i cili u zhvillua me qëllim ndërgjegjësimin e të miturve pranë Qendrës së Ri-Integritit të të Miturve Kavajë. Ky aktivitet u zhvillua në 3 grupe të ndryshme sipas grupmoshave të të miturve, ku përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën mundësinë të bashkëbisedonin me të miturit e kësaj qendre duke i shpjeguar në mënyrë të thjeshtëzuar se si ata apo prindërit e tyre mund të përfitonin nga shërbimet ligjore falas⁶.

³Një nga format e mbështetjes dhe bashkëpunimit janë **trajnimet** që do të ofrohen nga këta donatorë për ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Në këtë kuadër, një aktor kryesor i përfshirë është edhe Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë si organ i parashikuar në ligj për zbatimin e tij në kuadër të ndihmës juridike dytësore dhe për trajnimin e vazhdueshëm të avokatëve, ofrues të ndihmës juridike dytësore.

⁴Sa i përket ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut, DNJF ka parashikuar një sërë masash dhe aktiviteteve konkrete në zbatim të Strategjisë për Edukimin Ligjor të Publikut dhe Planit të saj të Veprimit. Angazhimi i DNJF në disa strategji të rëndësishme, ndër-institucionale tregon jo vetëm rëndësinë dhe rolin që ky institucion ka por ka shërbyer gjithashtu për të forcuar edhe më shumë përpjekjet në këtë kuadër.

⁵Një pjesë e tyre u pezulluan për shkak të gjendjes së pandemisë.

⁶Nga ana e stafit të DNJF u përgatitën disa materiale të cilat u vendosën në dispozicion të të miturve për të garantuar informimin e plotë të tyre, ndërgjegjësimin mbi të drejtat që gëzojnë në kuadër të sistemit të ndihmës juridike falas dhe më gjerë dhe mënyrës/rrugës që duhet ndjekur për të ushtruar këto të drejta. Materialet e përgatitura siguronin informacion në gjuhë të thjeshtë (jo teknike), të kuptueshme dhe të qartë mbi sistemin e ndihmës juridike falas, kushtet e përfitimit, mënyrës së aplikimit dhe ofruesit e këtij shërbimi. Konkretisht, materialet që u përgatitën në kuadër të këtij sesioni informues janë si vijon:

Në funksion të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor DNJF ka realizuar disa fushata ndërgjegjësimi në qytete të ndryshme në të cilat ka shpërndarë fletëpalosje, manuale për ndihmën juridike të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike dhe ka afishuar postera në disa institucione të ndryshme.

Fushatat e ndërgjegjësimit janë realizuar në qytetet e Tiranës, Fierit, Durrësit, Lezhës dhe Shkodrës. Fushatat e ndërgjegjësimit do të vijojnë edhe në qytetete të tjera përgjatë vitit 2021.

Gjithashtu, në funksion të këtij objekti janë zhvilluar takime/seminare të lidhura direkt me grupet vulnerabël konkretisht:

- *Takim informues me qytetarë të komunitetit Romë dhe Egjiptian në Shkozë, Tiranë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Nëntor 2020.*

DNJF organizoi një takim me qytetarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian në zonën e Shkozës, Tiranë, bashkë me përfaqësuesit e Klinikës Ligjore Wisdom, me të cilët është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi. Pjesëmarrësit, si një ndër kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti u informuan mbi të drejtat që ligji për ndihmën juridike u garanton dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike falas. U zhvillua një bashkëbisedim mbi problematikat ligjore të qytetarëve, të cilat do të adresohen për t'u trajtuar në Klinikën e Ligjit Wisdom dhe Qendrën e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore, Tiranë.

Ofrimi i shërbimit ligjor falas gjatë periudhës së pandemisë: Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas ka mundësuar për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore. Përgjatë vitit 2020, përmes kësaj platforme **kanë përfituar shërbim ligjor falas 1524 qytetarë**.

-
- Manual për ndihmën juridike të garantuar nga shteti me informacion të koncentruar në një gjuhë të thjeshtë për shërbimin ligjor falas, subjektet përfitues, mënyra e aplikimit dhe ku të drejtohen për të përfituar;
 - Fletëpalosje /poster informues;
 - Pyetësor për njohuritë mbi të drejtat dhe detyrimet, efektiviteti i sesionit informues dhe nevoja për aktivitete të tjera në këtë kuadër.

Gjithashtu, ky aktivitet shërbeu dhe ju dha mundësinë të miturve për marrë çdo lloj informacioni për të cilin ata kishin nevojë.

Kuvendi për të miturit

Kuvendi i Shqipërisë e konsideron fëmijën një individ me të drejta të barabarta e të patjetërsueshme në shoqëri, trajtimi i të cilit duhet të ketë në fokus garantimin e zbatimit të parimeve universale dhe udhëheqëse të të drejtave të fëmijës si: mosdiskriminimi, mbijetesa, zhvillimi si dhe interesi më i lartë i fëmijës. Kuvendi njeh detyrimin e shtetit për të mbrojtur, respektuar dhe promovuar të drejtat e fëmijës që burojnë nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës e OKB-së, konventat e Këshillit të Europës, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara prej tij dhe nga legjislacioni i brendshëm. Për këtë qëllim Kuvendi, në legjislaturën e kaluar ka ngritur Grupin e Deputetëve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve, si një grup *ad-hoc* avokatësie të parlamentarëve, që do të nxisin Kuvendin e Shqipërisë për shqyrtimin e nismave dhe veprimeve në mbështetje dhe në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit nga Kuvendi

Në datën 22 janar 2018, Kuvendi i Shqipërisë dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit, ndërmjet të cilit angazhohen së bashku në partneritet për përparimin e të drejtave të fëmijëve. Ky dokument shumë i rëndësishëm u nënshkrua nga Kryetari i Kuvendit, SH.T. Z Gramoz Ruçi dhe përfaqësuesi i UNICEF-it, Dr. Ezio Gianni Murzi. Memorandumi ka për qëllim të vendosë bashkëpunimin institucional mes **Palëve**, me synim forcimin e rolit ligjvënës, kontrollues dhe ndërgjegjësues të Kuvendit, komisioneve të tij të përhershme dhe të posaçme, nënkomisioneve parlamentare, përfshirë grupin e deputetëve “*Miqtë e Fëmijëve*”, në çuarjen përpara të të drejtave të fëmijëve.

Nëpërmjet këtij Memorandumi **Palët** angazhohen me detyrime konkrete në nxitjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijëve, hartimin e ligjeve me fokus këto të drejta, bashkërendimin me qeverinë për realizimin e këtyre të drejtave, në përputhje me standardet ndërkombëtare të cilave i përmbahet shteti shqiptar.

Veprimtaria e Grupit të Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” gjatë vitit 2020

Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” (GDMF) është grupim parlamentar vullnetar i deputetëve dhe nuk ka natyrë politike. Ai përbëhet nga deputetë të të gjithë grupeve parlamentare që shprehin dëshirën për të kontribuar në adresimin e të drejtave të fëmijëve dhe realizimin e tyre në një mënyrë efektive gjatë ushtrimit të funksioneve legjislative të Kuvendit, kontrollit parlamentar dhe gjatë diskutimit dhe miratimit të buxhetit të shtetit.

GDMF është i organizuar në gjashtë komitete si më poshtë:

1. Komisioni për drejtësi për të mitur;
2. Komisioni për bashkëpunim me OJQ-të;
3. Komisioni për shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve;
4. Komisioni për fëmijët e vendosur në institucionet publike;
5. Komisioni për buxhetim për fëmijët;
6. Komisioni për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna.

Gjatë vitit 2020, vijoi puna për realizimin e objektivave të parashikuara në **Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e punës së grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve” për vitin 2019 dhe për planin e veprimit për vitin 2020**, ku GDMF vazhdoi të kontribuojë në përmirësimin e të drejtave të fëmijëve në kontekstin e ri të kufizimeve, nëpërmjet kontrollit të ushtruar mbi institucionet që kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

- ✓ U miratuan shtesa e ndryshime në disa akte ligjore; vijoi monitorimi i zbatimit të politikave të qeverisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve si dhe u organizuan dëgjesa me të rinj dhe fëmijë në lidhje me të drejtat dhe nevojat e tyre.
- ✓ GDMF kontriboi në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes miratimit të legjislacionit të kontrollit të qeverisë për zbatimin efektiv të masave për mbrojtjen e fëmijëve.
- ✓ U angazhua duke organizuar dëgjesa me Institucionet si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Avokati i Popullit për të vlerësuar në këtë mënyrë ndikimin e pasojave të pandemisë dhe tërmetit të Nëntorit 2019 në situatën e fëmijëve dhe të familjeve të varfëra duke nxitur vijimin e pandërprerë të shërbimeve tek fëmijet, lidhur me shëndetësinë, arsimin dhe mbrojtjen shoqërore.
- ✓ GDMF shqyrtoi ecurinë e mësimin online për nxënësit e nivelit parauniversitar dhe mbështetjen e nxënësve nga familjet në nevojë.
- ✓ Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut zhvilluan një diskutim mbi ndryshimet në Kodin Penal për të adresuar dhunën me bazë gjinore dhe dhunën seksuale ndaj fëmijëve.
- ✓ Gjatë vitit 2020, GDMF vijoi bashkëpunimin me institucione të administratës publike, institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut, partnerë ndërkombëtarë, shoqërinë civile vendase dhe ndërkombëtare, botën akademike, median, grupet e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe ekspertë apo grupe interesi në fushën e të drejtave të fëmijëve.

- ✓ E gjithë veprimtaria e Grupit të Deputetëve “*Miqtë e fëmijëve*”, është e publikuar në faqen Kuvendit të Shqipërisë: <https://www.parlament.al/Kuvendi/KuvendiPerFemijet>

Ministria e Drejtësisë ka vijuar koordinimin e aktiviteteve me Organizatat Ndërkombëtare në fushën e drejtësisë penale për të mitur me qëllim zbatimin e programeve përkatëse.

➤ UNICEF

Në kuadër të ofrimit të ndihmës juridike për përfituesit e mitur për të patur një shërbim të shpejtë, profesional dhe efektiv, UNICEF mbajti një sesion informues lidhur me situatën e të miturve në konflikt dhe kontakt me ligjin duke theksuar si mund të kontribuojnë avokatët e të miturve në ndryshimin pozitiv në treguesit e Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë për të Mitur dhe në vetë jetën e këtyre fëmijëve. Me mbështetjen e UNICEF-it dhe fonde të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, Ambasadës së Norvegjisë si dhe Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar u rikonstruktuan, mobiluan, dhe u përshtaten 7 drejtori rajonale të policisë ku u bë e mundur krijimi i një ambienti miqësor për të miturit. Për përdorimin e mjediseve dhe pajisjeve të instaluara në to UNICEF ka trajnuar rreth 20 përfaqësues të drejtorive rajonale të policive.

UNICEF ka advokuar me KLGJ-në dhe KLP-në për nxjerrjen e akteve të nevojshme si dhe zbatimin e tyre lidhur me rritjen e numrit të prokurorëve, punonjësve të policisë, gjyqtarëve, e profesionistëve të tjerë të sektorit të drejtësisë që caktohen për t’u specializuar dhe për të punuar me të miturit. Si rezultat, nga informacionet që disponojmë ky numër është rritur nga 12 gjyqtarë dhe prokurorë në vitin 2018 (që ka qenë para fillimit të zbatimit të kësaj Strategjie) në 143 në 2020.

Në partneritet me Save the Children dhe fonde të MPJ-së të Norvegjisë janë trajnuar 62 profesionistë të disiplinave të ndryshme lidhur me menaxhimin ndër-sektorial të rasteve të fëmijëve në konflikt dhe në kontakt me ligjin në qarkun e Beratit dhe të Gjirokastrës.

Në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë si dhe përfaqësuesit e institucioneve të zbatimit të ligjit, ato të drejtësisë dhe institucione të tjera të kujdesit dhe mbrojtjes ndaj fëmijëve në Berat dhe Gjirokastrë ka hartuar Udhërrëfyesin për ndërveprimin mes institucioneve dhe profesionistëve të disiplinave të ndryshme për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt ose në kontakt me ligjin. Udhërrëfyesi është pajisur edhe me një kuadër logjik të thjeshtë që lehtëson përdorimin nga profesionistët e menaxhimit të rastit. Ai është pilotuar për rreth 1 vit e gjysmë në Berat dhe në Gjirokastrë dhe është plotësuar me reflektime që kanë dalë nga ky pilotim.

UNICEF ka mbështetur Ministrinë e Drejtësisë për ngritjen e infrastrukturës së Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur. Për këtë UNICEF, Ministria e Drejtësisë dhe AKSHI hartuan Termat e Referencës, specifikimet teknike dhe kostuan përshtatjen e prototipit dhe mirëmbajtjen e sistemit. U identifikua një zhvillues, Qendra për Vlerësim, Menaxhim dhe Trajnim dhe u konsultuan përfaqësues nga të 6 institucionet e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë të cilat do të jenë përdoruesit e sistemit, deri në finalizimin e përmbajtjes së rubrikave sipas kërkesave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë për të Mitur. Sistemi u hostua nga AKSHI dhe është tani më i vendosur në adresën: www.drejtisipertemitur.gov.al.

Janë realizuar dy analiza, një lidhur me mekanizmat ligjorë dhe institucional, konkretisht me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi, veçanërisht ai online, si dhe një tjetër lidhur me kuadrin ligjor që ndikon në institucionalizimin apo deinstitutionalizimin e fëmijëve. Këto analiza kanë orientuar punën e Ministrisë së Drejtësisë si dhe të Komitetit të Birësimeve lidhur me disa propozime ligjore që ndikojnë në të drejtën e fëmijës për familje. Gjithashtu, ka mbështetur Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e disa dokumentave bazë që do të orientojnë punën e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Ato do të shërbejnë si themeli i ngritjes së këtij institucioni dhe realizimit të misionit të saj gjatë viteve të para të ekzistencës së tij. Aktualisht, po vijon procesi i rekrutimit të punonjësve të kësaj Qendre. Në partneritet me Save the Children ka mbështetur 97 fëmijë për realizimin e proceseve të ndërmjetësisimit viktimë-dëshmitar në Berat dhe Gjirokastrë. Ndërkaq 375 fëmijë të tjerë, kryesisht nxënës të shkollave të mesme dhe të ciklit të lartë, të shkollave 9-vjeçare në Berat dhe Gjirokastrë kanë marrë pjesë në sesione informuese lidhur me drejtësinë restauruese si metodë për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Ky informim është një investim direkt në uljen e kriminalitetit ose të konflikteve të dhunshme.

UNICEF (me mbështetjen financiare të MPJ-esë të Norvegjisë) dhe në partneritet me Save the Children ka bërë 296 fëmijë të Beratit dhe Gjirokastrës, të cilët ishin në konflikt ose kontakt me ligjin, pjesë të një serie shërbimesh këshillimi dhe mbështetjeje në procesin e tyre të mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegritimit në komunitet. Kështu, 79 prej tyre kanë marrë këshillim dhe përfaqësim ligjor; 113 kanë marrë këshillim ose ndjekje terapeutike me psikolog. Në bashkëpunim me Bashkinë Berat dhe Gjirokastrë, UNICEF dhe Save the Children identifikuan dy qendra komunitare të cilat të mund të përdoren edhe për të lehtësuar masën e shmangies për disa të mitur. Po ashtu, UNICEF advokoi vazhdimisht gjatë zbatimit të ndërhyrjes në Berat dhe

Gjirokastrë që këto mjedise neutrale, jo frikësuese dhe jo stigmatizuese të përdoren edhe si vend-takime mes fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin dhe profesionistët e ndryshëm që merreshin me menaxhimin e rasteve të tyre, në vend që takimet të kryheshin në zyrat përkatëse të këtyre profesionistëve.

Gjatë ndërhyrjes së UNICEF dhe Save the Children në Berat dhe Gjirokastrë (fonde të MPJ-esë të Norvegjisë), 6 punonjës të zyrave vendore të shërbimit të provës janë ndihmuar për ndjekjen e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin, qoftë gjatë masave të shmangies, qoftë gjatë zbatimit të dënimeve alternative.

➤ **WORLD VISION**

Duke marrë parasysh numrin e lartë të fëmijëve të raportuar të cilët janë në kontakt ose në konflikt me ligjin në zonën e Kurbinit dhe Laçit, World Vision Albania ka mbështetur krijimin e dy hapësirave miqësore brenda komisariatit në Lezhë dhe Kurbin, punë e cila nisi që në vitin 2019, dhe vazhdoi përgjatë vitit 2020 me rritjen e kapaciteteve të punonjësve. Kjo ndërhyrje vjen si vijimësi e krijimit të dy hapësirave të para miqësore të ndërtuara në Komisaratin numër 5 në Kamëz dhe atë numër 6 në Tiranë. Në Kurbin, gjatë vitit 2020 u njoftua vetëm për dy raste të asistuara dhe më pas hapësira miqësore nuk u përdor për shkak të dëmtimeve të tërmetit të 26 nëntorit 2019. Në Lezhë dhe Kamëz ka pasur 32 raste të fëmijëve në kontakt dhe/ose në konflikt me ligjin që janë asistuar brenda Hapësirës Miqësore. Kryesisht rastet e dhunës dhe abuzimit seksual janë ato më prevalentet në rastet e fëmijëve që kanë qenë në kontakt dhe/ose konflikt me ligjin. Me bashkëpunimin e organizatës Nisma për ndryshim shoqëror - ARSIS, World Vision Albania ka ofruar nga 2 trajnime/sesione për Oficerët e Policisë Gjyqësore që shërbejnë në Komisaritet ku janë ndërtuar hapësira miqësore: sesioni i parë orientues lidhet me praktikën e përdorimit të sistemit audio-vizual brenda Hapësirës Miqësore për Fëmijët dhe trajnimi tjetër ishte mbi përdorimin e një qasjeje miqësore për fëmijën gjatë ndërveprimit me të. Gjithsej, 15 oficerë të policisë gjyqësore përfituan nga trajnimet e sipërpërmendura. Pjesë integrale e projektit të lartpërmendur ishte gjithashtu edhe prodhimi nga ekspertë të fushës i një dokumenti mbi "*Udhëzimet Procedurale për Intervistimin e të Miturve në kontakt/konflikt me ligjin, brenda Hapësirave Miqësore në Komisaritet e Policisë*". Përmes marrëveshjes së bashkëpunimit me TLAS-në, janë organizuar 4 seanca trajnimi për ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve (në Kamëz, Korçë, Librazhd, Lezhë & Kurbin) për zbatimin efektiv dhe të saktë të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, Ligjin e Ndihmës Juridike të garantuar nga shteti dhe ligji "*Për taksat dhe tarifën gjyqësore*". Këto trajnime synojnë në ngritjen

e kapaciteteve për profesionistët që punojnë me fëmijët, me përfaqësues të njësive të mbrojtjes së fëmijëve, shërbimeve sociale dhe përfaqësuesve të World Vision lidhur me sa më sipër.

➤ **TERRE DES HOMMES**

Në bashkëpunim me DhKA-në janë përgatitur udhëzues dhe trajnime mbi “*Drejtësinë Miqësore për të Miturit*” dhe veçanërisht rolin e Avokatit në Përdorimin e Programeve të Drejtësisë Restauruese dhe Masave të Shmangies nga procesi penal për fëmijët në konflikt me ligjin. *Janë botuar 200 kopje udhëzues dhe 500 kopje manual trajnimi.* Në bashkëpunim me DhKA-në dhe Programin Help të Këshillit të Evropës janë organizuar 2 ditë trajnim për hyrje në kursin online të drejtësisë restauruese.

Janë trajnuar *291 nxënës* të shkollave dhe mësues mbi parimet e drejtësisë restauruese për të mitur në Tiranë, Korçë, Durrës, etj.

Pas organizimit më datë 10-12 shkurt 2020 të workshopit konsultues mbi menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin në bashkëpunim me Strukturat e Mbrojtjes së Fëmijëve është përfunduar hartimi i “*Protokollit të Punës për Menaxhimin e Rasteve të Fëmijëve në Konflikt me Ligjin*” dhe draft “*Instrumenti i Monitorimit për Zbatimin e Protokollit të Punës për Menaxhimin e Rasteve të Fëmijëve në Konflikt me Ligjin*”. Të dyja këto dokumenta janë dërguar pranë MSHPS-së për zyrtarizim.

Ka përfunduar procesi i hartimit dhe akreditimit të moduleve mbi drejtësinë restauruese si pjesë e trajnimit vazhdues në Shkollën e Magistraturës. Janë botuar *500 kopje* të moduleve të hartuara.

Në kuadër të specializimit të profesionistëve që mbulojnë të drejtat e fëmijëve në çështjet e drejtësisë, Terre des Hommes ka vijuar me hartimin dhe trajnimin për rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile mbi qasjet e drejtësisë restauruese.

Ka përfunduar zbatimi i ndërhyrjeve të 10 organizatave lokale të mbështetura nëpërmjet skemës së granteve të vogla nga TDH-ja të zbatuara në Tiranë, Durrës, I EVP Kavajë/seksioni i të miturve, Gjirokastër, Shkodër dhe Vlorë. Janë trajnuar nëpërmjet kësaj skeme dhe këtyre ndërhyrjeve profesionistë në fushën e drejtësisë për të mitur (punonjës policie, avokatë, psikologë, mësues, psikologë shkollash, mediatorë, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve, etj) janë organizuar aktivitete informuese me fëmijë dhe të rinj mbi kuadrin e ri ligjor; janë siguruar seanca ndërmjetësimi; mbështetje ligjore dhe këshillim psikologjik për disa raste të indentifikuar në konflikt me ligjin nga ndërhyrjet në terren duke krijuar mundësinë e hartimit dhe zbatimit të praktikave të mira.

Janë trajnuar 20 mediatorë dhe u janë rritur kapacitetet për trajtimin e çështjeve penale për të mitur nëpërmjet ndërmjetësimit. Gjithashtu, një seri trajnimesh do të zbatohen në bashkëpunim dhe nën certifikimin e Dhomës Kombëtare të Mediatorëve.

Janë trajnuar mbi konceptet e drejtësisë restauruese, 15 stafe edukative dhe policë nga Instituti i të Miturve në Kavajë dhe Institucionet e Vuajtjes së Dënimit në Lezhë, Durrës, Rrogozhinë, Tiranë dhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Ka përfunduar hartimi i modelit të ri-integrimit për fëmijët në konflikt me ligjin, protokollin e punës dhe procesin e konsultimit. Janë trajtuar me shërbimin e ri-integrimit, punësimin, trajnimin profesional dhe mbështetjen sipas nevojës, në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe OJF-ve, 25 raste të të miturve në konflikt ose kontakt me ligjin në Tiranë.

➤ **KOMITETI HOLLANDEZ I HELSINKIT**

Projekti “*Drejt një mjedisi të sigurt, stimulues dhe rehabilitues në burgje, për fëmijët dhe të miturit në konflikt me ligjin në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni 2017-2021*”, i cili mbështetet financiarisht nga Ministria Hollandeze e Punëve të Jashtme nëpërmjet programit MaTra 2017-2020, është një nismë e Komitetit Hollandez të Helsinkit në bashkëpunim me Agjencinë Hollandeze të Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe me partnerë lokalë: Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarëve të Torturës dhe Komitetin Maqedonas të Helsinkit. Së bashku me ekspertët e Agjencisë Hollandeze të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Young in Prison dhe Universitetin Leiden të Shkencave të Aplikuara dhe në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në të tri shtetet, projekti synon të kontribuojë në reformën e sistemit të burgjeve duke përmirësuar mundësitë e të miturve të burgosur për t’u riintegruar me sukses në shoqëri. Projekti synon ta bëjë këtë duke parashtruar metoda zyrtare pune për stafin e burgut i cili punon me të miturit, dhe duke integruar këto metoda në politikat zyrtare dhe kurrikulat e institucioneve të edukimit. Projekti mbështetet në idenë që kushtet e ndalimit që favorizojnë ri-socializimin dhe përfshirjen aktive të të miturve në aktivitete ditore edukative dhe/apo profesionale janë më të suksesshme në arritjen e riintegrit të tyre në shoqëri.

Ky projekt ndërtohet mbi rezultatet e projektit të suksesshem të viteve 2013-2017 “Përmirësimi i kushteve të burgimit për riintegrimin e të miturve në Shqipëri, Maqedoni dhe Kosovë”.

Nisma e lartpërmendur, fillimisht synonte të kontribuonte në reformën e sistemit të burgjeve për të mitur në Shqipëri nëpërmjet sistemit prej katër komponentësh: **COPOSO** (mësimi i aftësive për jetën nëpërmjet prezantimit të aktiviteteve sportive dhe kreative nga mësues punëtarie lokale - Caritas dhe Ortek), **YouTurn/ToPs!** (trajnimi i stafit të IEVP Kavajë për të ndihmuar të miturit të mësojnë disa aftësi sociale dhe mendësore), **Social Climate Tool** (matja e klimës së jetesës, mësimi dhe punës në institucion për punonjësit dhe të miturit nëpërmjet studentëve dhe profesorëve të Universitetit të Tiranës të trajnuar nga ekspertë të Universitetit Leiden) dhe **Risk & Needs Assessment Tool**. Ky komponent i fundit, nën konsiderimin e nevojave të shprehura nga Ministria e Drejtësisë u amendua duke lënë mënjane zhvillimin e një Risk & Needs Assessment Tool dhe duke u përqëndruar në asistimin për zhvillimin e një kurrikule trajnimi për punonjësit që punojnë me të miturit dhe mbështetjen në ngritjen e një institucioni gjysëm të hapur (Neni 98 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur).

Nga Janari 2020 deri në ditët e para të Marsit 2020, nisma ka vijuar zbatimin e katër komponentëve kryesorë të saj sipas parashikimeve. Fatkeqësisht, pandemia Covid-19 shkaktoi një vonesë në zbatimin e nismës për shkak të forcës madhore. Aktivitetet rifilluan zbatimin online gjatë fundit të të njëjtit vit.

Pikërisht gjatë javës së dytë të Marsit, në kuadër të nismës, ishte parashikuar një vizitë pune disa ditore e një delegacioni të përbërë prej përfaqësuesëve kryesorë të zbatimit të katër komponentëve, të cilët do të zhvillonin takime në të gjithë institucionet përkatëse, duke përfshirë këtu dhe Ministrinë e Drejtësisë. Fatkeqësisht, vizitat e punës u anuluan dhe pjesëtarët e mbërritur në Tiranë të delegacionit u kthyen sërisht në Hollandë sapo lajmërimi për mbylljen e kufinjve u bë.

Sa i përket secilit prej komponentëve, **Social Climate Tool** pasi pati rezultate më se të kënaqshme në matjen e klimës brenda institucionit. Ai ishte planifikuar të prezantohej përpara institucioneve në vizitën e punës në Mars. Së shpejti priten të fillojnë trajnimet me studentët e rinj të përzgjedhur nga profesorët për t'u angazhuar në vijimin e matjes së klimës brenda institucionit.

Së dyti, komponenti **COPOSO** vijoi me zbatimin e punëtarive të Caritas Albania dhe Ortek për aq kohë sa ishte e mundur. Nga Nëntori 2020 e tutje, me ndihmën e Young in Prison, nga organizatat po arrihet të hidhen hapat e parë drejt ndërtimit të një platformë *online* për *workshop*-et, në respektim të rregullave të minimizimit të kontakteve fizike për shkak të vijueshmërisë së pandemisë Covid-19. Zhvillimi i kësaj platforme po kryhet në bashkëpunim me partnerët kosovarë të COPOSO: Caritas Kosova dhe Q'art. Në kuadër të përgatitjeve për këtë platformë, gjatë Nëntorit 2020, sesioni i parë i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve për prodhimin e videove të punëtarive u zhvillua me pjesëmarrës nga të gjitha organizatat që janë angazhuar më kurset e punëtarive brenda

institucionit. Ndryshimi i fundëm në metodën e zhvillimit të punëtarive, gjithashtu i mundëson të miturve të arrijnë të ndjekin punëtaritë e krijuara nga organizatat e angazhuara në Kosovë.

Së treti, zhvillimet për komponentin **YouTurn/ToPs!**, i cili përfshin trajnimet e punonjësve të I.E.V.P. Kavajë, pas konsultimit me pikën e kontaktit është fiksuar të rifillojë me disa trajnime rifreskuese për njohuritë e marra gjatë vitit 2019 dhe më pas të vijojë me linjën e trajnimeve të menduara si më parë. Skeleti i përbërjes së këtyre trajnimeve i është prezantuar së fundmi përfaqësuesëve të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të cilët u shprehën në dakordësi me risitë e prezantuar.

Së fundmi, bashkëpunimi midis organizatave partnere dhe Ministrisë së Drejtësisë është vendosur që të përfshijë përgatitjen e dokumentave ndihmues dhe udhëzues (protokolle, rregullore të brendshme, etj.) për ngritjen e institucionit gjysëm të mbyllur për të miturit sipas parashikimeve të bëra në ndryshimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, Neni 98, nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 233/2019. Gjithashtu, si më lart, bashkëpunimi do të përfshijë asistimin në zhvillimin e kurrikulës për stafin që punon me të miturit, për të cilën planet e para dhe dakordësitë u arritën në fund të 2020.

➤ **QENDRA E BERLINIT PËR NDËRMJETËSIMIN E INTEGRUAR (CSSP)**

CSSP, në partneritet me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve dhe FZKPM kanë ofruar trajnim për ndërmjetës si vazhdim i një programi trajnues të ofruar paraprakisht nga Terre des Hommes dhe FZKPM. Qëllimi i trajnimit ishte specializimi në fushën e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit në rastet e të miturve. Trajnimi u realizua si pjesë e projektit “*Forcimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri*” që po zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë.

➤ **CRCA/ECPAT SHQIPËRI**

Qendra për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri - CRCA/ECPAT punon për të promovuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve. CRCA/ECPAT Shqipëri prej 24 vitesh në fushën e drejtësisë për të mitur është një ndër organizatat lider në reformimin e sistemit të administrimit të drejtësisë për të mitur që nga viti 1999 e në vijim. CRCA/ECPAT Shqipëri ndër të tjera punon gjithashtu për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në nivel kombëtar dhe lokal, nëpërmjet avokatisë, përmirësimit të politikave dhe legjislacionit, ngritjes së kapaciteteve, informimit dhe studimeve, si dhe krijimit të modeleve efektive të shërbimeve shoqërore dhe

komunitare për kujdesin dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve. CRCA/ECPAT Shqipëri që prej vitit 2019 po zbaton nismën dy-vjeçare në mbështetje të reformës së drejtësisë për të mitur, të quajtur: “Shpresë për Fëmijët dhe të Rinjtë në Konflikt me Ligjin në Shqipëri”. Nisma është duke u zbatuar në qarkun e Tiranës dhe ka si qëllim të identifikojë, zhvillojë dhe promovojë shërbime alternative, të bazuara në komunitet, për fëmijët dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, në mënyrë që të mbështetet zhvillimi i tyre pozitiv, duke siguruar funksionimin e sistemit të drejtësisë për të mitur dhe atë të mbrojtjes së fëmijëve. Gjithashtu prej muajit Shtator 2020, CRCA/ECPAT Shqipëri po zbaton nismën, “Shpresë për fëmijët dhe të rinjtë në konflikt me ligjin” në qytetin e Tiranës, Elbasanit dhe Korçës, që mbështetet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga TLAS në partneritet me Fondacionin Qendra Europiane në Shqipëri.

Përgjatë periudhës **Janar – Dhjetor 2020** janë zhvilluar një seri aktiviteteve si vijon:

- ✓ Zyra e Mbrojtjes Ligjore Falas për Fëmijët dhe të Rinjtë e Pambrojtur e CRCA/ECPAT Shqipëri ka ofruar ndihmë juridike parësore falas për fëmijët dhe të rinjtë që kanë nevojë për ndihmë juridike dhe mbrojtje ligjore duke menaxhuar dhe trajtuar 17 raste me ndihmë ligjore parësore të të miturve në konflikt me ligjin në Tiranë, Elbasan, Korçë, Kukës, Krujë, Berat, etj.
- ✓ Krijimi i Qendrës Kombëtare Burimore për Rehabilitimin dhe Riintegrimin e të Miturve në Konflikt me Ligjin. Qendra ka si qëllim të ofrojë shërbimet si informim, këshillim dhe mbështetje psiko-sociale; Ndihmë ligjore falas; Monitorim dhe asistim për mbarëvajtjen e procesit të riintegrit të fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin; Mbështetje për riintegrimin në shoqëri të fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin përmes rritjes së kapaciteteve të tyre me anë të kurseve profesionale; Këshillim karriere dhe ndërmjetësim me institucionet publike për ofrimin e punësimit për të rinjtë në konflikt me ligjin në mënyrë që ta kenë sa më të lehtë riintegrimin; Këshillim dhe fuqizim i familjeve të fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin me qëllim mbështetjen e tyre për riintegrim; Fuqizimi i komuniteteve lokale ku fëmijët dhe të rinjtë jetojnë në mënyrë që këto komunitete të jenë sa më ndihmues përgjatë procesit të riintegrit; Informim dhe ndërgjegjësim i stafeve pedagogjike të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme mbi format e riintegrit të fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin.
- ✓ Monitorimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë mbi zbatimin e legjislacionit të Drejtësisë për të Mitur (për të rinjtë në konflikt me ligjin). Në këtë kuadër CRCA/ECPAT Shqipëria ka realizuar gjatë periudhës Mars, Prill, Maj dhe Qershor 2020, monitorimin 4 mujor lidhur me zbatimin e legjislacionit të Drejtësisë për të Mitur dhe specifikisht mbi caktimin e

Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të specializuar për gjykimin e çështjeve të Drejtësisë për të Mitur.

- ✓ Përgjatë periudhës Janar- Dhjetor 2020 është bërë përgatitja dhe hartimi i koncepteve, agjendave dhe ftesave në kuadër të zhvillimeve të seancave informuese, të paktën 60 përfaqësuesve nga sistemi i drejtësisë dhe mirëqenies sociale mbi procedurat dhe praktikat e reja në fushë.
- ✓ Ka filluar puna nga eksperti për Hartimin e Manualeve dhe Procedurave Standarte për menaxhimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin. Aktualisht këto dokumenta kanë përfunduar.
- ✓ Nismë ligjore për të miturit viktime të krimeve (Regjistri Kombëtar për Krimet Seksuale). Nisma ligjore për krijimin e regjistrit kombëtar të të dënuarve për krime seksuale do të funksionojë si një databazë e të dhënave të personave rezidentë në Shqipëri dhe që janë dënuar me vendim të formës së prerë nga ana e gjykatave vendase apo edhe në vende të tjera, për vepra penale seksuale. Regjistri do të jetë një mjet parandalues në duart e shtetit dhe shoqërisë shqiptare për të mbrojtur fëmijët, të rinjtë, gratë dhe çdo viktimë seksuale nga grabitqarët seksual.
- ✓ Vlerësimi i sistemit të adminstrimit të drejtësisë për të mitur sipas modelit “MONEE Analytical Report”. Në këtë kuadër është hartuar një raport 10-vjeçar mbi nivelin e kriminalitetit rinor në vend dhe impaktin që Ligji nr 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” ka pasur në uljen apo rritjen e kriminalitetit rinor në Shqipëri.
- ✓ Ofrimi i shërbimit psiko-emocional falas për fëmijët dhe të rinjtë në konflikt me ligjin gjatë dhe/ose pas përfundimit të masës së dënimit. Zhvillimi i seancave psikologjike dhe planit individual të veprimit si dhe shërbime në familje dhe komunitet.
- ✓ Zhvillimi i takimeve me Zyrat e Punës dhe Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional në Tiranë me qëllim lehtësimin e procesit të riintegritimit të fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin përmes ofrimit të kurseve profesionale falas dhe vendosjes në kontakt me tregun e punës. Përgjatë këtyre takimeve është diskutuar mbi programin e CRCA/ECPAT Shqipëri si dhe mbi ofrimin falas të kurseve profesionale për fëmijët dhe të rinjtë në konflikt me ligjin. Gjithashtu, është rënë dakort për të lidhur një marrëveshje bashkëpunimi mes zyrave të punës, Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional dhe CRCA/ECPAT Shqipëri.
- ✓ Zhvillimi i takimeve me Shërbimin e Provës Tiranë me qëllim koordinimin e punës lidhur me rastet e fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin të cilët do të kenë nevojë për shërbime të integruara të cilat CRCA/ECPAT Shqipëri i ofron. Përgjatë takimit me Drejtorin e Shërbimit të Provës është diskutuar mbi programin e CRCA/ECPAT Shqipëri si dhe mbi mundësitë e bashkëpunimit mes Shërbimit të Provës-Tiranë dhe CRCA/ECPAT Shqipëri me

qëllim koordinimin e punës lidhur me rastet e fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin të cilët do të kenë nevojë për shërbime të integruara të cilat CRCA/ECPAT Shqipëri i ofron. Gjithashtu, është rënë dakort për të lidhur një marrëveshje bashkëpunimi.

- ✓ Zhvillimi i takimeve ndër-institucionale me qëllim lehtësimin e procesit të riintegrimit të fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin. Në këtë kuadër, një seri takimesh janë zhvilluar me institucione të ndryshme të cilët konsiderohen si aktor kyç në zbatimin e nismës së CRCA/ECPAT Shqipëri në qarkun e Tiranës, Elbasanit dhe Korçës.
- ✓ Vijimi i punës për ngritjen e Rrjetit të Drejtësisë për të Mitur i cili do të jetë i përbërë nga organizatat e shoqërisë civile që punojnë për çështjet e drejtësisë për të mitur. Përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020 është punuar mbi hartimin e konceptit për Rrjetin e Drejtësisë për të Mitur. Gjithashtu është dërguar një email (ftesë) për të zhvilluar takimin e parë koordinues lidhur me krijimin e rrjetit.
- ✓ Finalizimi i Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës si dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, gjithashtu firmosja e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me Bashkinë Elbasan dhe Korçë, në kuadër të ofrimit të shërbimeve rehabilitues dhe riintegruese për të miturit në konflikt me ligjin.

➤ **FONDACIONI “ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE DHE PAJTIMI I MOSMARRËVESHJEVE” (FZKPM)**

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2020, Fondacioni “Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve” (FZKPM), në bashkëpunim dhe me aktorë të tjerë ka organizuar aktivitete që synojnë rritjen e kapaciteteve të profesionistëve në fushën e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve ku janë të përfshirë të miturit, duke vënë fokusin në njohjen me Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit dhe zbatimin e masës alternative të drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit.

Qershor 2020: Në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve u trajnuan 15 specialistë të institucioneve të vuajtjes së dënimeve penale përmes një trajnimi dyditor, të organizuar si pjesë e projektit “**Aktivizimi i shoqërisë civile në modelimin e praktikave restauruese për fëmijët dhe të rinjtë në kontakt me ligjin**”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Terre des Hommes në partneritet me FZKPM.

Gjithashtu, si pjesë e projektit të sipërpërmendur u organizuan dhe aktivitetet e mëposhtme:

- *Korrik 2020 dhe Tetor 2020*: në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve u organizuan dy workshope njëditore me ndërmjetës, ku u diskutuan çështje praktike që lidhen me ofrimin e shërbimit të ndërmjetësimit dhe drejtësisë restauruese për të miturit.
- *Tetor 2020*: Webinar realizuar në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Provës, me pjesëmarrjen e punonjësve të shërbimit të provës dhe përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, për rolin e punonjësit të shërbimit të provës në zbatimin e praktikave restauruese.
- *Nëntor 2020*: Trajnim vazhdues i specializuar për ndërmjetës në fushën e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimit për të mitur. Trajnimi u realizua si pjesë e projektit “Forcimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri”, që zbatohet nga Qendra CSSP për Ndërmjetësim e Integrues Gjermani, Zyra e Tiranës, në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë, Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve dhe FZKPM. Si pjesë e projektit të sipërpërmendur gjatë vitit 2020 janë organizuar sesione informuese për praktikën e drejtësisë restauruese me pjesëmarrjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Durrës.

➤ **Programi Shqiptar-Suedez i Drejtësisë Penale për të Miturit (SIDA)**

Programi Shqiptar-Suedez i Drejtësisë Penale për të Miturit i titulluar "*Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese dhe gjykatave shqiptare për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut në drejtësinë për të mitur - një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë*" pavarësisht vështirësive të hasura për shkak të pandemisë ka vijuar me aktivitetet e tij në zbatim të Planit të Punës të Programit dhe në mbështetje të Strategjisë për Drejtësinë Penale për të Miturit dhe Planit të saj të Veprimit. Komponentët e Programit- Policia, Prokuroria, Gjykata, Shërbimi i Provës dhe Burgjeve- së bashku, ose veçmas, kanë zhvilluar një sërë aktivitetesh gjatë vitit 2020, mes të cilave, në funksion të Plani të Veprimit të Strategjisë për të Miturit, po përmendim sa më poshtë:

Komponenti i Policisë

Programi Shqiptar-Suedez për drejtësinë penale për të mitur ka ndihmuar në krijimin e katër njësive të intervistimit sipas standardeve ndërkombëtare dhe procedurave standarde të veprimit të miratuara nga PSHSH. Njësitë janë krijuar në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë. Në vijim, po organizohet puna për trajnimin e përdoruesve të njësive, dhe ka filluar ToT i specialistëve të hetimit dhe psikologëve të cilët do të trajnojnë më tej të gjithë specialistët e hetimit të këtyre rrethëve për teknikat e intervistimit shkencor. Java e fundit e ToT që u ndërpre për shkak të pandemisë, do të vijojë online në katërmujorin e parë të vitit dhe do të mendohet së bashku me Akademinë e Sigurisë mënyra e trajnimit të specialistëve. Trajnimi do të bëhet sipas Kurrikulës për Teknikat e Intervistimit Shkencor të të Miturve të miratuar tashmë dhe do të zgjasë dy javë.

Komponenti i Prokurorisë

Në kuadër të garantimit të aksesit të të miturve në drejtësi, Qendra e Zhvillimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme me ekspertizën suedeze kanë finalizuar hartimin e materialit informues për shmangien që do t'i jepet autorëve të mitur. Ideja themelore pas kësaj veprimtarie është se i mituri në konflikt me ligjin ka nevojë për informacion mbi konceptin e shmangies që në fillim të hetimit. Instituti i shmangies është një mënyrë për të shmangur stigmatizimin e të miturit për dhënien e një dënimi të zakonshëm dhe në vend të kësaj të miturit i jepet p.sh një mundësi për një jetë më të mirë përmes këshillimit. Materiali po printohet dhe do t'i jepet prokurorëve të caktuar për hetimin e çështjeve me të mitur, të cilët duhet t'ia japin këtë informacion çdo të mituri në kontakt me ligjin.

Programi gjithashtu ka vijuar me përgatitjen e disa dokumenteve që synojnë të përmirësojnë procesin me të miturin, si gjatë hetimit ashtu edhe gjatë gjyqimit. Kështu, qëllimi i Programit është që specialistët e hetimit të intervistojnë të miturin në konflikt me ligjin me një cilësi të tillë që prokurorët të mos kenë nevojë të intervistojnë përsëri. Të paktën, specialistët e hetimit duhet të kryejnë intervistat në të gjitha situatat, përveç atyre që janë më ekstreme. Ekspertët aktivë në Program dhe në Qendrën e Zhvillimit kanë mbledhur intervista për analizë dhe krahasim. Është finalizuar drafti i parë me gjetjet dhe rekomandimet dhe pritet që dokumenti përfundimtar të miratohet në muajt e ardhshëm të vitit 2021.

Komponenti i Gjykatës

Programi ka finalizuar një studim për të krijuar bazën për ndarjen e mëtejshme të njohurive midis profesionistëve dhe një bazë për zhvillimin e një sistemi të unifikuar dhe të parashikueshëm të drejtësisë për të mitur në Shqipëri në përputhje me sundimin e ligjit dhe interesin më të lartë të fëmijës: ***Përmbledhje e çështjeve gjyqësore mbi drejtësinë penale për të mitur - Zbatimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit në Gjykatat e Tiranës dhe Durrësit gjatë vitit 2018 dhe 2019***, e cila përbëhet nga dy pjesë. Pjesa e parë përbëhet nga **vendimet ndaj të miturve** në gjykatat e Tiranës dhe Durrësit gjatë vitit 2018 dhe 2019. Qëllimi është që përmbledhja të shërbejë një "dokument pune" që përmirësohet vazhdimisht me pjesëmarrjen e profesionistëve shqiptarë, gjyqtarë dhe të tjerëve. Pjesa e dytë përmban **të gjitha vendimet për masat e sigurimit** nga gjykatat në Tiranë dhe Durrës nga janari 2018 - qershor 2019. Autorët kanë identifikuar disa çështje dhe sfida të përgjithshme në zbatimin aktual dhe kanë rënë dakord për disa përfundime dhe rekomandime. Botimi u është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në të gjithë Shqipërinë dhe është postuar në faqen e internetit të Shkollës së Magjistraturës. Pjesa e dytë është analizuar me tej duke u fokusuar në **zbatimin e masës së sigurimit Vendosija e të miturit në mbikëqyrje dhe Vendosija e të miturit në shërbim të specializuar në çështjet me të mitur**. Ky studim është iniciuar me **objektivin e përgjithshëm** për të ulur numrin e të miturve në paraburgim ose me masë sigurimi në KPP që janë parashikuar për të rriturit, për të shkurtuar kohëzgjatjen e hetimeve penale dhe proceseve gjyqësore në çështjet e drejtësisë penale për të mitur, për të filluar krijimin e bazës për aplikim uniform dhe për të siguruar krijimin e kushteve për profesionistët që të zbatojnë masat e sigurimit në KDPM, kur është e nevojshme, në

përputhje me interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, pjesë e studimit është një format tip për të ndihmuar gjykatat që të formulojnë vendime më miqësore për fëmijët që përmbajnë të gjitha informacionet përkatëse.

Komponenti i Prokurorisë dhe Gjykatave

Në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës janë organizuar trajnime të vazhdueshme dhe fillestare. Kështu janë zhvilluar trajnime të vazhdueshme me temë *Masat e sigurimit dhe dënimet ndaj të miturve me synim arritjen e një praktike të unifikuar të bazuar në raste nga praktika dhe Çfarë ndodh pas dënimit? Roli i Prokurorëve dhe Gjyqtarëve në ekzekutimin e shmangies, dënimeve ndaj të miturve dhe dënimeve alternative*. Trajnimet janë zhvilluar përmes platformës Zoom. Pjesëmarrësit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të specializuar në drejtësinë për të mitur, kryesisht nga gjykatat dhe prokuroritë e rretheve. Trajnimi fillestar *Zbatimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mituri: Masat e Sigurimit, shmangia dhe arsyetimi ligjor për dënimet ndaj të miturve* është zhvilluar me pjesëmarrjen e kandidatëve të vitit të dytë të Shkollës së Magjistraturës. Konkluzionet e trajnimeve janë ndarë me Shkollën e Magjistraturës.

Komponenti i Shërbimit të Provës dhe Burgjeve

Një aktivitet i rëndësishëm i Programit që vijon punën e kryer në vitin 2019, është Trajnimi për mekanizmin e vlerësimit të riskut dhe nevojës (YRNAS) & planin e dënimit (PIT). Ky aktivitet u planifikua në pesë hapa, duke filluar me një trajnim mbi mekanizmin e vlerësimit të riskut dhe nevojës (YRNAS) dhe modelin e trajtimit individual (PIT) me manualin përkatës që u zhvillua në 2019 nga ky Program. Mjetet e përgatitura bazohen në mjetet / procedurat ekzistuese brenda DPB dhe DPSHP, por me një theks të fortë në qasjen e individualizuar, e cila përcaktohet në KDPM. Një trajnim tre ditor për zbatimin praktik të instrumentit të riskut dhe nevojës dhe modelit PIT u zhvillua në shkurt për 26 pjesëmarrës nga shërbimi shqiptar i burgjeve dhe i provës. Përmes këtij aktiviteti trajnues, pjesëmarrësit morën njohuri të mjaftueshme se si të aplikojnë YRNAS dhe modelin PIT. Për më tepër, pjesëmarrësit treguan aftësi të fituara në përcaktimin e nivelit të rrezikut të përsëritjes (YRNAS) dhe identifikimin e ndërhyrjeve të përshtatshme me një plan të vijues në përgjigje të risqeve të identifikuar (ITP). Përveç kësaj, shumë nga pjesëmarrësit bënë lidhje të qarta me "Udhëzuesin e Përdoruesit", i cili është një përmbledhje e teknikave të rehabilitimit të zbatueshme në burgje dhe shërbim prove, për të cilat stafi u trajnua gjatë vitit 2019. Në përfundim të trajnimit, u arrit konsensus për hapat e mëtejshëm të nevojshme nga pjesëmarrësit për një zbatim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të mjeteve.

Stafi i shërbimit të provës dhe burgjeve ka marrë pjesë në aktivitetet e mentorimit të organizuara nga Programi, me mbështetjen e dy ekspertëve suedezë, që e kanë gjuhën shqipe gjuhë amtare. Qëllimi i këtyre aktivitetëve ishte që pjesëmarrësit të merrnin mbështetjen e mjaftueshme për zhvillimin personal në mënyrë që të zbatojnë plotësisht mjetet / teknikat dhe që në përfundim të aktivitetëve të mentorimit të krijohej një ide e përgjithshme e progresit të çdo agjencie në zbatimin e mjeteve/teknikave. Plani fillestar ishte vijimi i trajnimit me tre aktivitete koherente dhe të integruara mentorimit për personelin e burgjeve dhe shërbimit të provës të trajnuar për YRNAS, PIT dhe Udhëzuesin e Përdoruesit. Raundi i parë i këtyre aktivitetëve të

mentorimit u zhvillua në Tiranë, Kavaje dhe Lezhe me pjesëmarrës nga Tirana, Kavaja, Lezha, Kruja, Shkodra, Kukësi, Elbasani, Berati, Korça dhe Fieri. 18 pjesëmarrës morën pjesë në këto aktivitete. Sidoqoftë, për shkak të pandemisë, veprimtaritë duhej të shtyheshin për në nëntor dhe dhjetor, ku u zhvilluan tre seanca mentorimi me pjesëmarrjen e 16 pjesëmarrësve me anë të platformës zoom. Gjithsej, stafi i shërbimit të provës është përfshirë në katër seanca mentorimi ndërsa shërbimi i burgjeve në pesë seanca. Të dyja agjencitë e përfshira kanë shprehur nevojën për të vazhduar aktivitetet e mentorimit në vitin 2021.

Gjithashtu, gjatë gjysmës së parë të vitit 2020, përfundoi puna me finalizimin e manualit për Raportin e Vlerësimit Individual (RVI), e cili filloi në vitin 2019. Qëllimet e manualit janë të japë mbështetje efektive dhe praktike për specialistët e shërbimit të provës gjatë hartimit të RVI në lidhje me të miturit në konflikt me ligjin, të japë orientim për zbatimin e një mënyre të unifikuar të hartimit të RVI, ku informacioni që i jepet gjykatës / prokurorit të identifikohet dhe vlerësohet sistematikisht, të sigurohet qëndrueshmëri për të ardhmen. Trajnimi i planifikuar mbi manualin është shtyrë për në vitin 2021, por manuali u është shpërndarë profesionistëve për të ndjekur punën e tyre të përditshme.

Bashkëpunim ndërinstitucional (Prokurori, Gjykata, Shërbim i Provës dhe Burgjeve)

Nisur nga formati i Programit, i cili përfshin zinxhirin e drejtësisë, dhe objektivin e rëndësishëm të programit për koordinimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, Grupi i Punës i ngritur me përfaqësues të gjykatës, prokurorisë, shërbimit të burgjeve dhe provës, të palës Shqiptare dhe Suedeze ka finalizuar hartimin e formateve tip të dokumenteve të mëposhtme:

- 1- Format tip i kërkesës së Gjykatës drejtuar shërbimit të provës për hartimin e RVI-së
- 2- Vendimin e Prokurorisë drejtuar shërbimit të provës për hartimin e RVI-së
- 3- Urdhrin e ekzekutimit të dënimit me burg në çështje me të mitur
- 4- Urdhrin e ekzekutimit të dënimit alternativ dhe masës së shmangies ndaj të miturve
- 5- Listën e kontrollit të përmbajtjes së fashikullit të prokurorit dërguar gjykatës.

Të gjitha këto formate janë në fazë miratimi nga institucionet përkatëse.

4.1 Vlerësimi i sfidave, boshllëqeve dhe joefikasitetit

Mbështetur në rezultatet e monitorimit të kryer për periudhën *1 janar – 30 dhjetor 2020*, rezulton se fushat që kanë treguar performancë jo rezultative të shoqëruar nga problematika për këtë periudhë raportimi janë aktivitet e pa realizuara/pazbatuara.

Në adresimin e performancës nga institucionet, rezulton se mungesa e burimeve njerëzore specifike (kapacitete institucionale); mungesa e buxheteve specifike për kryerjen e disa veprimtarive të parashikuara; vonesa në kryerjen e procedurave/fazave të kryerjes së aktiviteteve specifike janë

arsye dhe shkaqe që kanë çuar në mosrealizim të objektivave të parashikuar për periudhën e raportimit.

Periudha *janar – dhjetor 2020*, përkoi gjithashtu me një situatë të vështirë shoqërore me efekt global, Pandemia Covid -19 e cila pati ndikimet e saj të menjëhershme edhe në mbarëvajtjen e aktiviteteve institucionale dhe ndërinstucionale në vend, në kuadër të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit 2018-2021.

Me qëllim përmirësimit të zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit 2018-2021, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të zbatimit dhe të monitorimit janë:

- ✓ Njohja dhe aplikimi i metodologjisë së re të monitorimit dhe raportimit të planit të veprimit në përputhje e agjendën e mirëqeverisjes dhe formatin IPSIS të dokumenteve strategjike. Informacioni i raportuar duhet të përpunohet dhe dërgohet në përputhje me kategorinë e informacionit, të jetë faktik, të ketë evidenca të qarta dhe të dhëna analitike. Çdo qëllim politikash duhet të ndërlidhet me nivelin e zbatueshmërisë së masave/aktiviteteve dhe buxhetin e planifikuar dhe të buxhetit faktik të përdorur.
- ✓ Rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në Planin e Veprimit lidhur me rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur dhe në kohë të PV, si dhe mbi rëndësinë e procesit të raportimit.
- ✓ Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstucional.
- ✓ Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit tek Drejtoritë e Financës, përpara momentit të raportimit.
- ✓ Kryerja e procesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të raportimit të parashikuara në Strategji.

4.2 Konkluzione dhe rekomandime

Raporti i monitorimit *janar - dhjetor 2020*, në zbatim të Planit të Veprimit 2018-2021, të Strategjisë së Drejtësisë për të Mitur është hartuar në përputhje me strukturën e dokumenteve strategjike sektoriale dhe ndërsektorialë për agjendën e mirëqeverisjes dhe në kuadër të programimit IPSIS.

Raporti vjetor jep një informacion mbi zbatueshmërinë e objektivave strategjike dhe të masave të parashikuara për arritjen e këtyre objektivave. Raporti jep një informacion specifik mbi realizueshmërinë e masave prioritare të planit të veprimit, problematika të hasura gjatë zbatimit, sfidat e institucioneve si dhe identifikim të masave të nevojshme korigjuese për periudhat në vijim. Për këtë periudhë zbatimi të Planit të Veprimit, janë parashikuar në total 5 objektiva dhe **24 masa**.

-Nga këto: **15** masa janë të zbatuara plotësisht; **7** masa janë ende në proces zbatimi, **2** masa janë të përealizuara.

Në përfundim të këtij raporti, **Rekomandimet** janë:

- ✚ Të përmirësohet performanca e aktivitetit të institucioneve që raportojnë masa/aktivitete në proces zbatimi;
- ✚ Të ulet numri i masave/aktiviteteve që rezultojnë të pazbatuara;
- ✚ Të brendësohet metodologjia IPSIS e raportimit të zbatimit të masave dhe aktiviteteve për periudhën në zbatim.

V. RISQET/RISKU DHE HAPAT PËR TU ADRESUAR

5.1 Vlerësimi i riskut duke përdorur dhe treguesit

Ky kapitull përcakton parimet e përgjithshme të menaxhimit të riskut, metodën sistematike që përdoret për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar risqet kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë me qëllim minimizimin e ngjarjeve negative të paparashikuara dhe maksimizimin e mundësive.

Vlerësimi i risqeve është udhëhequr nga tre parimet bazë:

- Siguria se ka një proces të strukturuar qartë në të cilin si mundësia edhe impakti, konsiderohen, për secilin risk;
- Regjistrimi i vlerësimit të riskut në një mënyrë që lehtëson monitorimin dhe identifikimin e prioritetëve të riskut;
- Qartësimi mbi ndryshimin ndërmjet riskut të qenësishëm dhe riskut të mbetur.

Rreziku	Niveli	Masat lehtësuese
Çështjeve që i referohen investimeve në përshtatjen e ambienteve të institucioneve ligjzbatuese, pasi kjo çështje lidhet ngushtësisht edhe me riorganizimin e ri të gjykatave dhe të prokurorisë, duke përfshirë edhe seksionet e të miturve në këto institucione sipas hartës së re gjyqësore.	Mesatare	Dialog i vazhdueshëm me të gjithë bashkëbiseduesit.
Zbatimi i programeve rehabilituese / rintegruese / korrigjuese dhe edukuese për të miturit duhet të		

shoqërohet edhe me ngritjen e institucioneve dhe qendrave të posaçme për ta, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë e grupeve vulnerable dhe me aftësi të kufizuar.	Mesatare	Dialog i vazhdueshëm me të gjithë bashkëbiseduesit kryesorë të cilat janë thelbësore për ngritjen e institucioneve dhe qendrave të posaçme.
Mjaftueshmëria e kapaciteteve njerëzore dhe financiare, bashkëpunimi dhe koordinimi ndërmjet organizatave dhe institucioneve do të jenë faktorë kyç që ndikojnë tek rezultatet.	I Lartë	Mbështetja përmes ndërtimit të kapaciteteve plotësuese ose të propozuara për të lehtësuar arritjen e rezultateve.
Akresi tek burimet dhe zbatimimi në kohë i ligjeve dhe rregulloreve do të jenë ndikimet kryesore në progresin e arritshëm. Përveç zbatimit të ligjeve, njohuritë e zotëruara nga persona që zbatojnë iniciativat do të jenë vendimtare në arritjen e aktiviteteve.	E ulët	Vijueshmëria e procesit të punës nuk ndikohet dhe nuk nevojitet angazhimi i burimeve shtesë.

Në raportet e ardhshme të monitorimit do të vijojë analiza e treguesve për çdo objektiv për të parë ecurinë e tyre dhe progresin e qëllimeve të politikës sipas pesë Objektivave Strategjike të SDM.

1. Duhet kushtuar vëmendje realizimit të masave dhe aktiviteteve të lidhura me objektivat respektive specifike.
2. Tejkalmi i afateve të raportimit nga institucionet përgjegjëse është problematikë e cila ndikon drejtpërsëdrejti në hartimin e Raporteve të Monitorimit.
3. Problematikë e rëndësishme është cilësia e kontributeve, ku shpesh janë ri-kthyer për t'u plotësuar sipas kërkesave dhe në përputhje me formatin e Planit të Veprimit.
4. Metodologjia e monitorimit sipas IPSIS kërkon përmirësimin e kapaciteteve në institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe raportimin.

5.2 Hapat e radhës

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar - dhjetor 2020*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, të të dhënave analitike që institucionet kanë raportuar dhe të analizës së kryer, kërkohet që:

- ✓ Të vijojë zbatimi i masave në statusin “zbatuar pjesërisht/në proces” sipas afateve të parashikuara;
- ✓ Të nisë zbatimi në kohë i masave/aktiviteteve të parashikuara për periudhën në vijim;
- ✓ Të tregohet kujdes për organizimin e punës dhe proceseve përkatëse për ecurinë e masave e aktiviteteve;

- ✓ Të sigurohet operativiteti i burimeve dhe kapaciteteve njerëzore dhe ekspertizës së nevojshme për kryerjen e tyre;
- ✓ Dërgimi i informacionit mbi disbursimin financiar për aktivitetet e parashikuara në strategji, pasi ndikojnë në pasqyrimin jo real të kostove për zbatimin e Strategjisë;
- ✓ Të sigurohet bashkëpunimi institucional i nevojshëm për masa e aktivitete të përbashkëta;
- ✓ Të garantohet koordinimi i mjaftueshëm për të shkëmbyer në mënyrë të efektshme informacionin dhe zgjidhur problemet penguese që mund të zgjidhen nga institucionet (përgjegjëse dhe bashkëpunëtore).

PLANI I VEPRIMIT 2018 - 2021

I. JANAR – DHJETOR 2020

Nr.	Aktivitetet	Afati i realizimit	Institucioni përgjegjës	Indikatorët e zbatimit	Buxheti i parashikuar për vitin 2020	Buxheti i shpenzuar për realizimin e aktivitetit Janar-Dhjetor 2020		Statusi i aktivitetit për periudhën Janar-Dhjetor 2020 (E realizuar/në proces/parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën Janar-Dhjetor 2020
						Buxheti Shtetit	Donatorë		
<p>Indikatorët - numri i strukturave dhe profesionistëve që ofrojnë ndihmë ligjore; - numri i aktiviteteve sensibilizuese për drejtësinë për të miturit; - numri i fëmijëve që marrin ndihmë ligjore;</p>									
<p>Objektivi Specifik 1: Ofrimi i ndihmës juridike për përfituesit e mitur që ky shërbim të jetë i shpejtë, profesional dhe efektiv</p>									
1.1	⁷ Krijimi i kuadrit rregullator për ofrimin e ndihmës juridike për përfituesit e mitur	2018	(MD) Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	Miratimi i 2 (dy) formularëve të vetëdeklarimit për përfitimin e ndihmës juridike për: 1 - viktimat e mitur 2 - të miturit në konflikt me ligjin.	0			Realizuar në vitin 2019	<p>Ministria e Drejtësisë Aktiviteti i realizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në qershor të vitit 2018, si dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji, konkretisht: Urdhri i Ministrit të Drejtësisë nr. 225, datë 25.3.2019 “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.</p> <p>Pas ndryshimeve që pësoi sistemi i ndihmës juridike në kuadër të paketës së ligjeve të reformës në drejtësi, me Ligjin nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, u zgjerua rrethi i subjekteve të cilët përfitojnë nga shërbimet juridike falas. Në këtë kuadër, përveç pamundësisë financiare si kriter i përgjithshëm për të përfituar nga këto shërbime, u parashikua dhe një kategori e veçantë subjektësh të cilët janë drejtpërdrejtë përfitues pavarësisht nëse përmbushin ose jo kriterin financiar. Në kategorinë e subjekteve të veçanta janë parashikuar ndër të tjera, viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin. Me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.225, datë 25.3.2019 “Për miratimin e formularëve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”, janë miratuar formularët e aplikimit për të gjitha format e ndihmës juridike, formatet e regjistrimit</p>

								<p>të kërkesave dhe vetëdeklarimeve, formati i regjistrimit të OJF-ve të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore, formulari i ankimit ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore, formulari i vetëdeklarimit për ardhurat dhe pasuritë si dhe formulari i vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta. Në formularin e fundit është parashikuar ndër të tjera, vetëdeklarimi nëse subjekti që kërkon të përfitojë nga shërbimet juridike falas është viktimë e mitur apo i mitur në konflikt me ligjin. Kuadri i ri ligjor për ndihmën juridike të garantuar nga shteti mundëson shërbime të ndihmës juridike parësore, dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore si formë e tretë e shërbimit juridik falas, duke garantuar eficiencë dhe cilësi përmes zbatimit të politikave dhe administrimit të ndihmës juridike parësore si dhe procesit të mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimit të dhënë nga të gjithë ofruesit e parashikuar në ligj nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas.</p> <p>Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas</p> <p>Përgjatë vitit 2020, sa i përket aspektit legjislativ kanë ndodhur një sërë zhvillimesh të cilat kanë bërë të mundur funksionimin me eficiencë të plotë të sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti. Sa i përket kësaj mase të parashikuar në Plan veprim, është plotësuar kuadri ligjor për ndihmën juridike me miratimin e dy akteve më të fundit në shtator të 2020. Gjithashtu, është miratuar Rregullorja e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas e cila rregullon në mënyrë të detajuar të gjitha fushat e veprimtarisë së këtij institucioni. Gjatë këtij viti është bërë i mundur gjithashtu miratimi i ndryshimeve ligjore të propozuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, konkretisht në Urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë. Këto zhvillime shprehen më të detajuara më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Miratohen dy aktet e fundit që lidhen me tarifat e shpërblimit të avokatëve që ofrojnë ndihmë juridike dytësore si dhe caktimin e tyre në bazë të parimit të rotacionit duke plotësuar kështu të gjithë kuadrin ligjor për ndihmën juridike të garantuar nga shteti.</i> <p>Muaji shtator 2020 shënon një arritje të rëndësishme sa i përket miratimit të akteve të fundit nënligjore në zbatim të ligjit nr.111/2017, duke plotësuar kështu të gjithë kuadrin ligjor në fushën e ndihmës juridike. Tashmë, ligji</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>nr.111/2017 është plotësuar dhe ndiqet nga 13 akte nënligjore të cilat rregullojnë në mënyrë të detajuar çdo fushë specifike të ndihmës juridike dhe kanë sjellë një serë risish e procedurash të reja.</p> <p>– <i>Miratohet Rregullorja e Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.</i></p> <p>Gjthashtu, në funksion të përcaktimit të rregullave lidhur me organizimin, funksionimin dhe administrimin e DNJF, me Urdhër nr. 393 datë 23.11.2020, të Ministrit të Drejtësisë është miratuar Rregullorja e Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas”.</p> <p>Në mënyrë të përmbledhur, Rregullorja e Brendshme e Organizimit dhe Funkcionimit të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas përcakton rregulla lidhur me organizimin, funksionimin dhe administrimin e DNJF, duke u ndalur kryesisht në:</p> <ol style="list-style-type: none"> a) Rregullimin e mënyrës së organizimit të DNJF, sipas strukturave; b) Përshkrimin e detyrave funksionale dhe kompetencave të nëpunësve dhe punonjësve administrativë sipas hierarkisë; c) Bashkërendimin e punës së strukturave të brendshme të Drejtorisë me institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike, si edhe publikun, median dhe çdo subjekt tjetër të interesuar; d) Caktimin e rregullave të përgjithshme të etikës, mbarëvajtjes, disiplinës në marrëdhëniet e punës. <p>– <i>Miratohen propozimet për ndryshime në Urdhër nr. 226 datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë “Për miratimin e kontratave të ofruesve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti”.</i></p> <p>Nisur nga 2 problematika kryesore që kanë rezultuar nga zbatimi në praktikë i detyrave funksionale të DNJF të cilat</p>
--	--	--	--	--	--	--	---

										<p>konstojnë konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mënyra e financimit të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara(në kushtet kur kontrata e financimit e OJF-ve e miratuar me udhëzimet e sipërcituar të Ministrisë së Drejtësisë nuk parashikon rregullat dhe procedurat mbi mënyrën e financimit për OJF-të e autorizuara); - Përfshirja e metodologjisë së vlerësimit të cilësisë së shërbimit të ofruar në kontratat tip të avokatëve për ofrimin e ndihmës juridike dytësore (Në kushtet kur kontratat e avokatëve të miratuara me këtë urdhër nuk përmbanin parashikim lidhur me zbatimin e standardeve të përcaktuara në urdhrin nr.531, datë 25.11.2019 “Për miratimin e kriterëve dhe metodologjisë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas të shërbimeve të ndihmës juridike”; <p>DNJF ka përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë propozimet përkatëse për shtesa dhe ndryshime në Urdhrin e sipërcituar. <i>Këto propozime janë miratuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë përkatësisht me Urdhrin nr. 424 datë 18.12.2020, , “Për disa shtesa në urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019” si dhe Urdhrin nr. 447, datë 31.12.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 226, datë 25.03.2019”.</i></p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

1.2	Përmirësimi i kuadrít profesional në ofrimin e ndihmës juridike për përfituesit e mitur	2019 - 2021	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (MD) DHKA, DPA, OJF/Donatorët	Zhvillimi i 2 (dy) trajnime në vit për punonjësit që do të ofrojnë ndihmë falas parësore dhe dytësore për të mitur <i>si dhe të përfaqësuesve procedurale nga Punonjësit e Mbrojtjes së fëmijëve</i>	210,000		(2019) ALL 320,000.00	Realizuar	<p>UNICEF</p> <p>Dhoma Kombëtare e Avokatisë, me mbështetjen e Këshillit të Evropës organizoi një sesion trajnimi online për avokatët që do të specializohen për ofrimin e ndihmës juridike për të miturit. UNICEF po ashtu mbajti një sesion informues në këtë takim lidhur me situatën e të miturve në konflikt dhe kontakt me ligjin duke theksuar si mund të kontribuojnë avokatët e të miturve në ndryshimin pozitiv në treguesit e Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë për të Mitur dhe në vetë jetën e këtyre fëmijëve. Po ashtu, UNICEF shpërndaui për pjesëmarrësit përmes Dhomës së Avokatisë botimet e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur e akteve të tij nënligjore, si dhe të Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë për të Mitur (2018-2021)</p> <p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas</p> <p>Forcimi i kapaciteteve të Stafit të DNJF</p> <p><i>Bashkëpunimi me Euralius.</i> Stafit i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas më datë 10.12.2020, pati mundësinë të zhvillonte trajnimin e organizuar nga Euralius V mbi ligjin “<i>Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti</i>” me pjesëmarrjen e ekspertëve të kontraktuar nga Euralius, Z. Thomas Traar dhe Zj. Arta Vorpsi. Stafit pati mundësinë të diskutonte në terma teknikë mbi problematikat e hasura në praktikë nga kuadri ligjor i sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta duke marrë në konsideratë dhë praktikën ndërkombëtare.</p> <p>Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore</p> <p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka patur një komunikim të vazhdueshëm me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), me qëllim dakordësimin mbi zhvillimin e trajnimeve për punonjësit me trajnim të posaçëm, si detyrim ligjor i parashikuar në shkronjën “g”, të nenit 8 të ligjit nr.111/2017, në të cilin parashikohet se: “<i>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për miratimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit me trajnim të posaçëm, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe</i></p>
-----	---	-------------	---	--	---------	--	-----------------------	-----------	---

												<p><i>rishqyrton periodikisht standardet për trajnimin dhe performancën profesionale të punonjësve me trajnim të posaçëm”.</i></p> <p>Nga ana e ASPA-s, me shkresën me nr. 7006/4 prot., datë 31.01.2020, u miratua Draft Programi i trajnimeve (trajnimi fillestar i detyrueshëm), hartuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për punonjësit me trajnim të posaçëm pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore. Nga ana tjetër, me shkresën me nr. 386/2, datë 22.05.2020, ASPA bën me dije se referuar VKM nr. 138, datë 12.03.2014 “<i>Për rregullat e organizimit dhe funksionimit të ASPA-s dhe trajnimin e nëpunësve civilë</i>”, konkretisht kreu III, përcaktohet se: “Për personat jashtë shërbimit civil (<i>siç janë punonjësit me trajnim të posaçëm, marrëdhënia e të cilëve rregullohet nga Kodi i Punës</i>), paguhet tarifa prej 3000 (tre mijë) deri në 7000 (shtatë mijë) lekë për kurs trajnimi, në varësi të kohëzgjatjes së kursi” .</p> <p>Sa më sipër, në kushtet kur buxheti i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas është i pamjaftueshëm për trajnimin e detyrueshëm e punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, DNJF kërkoi nga ana e UNDP mbështetjen qoftë atë financiare (pagesa e trajnimeve të ASPA-s), ose qoftë përmes zhvillimit të këtij trajnimi nga ana e një eksperti të kontraktuar.</p> <p>UNDP u shpreh e gatshme për zhvillimin e një trajnimi paraprak të punonjësve të qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore përmes angazhimit të disa ekspertëve dhe më datë 24.09.2020, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas u zhvillua sesioni i parë trajnues gjatë të cilit punonjësit e qendrave patën mundësi të diskutojnë në terma praktikë ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike sipas kategorive specifike të ligjit. (<i>u diskutua në mënyrë të detajuar për kategorinë e të miturve si kategori e veçantë dhe drejtpërdrejt përfituese</i>).</p> <p>Ky trajnim i paraprin zhvillimit të trajnimeve të detyrueshme të punonjësve nga ana e ASPA-s me bashkëpunimin dhe mbështetjen e UNDP-së. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, më datë 14 Dhjetor 2020, u mundësua zhvillimi i një takimi të përbashkët mes UNDP-së, DNJF-së dhe ASPA-s ku u diskutua në mënyrë të përgjithshme</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i kurrikulës (nëse ka një tekst bazë; printimi duhet të jetë në standard afatgjatë; nëse ky modul mund të përdoret nga ASPA për trajnime në vijim); - Pjesëmarrësit kanë mundësi që të reflektojnë mbi leksionet e marra gjatë sesionit të trajnimit dhe ti paraqesin këto reflektime në sesionin vijues; - Dhënia e certifikatës (çertifikata bazohet në një proces vlerësimi i cili kryhet specifikisht sipas nevojave të çdo pjesëmarrësi. Vlerësimi mund të bëhet përmes caktimit të detyrave/një prezantimi nga trajnuesi për pjesëmarrësit sipas nevojave që ata kanë prezantuar edhe gjatë trajnimit); - U theksua bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike sa i përket këtij projekti; - Punonjësit e Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore (për qendrat aktualisht të hapura dhe ato që do të hapen në vijim), janë target grupi i parë që do të trajnohen; - Nevojat për trajnim janë reflektuar në termat e referencës të cilat janë diskutuar dhe rënë dakord me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas. (është diskutuar në disa takime me DNJF-në lidhur me nevojat konkrete për trajnim të punonjësve të qendrave); - Moduli që do të hartohet për këto trajnime mund të përdoret nga të gjithë ata që ofrojnë shërbime (inkurajohet përdorimi i gjerë i këtij moduli); Do të jetë një Modul trajnimi i cili do të përfshijë disa tematika ashtu sikurse parashikohet në ligj dhe sikurse e kërkojnë nevojat e punonjësve. <p>Objektiv i DNJF-së është zhvillimi i këtyre trajnimeve brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021, duke u reflektuar në</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

mënyrë të detajuar në Planin e ri të Punës.

- **Forcimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike dytësore**

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional, i është drejtuar DhASH-së me shkresë Nr. 396 Prot., datë 01.10.2020, bazuar në kompetencat që rrjedhin nga ligji Nr.111/2017 ”Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, neni 9, gërma d) parashikon si detyrë të Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë përgatitjen dhe organizimin e programeve të trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas.

Ky parashikim ligjor gjen mbështetje dhe në ligjin nr. 55/2018 “Për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë”, ku në kapitullin VII “Edukimi profesional i avokatit” nenet 52, 55 dhe 30 përcakton se: Avokatët që do të përfshihen në listën e Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, kryejnë trajnim specifik mbi fusha të së drejtës të lidhura me kategoritë përfituese të ndihmës juridike dytësore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, duke ia atribuar këtë kompetencë Shkollës së Avokatisë, si organ i ngritur për të realizuar këtë qëllim.

Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur kontrata për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore për vitin 2020 me 73 avokatë në rang vendi, listuar sipas Dhomave Vendore të Avokatisë. Si rrjedhojë, nga ana jonë është propozuar që trajnimi vazhdueshëm të zhvillohet për të 73 ofruesit e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore. Në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka hartuar draft programin e trajnimit vazhdueshëm të ofruesve të shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, në të cilin janë parashikuar tema specifike duke u përqëndruar kryesisht në ligjin nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Gjithashtu, në fokus të veçantë për trajnimin vazhdueshëm janë parashikuar edhe nëntema të lidhura specifikisht me kategoritë e veçanta përfituese/grupet vulnerabël, sikurse parashikohen në ligj.

Objektiv i DNJF-së është zhvillimi i këtyre trajnimeve brenda 6 mujorit të parë të vitit 2021, duke u reflektuar në mënyrë të detajuar në Planin e ri të Punës.

– Zhvillimi i webinarëve nga DNJF

Në kuadër të njohjes së ofruesve të shërbimit me procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore qoftë sa i përket raportimit të të dhënave, qoftë sa i përket procedurës së mbikëqyrjes së cilësisë së shërbimit, DNJF ka zhvilluar disa webinarë me qëllim diskutimin më në detaje të akteve nënligjore dhe konkretisht:

- 1. Webinar datë 29 Tetor 2020, “Mbi procedurën e administrimit të të dhënave dhe raportimit nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore”,** me pjesëmarrjen e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore, Organizatave Jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikave të Ligjit pranë IAL-ve. Qëllimi kryesor i këtij webinarit ishte diskutimi në terma teknikë dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit në kuadër të rasteve të trajtuara, mbajtjes të të dhënave dhe administrimit të tyre sipas formateve të reja të përcaktuara nga aktet nënligjore. Janë pikërisht këto të dhëna, të administruara nga të gjithë ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike të cilat do të shërbejnë për hartimin e politikave të ndryshme në këtë kuadër si dhe do të jenë një indicie për evidentimin e nevojave për ndryshime ligjore.
- 2. Webinar datë 22 Nëntor 2020, “Mbi Standardet e ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë”,** me pjesëmarrjen e
 - Avokatëve të ndihmës juridike dytësore;
 - Përfaqësues nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë;
 - Përfaqësues nga Shoqata e

Avokatëve Penalistë të Shqipërisë;

- Përfaqësues nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore dhe
- Përfaqësues nga Organizatat Jofitimprurëse të autorizuara.

Qëllimi kryesor i këtij webinar i ishte diskutimi në terma teknike dhe bashkëbisedimi aktiv i ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore në kuadër të standardeve të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes së cilësisë. Diskutimi u përqëndrua në disa tematika kryesore si: Risitë e ligjit nr.111/2017, në kuadër të mekanizimit të mbikëqyrjes së cilësisë; Standardet e reja dhe indikatorët e vlerësimit të sanksionuara në Metodologjinë e miratuar me urdhër të Ministrisë të Drejtësisë dhe zbatimimi në praktikë referuar problematikave të nxjerra nga monitorimet e kryera.

- Takim Online me Klinikat e Ligjit, Tetor 2020

Më datë 28.10.2020 u zhvillua takimi i parë teknik me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë me të cilat Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë këtij takimi u diskutua për rolin që u është atribuar me ligj Klinikave të Ligjit, si ofrues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike falas dhe masat që duhen ndërmarrë me qëllim vendosjen e tyre në të njëjtën linjë me Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara. Pavarësisht se ndodhemi në kushtet e një viti të ri akademik sfidues, referuar masave kufizuese të ndërmarra për shkak të pandemisë, nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe përfaqësuesve të Klinikave u shpreh angazhimi maksimal dhe gadishmëria për bashkëpunim të mëtejshëm.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë

Gjatë vitit 2020, DhASH me mbështjen e organizatës Terre des Homme ka përgatitur:

- i- një Udhëzues për Avokatë mbi "Drejtësinë Miqësore për të Miturit dhe rolin e Avokatit në aplikimin e drejtësisë restauruese, masat alternative si shmangia dhe ndërmjetësimi për të miturit në konflikt me ligjin";
- ii- një Modul Trajnimi për Rolin e Avokatit në Aplikimin e Drejtësisë Restauruese dhe alternativat e tjera të dënimit

									<p>për të miturit në konflikt me ligjin”;</p> <p>iii- në Tetor 2020 është zhvilluar trajnimi me avokatët që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga Shteti. Lidhur me specializimin e avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike dytësore, është zhvilluar trajnimi i avokatëve mbi të drejtat e fëmijëve, veçanërisht të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe zbatimin të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, në bashkëpunim me Programin HELP të Këshillit të Europës, në datat 12-13 Tetor 2020 u zhvillua Kick off seminar online mbi “Drejtësinë miqësore për të Miturit dhe Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur” për specializimin e avokatëve të listës së ndihmës juridike; Në trajnim kanë marrë pjesë 25 avokatë dhe certifikimi i tyre do të bëhet në fund të muajit janar 2021;</p> <p>iv-Në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndhmës Juridike është punuar për hartimin e programit të veçantë të trajnimit vazhdues të avokatëve që do të ofrojnë ndihmën juridike të garantuar nga shteti i cili do të fillojë të zbatohet brenda muajit shkurt 2021 ;</p>
Objektivi Specifik 2: Krijimi i kushteve infrastrukturore të përshtatshme me nevojat e të miturve									
2.1	Përshtatja e mjediseve në polici, prokurori, gjykata dhe në institucione të tjera ligjzbatuese	2019 - 2021	MD, MB, DPB, DPPSH, DPSHP, KLGJ, KLP	Përshtatja sipas nevojave të të miturve në ambientet e policisë, gjykata dhe prokurori.	7,041,800		ALL 24,890,363	Proces	<p>UNICEF</p> <p>Me mbështetjen e UNICEF-it dhe fonde të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë e të Ambasadës së Norvegjisë si dhe të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar u përshtatën në 7 drejtori rajonale të policisë (nga 12) dhe u krijuan njësi të intervistimit miqësor për të miturit. Rikonstruksioni, mobilimi si dhe pajisjet dhe programet kompjuterike të fjalës së fundit, jo vetëm krijojnë një mjedis të përshtatshëm ku çdo fëmijë në konflikt a në kontakt me ligjin mund të intervistohet në kushte të qetësisë së plotë dhe të pafrikësuar, por edhe krijojnë mundësinë e regjistrimit të kësaj interviste – një detyrim kjo për fëmijët viktime të dhunës seksuale, por edhe një mënyrë për të realizuar kërkesat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, për të gjithë fëmijët e tjerë që ata të intervistohen sa më pak herë që të jetë e mundur. Për përdorimin e mjediseve dhe pajisjeve të instaluar në to UNICEF ka trajnuar rreth 20 përfaqësues të drejtorive rajonale të policive.</p> <p>Këshilli I Lartë Gjyqësor</p> <p>Për plotësimin e Objektivit Specifik 2, lidhur me krijimin e kushteve infrastrukturore të përshtatshme me nevojat e të miturve, KLGJ-ja përzgjedhi katër gjykata, të cilat u vlerësuan se kishin mundësinë praktike për përmbushjen e këtij objekti, pasi godinat e tyre dispononin ambientet e nevojshme për përshtatje. Gjykatat e përzgjedhura në këtë mënyrë janë:</p>

										<p>1. Gj. Ap. Shkodër; 2. Gj. Rr. Gj. Dibër; 3. Gj. Rr. Gj. Elbasan; 4. Gj. Rr. Gj. Shkodër.</p> <p>Realizimi i ambienteve miqësore për të miturit në gjykatat e mësipërme ishte planifikuar të kryhej gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2020.</p> <p>Nga raportimet e marra nga këto gjykata është arritur të krijohen ambientet miqësore për të miturit në tre prej tyre: Gj. Ap. Shkodër, Gj. Rr. Gj. Elbasan dhe Gj. Rr. Gj. Shkodër. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër nuk arriti ta realizonte këtë objektiv brenda vitit 2020, pasi ambienti që ishte planifikuar të përshtatej për të miturit, ndonëse në përdorim të gjykatës është aktualisht i zënë nga Zyra e Përmbarrimit. Përpjekjet për lirim të ambientit janë në vijim nga ana e gjykatës dhe me zgjidhjen e këtij problemi, do të procedohet menjëherë për përshtatjen dhe kompletimin e tij sipas modeleve të rekomanduara për ambientet miqësore për të miturit.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë Në lidhje me përshtatjen e ambienteve në prokurori, sipas nenit 38 të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, rezulton se është kompetencë e Prokurorit të Përgjithshëm të administrojë buxhetin e prokurorisë së juridiksionit të përgjithshëm dhe të kujdeset për ushtrimin e kompetencave ligjore dhe kushtetuese të prokurorisë. Sipas të dhënave të marra nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton se janë përshtatur ambientet pothuajse në të gjitha prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë. Këto institucione kanë marrë masat për përshtatjen e mjediseve/zyrave për të bërë miqësore për të miturit, duke shfrytëzuar hapësirat në dispozicion. Vetëm në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë Tiranë, Vlorë e Gjirokastrë nuk është bërë e mundur përshtatja e ambienteve. Në këto institucione shfrytëzohen ambientet e krijuara posaçërisht në komisariatet e policisë.</p> <p>Prokuroria e Përgjithshme Në prokuroritë e shkallës së parë janë marrë masa për përshtatjen e mjediseve/zyrave për të bërë miqësore për të miturit duke shfrytëzuar maksimalisht mjediset në dispozicion. Vetëm në prokuroritë Tiranë, Vlorë e Gjirokastrë, nuk është bërë e mundur por shfrytëzohen ambientet e krijuara posaçërisht në komisariatet e policisë.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit Në bashkëpunim dhe me mbështetjen e Programit “Forcimi</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

							<p>i kapaciteteve të agjencive ligj-zbatuese shqiptare për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit – një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë”, u mundësua ngritja e katër ambienteve miqësore për intervistimin e të miturve, në strukturat policore të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Shkodër e konkretisht;</p> <ul style="list-style-type: none">- Një në Komisaratin e Policisë Nr.3, Tiranë, ku punimet kanë përfunduar.- Një Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës, ku punimet kanë përfunduar.- Një në Drejtorinë Vendore të Policisë – Shkodër, ku punimet kanë përfunduar.- Një në Drejtorinë Vendore të Policisë – Vlorë është në proces e sipër, pasi punimet u vonuan për shkak të situatës Covid-19.- Po kështu, në bashkëpunim me UNICEF - Shqipëri, u mundësua përshtatja e shtatë ambienteve miqësore për intervistimin e të miturve, në strukturat vendore të policisë, e konkretisht;- Një në Drejtorinë Vendore të Policisë Berat,- Një në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë,- Një në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër,- Një në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës,- Një në Drejtorinë Vendore të Policisë Fier,- Një në Komisaratin e Policisë Sarandë,- Një në Komisaratin e Policisë Korçë. <p><i>Përvec DVP Vlorë, ku punimet nuk kanë përfunduar ende , të gjitha drejtoritë vendore të policisë janë të pajisura tashmë me një njësi për intervistimin e të miturve.</i></p> <p>World Vision Duke marrë parasysh numrin e lartë të fëmijëve të raportuar, të cilët janë në kontakt ose në konflikt me ligjin në zonën e Kurbinit dhe Lacit, World Vision Albania ka mbështetur krijimin e dy hapësirave miqësore brenda komisarariatit në Lezhë dhe Kurbin, punë e cila nisi që në vitin 2019, dhe vazhdoi përgjatë vitit 2020 me rritjen e kapaciteteve të punonjësve. Kjo ndërhyrje vjen si vijimësi e krijimit të dy hapësirave të para miqësore të ndërtuara në Komisaratin numër 5 në Kamëz dhe atë numër 6 në Tiranë.Në Kurbin, gjatë vitit 2020 u njoftua vetëm për dy raste të asistuara, dhe më pas hapësira miqësore nuk u përdor për shkak të dëmtimeve të tërmetit të 26 nëntorit 2019. Në Lezhë dhe Kamëz, ka pasur 32 raste të fëmijëve në kontakt dhe / ose në konflikt me ligjin që janë asistuar brenda Hapësirës Miqësore. Kryesisht rastet e dhunës dhe abuzimit seksual, janë ato më prevalentet në rastet e fëmijëve që kanë qenë në kontakt dhe/ose konflikt me ligjin.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--

									<p>SIDA Për periudhën raportuese tre njësi intervistimi të krijuara brenda ambienteve të policisë në Tiranë, Durrës dhe Shkodër. Njësia e katërt planifikohet të ngrihet në Vlorë.</p>
<p>Objektivi Specifik 3: Fushata sensibilizuese për aksesin e të miturve në drejtësi dhe të shërbimeve që ofron sistemi për ta</p>									
3.1	<p>Zhvillimi i aktiviteteve sensibilizuese në lidhje me të drejtat e të miturve autor, vistikim, dëshmitar dhe shërbimet që mund të përfitojnë nëpërmjet garantimit të të drejtës së fëmijës për informacion e këshillim ligjorë përmes përfshirjes në kurrikulat shkollore të moduleve të edukimit ligjor.</p>	2018 - 2021	<p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas (MD), DHKA, Gjykatat/KLGJ, Prokurori/KLP, MB, AP, DPPSH, MSHMS, MASR, ASHDMF, OJF/Donatorët</p>	<p>1.Hartimi i 1 (një) plani ndërgjegjësimi. 2. Zhvillimi i 10-20 në vit i aktiviteteve sensibilizuese pranë institucioneve arsimore, shëndetësore, vendore, penitenciare, gjyqësore dhe të tjera.</p>	1,500,000		<p>4900 Euro (TdH)</p> <p>UNICEF</p> <p>Njohja me medotat restauruese: 119,325 ALL</p> <p>njohja me të drejtave dhe shërbimet: 575,000 ALL</p>	Realizuar	<p>UNICEF UNICEF po punon për të mbështetur Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e tjera në zbatim të këtij aktiviteti gjatë vitit 2021.Për periudhën raportuese, UNICEF në bashkëpunim me Save the Children, zyrat vendore arsimore dhe qendrat komunitare në Berat dhe Gjirokastrë kanë organizuar dy fushata sensibilizuese në fushën e ‘parandalimit dhe zgjidhjes me metoda restauruese të konflikteve’ dhe ‘njohjes së të drejtave dhe shërbimeve që përfitojnë të miturit autorë, viktimat dhe dëshmitarë të veprave penale’. Për shkak të pandemisë një pjesë e seancave informative dhe workshop-eve me fëmijët e arsimit të detyruar dhe të mesëm u zhvilluan në distancë përmes platformës zoom. Këto fushata, përveç ndërgjegjësimit të mbi 120 fëmijëve dhe të rinjve në Berat dhe Gjirokastrë mbi të drejtat, mekanizmat për përmbushjen e tyre dhe shërbimet e ofruara në kuadrin e drejtësisë penale për të mitur, përbëjnë gjithashtu edhe një eksperiencë të vlefshme për pasurimin dhe zbatimin e përvitshëm të planeve të ndërgjegjësimit që mund të zbatohen pranë institucioneve arsimore. Udhëzuesi për Ndhmën Juridike Miqësore ndaj Fëmijës përgatitur nga Zyra e UNICEF për Evropën dhe Azinë Qendrore është përkthyer në gjuhën shqipe nga Zyra e UNICEF-it në Tiranë dhe është gati për publikim.</p> <p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas Duke qenë tërësisht të vetëdijshëm se rritja e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitim të saj përveçse një detyrimi ligjor (neni 8 i ligjit 111/2017), është një nga komponentët me thelbësorë të funksionimit të sistemit të ndihmës juridike dhe forcimit të aksesit të qytetarëve në drejtësi, DNJF-ja i ka kushtuar një vëmendje të shtuar informimit mbi sistemin e ndihmës juridike falas duke u ndalur në hartimin dhe publikimin e materialeve të vizibilitetit si dhe publikimit të postimeve/videove ndërgjegjësuere në rrjetet sociale të Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Edhe pse përgjatë vitit 2020 jemi hasur me një sërë vështirësish referuar gjëndjes së pandemisë së krijuar si rrjedhojë e COVID-19 dhe kufizimeve të ndërmarra në këtë kuadër, sërish i është kushtuar</p>

rëndësi e vecantë aktiviteteve me natyrë sensibilizuese me fokus edukimin ligjor të qytetarëve dhe marrjen e informacionit të nevojshëm mbi sistemin e ndihmës juridike falas nga grupet dhe kategoritë në nevojë.

1. Zhvillimi i aktiviteteve në kuadër të forcimit të sistemit të ndihmës juridike parësore

- *Takim me punonjësit e Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore*

Pranë ambjenteteve të Ministrisë së Drejtësisë, me prezencën e Ministres së Drejtësisë, zj. Etilda Gjonaj u zhvillua më datë 01.09.2020, një takim pune me punonjësit me trajnim të posaçëm në Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas në Tiranë, Durrës, Fier dhe Lezhë. Në këtë takim ju kushtua një rëndësi e veçantë diskutimit mbi mënyrat e sensibilizimit të qytetarëve dhe nxitjen e tyre për të marrë shërbimin ligjor falas pranë këtyre qendrave.

- *Aktivitet Ndërgjegjësues “Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin”, Kavajë, 09 mars 2020*

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet më themelore të mbrojtura në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Formë e mbrojtjes së këtij interesi është edhe aksesi në drejtësi për të gjithë fëmijët në konflikt me ligjin duke garantuar një shërbim ligjor falas dhe cilësor. Nga ky këndvështrim, ishte e nevojshme të bëheshin ndryshime ligjore në legjislacionin e procedurës penale dhe gjithashtu në ligjin "Për ndihmën juridike falas të garantuar nga shteti". Ligji 111/2017, "Për Ndihmën Juridike të garantuar nga Shteti", në referim të nenit 11 të tij, tashmë i ka cilësuar të miturit si subjekte të posaçëm të cilët, pavarësisht nga të ardhurat e tyre janë përfitues të drejtëpërdrejtë të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Konkretisht, fëmijët që jetojnë në institucione të kujdesit shoqëror; fëmijët në kujdestari, të cilët kërkojnë të fillojnë një proces pa pëlqimin e përfaqësuesit të tyre ligjor ose kundër përfaqësuesit të tyre ligjor; viktimat të mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedurës penale (për të cilën nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme), mund të përfitojnë që nga këshillimi ligjor (ndihma juridike parësore) deri në përfaqësimin e çështjeve

në gjykatë (ndihmë juridike sekondare). Gjithashtu, duke ritheksuar edhe njëherë mbrojtjen e interesave më të lartë të fëmijëve është detyrim ligjor që juristët/avokatët që ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike falas, të jenë të specializuar në sistemin e Drejtësisë për të mitur përmes ndjekjes së trajnimeve fillestare dhe të vazhdueshme të organizuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas/Departamenti i Administratës Publike/Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Pavarësisht lehtësirave që ka sjellë ky ligj në kuadër të përfitimit të shërbimit ligjor falas, vihet re se nga të miturit apo familjarët e tyre, nuk ka kërkesa për përfitim të ndihmës ligjore falas. Kjo mund të jetë si shkak i mungesës së informacionit mbi këtë shërbim. Në këto kushte, nga ana e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas është planifikuar zhvillimi i një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuere duke u ndalur veçanërisht tek kategoritë e veçanta të ligjit.

Pjesë e këtyre aktiviteteve ishte dhe Aktiviteti “Aksesi në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin” i cili u zhvillua me qëllim ndërgjegjësimin e të miturve pranë Qendrës së Ri-Integritit të të Miturve Kavajë. Ky aktivitet u zhvillua në 3 seksione ku përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën mundësinë të bashkëbisedonin me të miturit e kësaj qendre duke i shpjeguar në mënyrë të thjeshtëzuar se si ata apo prindërit e tyre mund të përfitonin nga shërbimet ligjore falas. Të miturit gjatë takimit informues u shfaqën mjaft të interesuar për t’u informuar mbi mënyrën e përfitimit të këtij shërbimi. Shumica prej tyre i shprehën problematikat ligjore më të cilat përballen familjarët e tyre të cilat lidheshin më së tepërmi me “detyrimin për ushqim” si dhe me kërkesat për “revokimin e avokatëve të caktuar kryesisht”. Me qëllim zgjidhjen e këtyre problematikave dhe përfitimin e shërbimit nga këta të mitur, përfaqësuesit e DNJF-së shkëmbyen kontaktet me Punonjësit Socialë të Qendrës së Re-Integritit të të Miturve Kavajë të cilët ishin mëse të gatshëm për bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas në trajtimin e këtyre rasteve.

- **Tryezë e Përbashkët në kuadër të promovimit dhe nxitjes së sistemit të ndihmës juridike falas, Elbasan 05 Mars 2020**

Më datë 5 Mars DNJF zhvilloi një tryezë të përbashkët me

								<p>përfaqësues nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Bashkia Elbasan, Drejtoria e Policisë Vendore dhe përfaqësues të Organizatave Jofitimprurëse. Qëllimi i kësaj tryeze konsistente në rëndësinë dhe efikasitetin që duhet të ketë Sistemi i Ndhmës Juridike Parësore dhe fokusin për të rritur urat e bashkëpunimit ndërinstitucional në mënyrë të tillë që çdo qytetari t'i garantohet akses në Drejtësi. Tryeza rezultoi mjaft frytdhënëse në kuadër të lidhjes së urave të bashkëpunimit me aktorët ndër institucionalë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Intervista televizive me qëllim përcjelljen e njohurive mbi sistemin e ndihmës juridike falas tek qytetarët</i> <p>Më datë 17 qershor 2020^s, 2 specialistë të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas janë ftuar në emisionin “Mirëmëngjes Shqipëri” në Radio Televizionin Shqiptar gjatë të cilit është diskutuar mbi ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas gjatë periudhës së pandemisë, sistemin e ndihmës juridike falas, ofruesit e këtij shërbimi dhe kategoritë përfituese.</p> <p>Në muajin Nëntor të vitit 2020 është realizuar intervista televizive me pjesëmarrjen e punonjësve të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Pogradec dhe kryetarit të Dhomës Vendore të Avokatishë Korçë në të cilën është folur mbi sistemin e ri të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, kushtet e përfitimit, ofruesit e shërbimit dhe informacione të tjera të nevojshme për informimin ligjor të publikut.</p> <p>Këto intervista kanë vijuar të zhvillohen përgjatë muajit dhjetor me qëllim përbushjen e objektivit të DNJF-së lidhur me promovimin e sistemit të ndihmës juridike falas dhe edukimin ligjor të publikut.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Takim me organizatat jofitimprurëse të autorizuar që do të ofrojnë ndihmë juridike të garantuar nga shteti</i> <p>Më datë 10.09.2020, u zhvillua ceremonia e shpërndarjes së autorizimeve nga ana e Ministrit të Drejtësisë të 12</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

organizatave jofitimpruëse të autorizuara me një shtrirje gjeografike në Tiranë, Elbasan, Durrës, Shkodër dhe Berat. Gjatë këtij takimi u vu theksi në prioritetin që i jepet ndihmës juridike falas, në realizimin e së cilit kanë qenë mbështetës aktorët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile. Organizatat jofitimpruëse krahas Qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe Klinikave të Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë, përmes eksperiencës së tyre shumëvjeçare do të sigurojnë ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas tek qytetarët në mënyrë profesionale dhe cilësore, nën kujdesin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

- ***Publikime dhe produkte të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në kuadër të vizibilitetit***

Publikimi i manualit “Si të përfitojmë ndihmë juridike falas”

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 8 shkronja “d” dhe “e” të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka vijuar me hartimin dhe publikimin e një manuali të thjeshtëzuar mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike falas. Manuali për ndihmën juridike u është përcjellë disa institucioneve si Bashkia Tiranë, Avokatit të Popullit, Komitetit Shqiptar të Helsinkit, Kryeministrisë në kuadër të nxitjes dhe bashkëpunimit .

- ***Promovimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore/dytësore përmes vendosjes së posterave pranë institucioneve kryesore në vend.***

DNJF në kuadër të përmbushjes së këtij aktiviteti, ka zhvilluar një sërë takimesh me EURALIUS V19 sa i përket përmbajtjes së posterave. Në muajin Shtator 2020 u bë i mundur dizajnimi dhe printimi i mbi 500 posterave adezivë promovues të sistemit të ndihmës juridike falas me qëllim afishimin e tyre pranë institucioneve shtetërorë në gjithë Republikën e Shqipërisë.

								<p>Gjithashtu, janë hartuar dhe vendosur në dispozicion të qytetarëve fletëpalosje të dedikuara për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas dhe Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve me të cilat DNJF ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>- <i>Përditësimi i vazhdueshëm i faqes zyrtare në kuadër të transparencës dhe informimit të qytetarëve.</i></p> <p>Që prej muajit Mars 2020, është finalizuar faqja zyrtare e DNJF dhe është vendosur në dispozicion të publikut. Aktualisht DNJF është duke e përditësuar faqen në mënyrë aktive përmes publikimit të raportimeve të ndryshme në kuadër të transparencës si dhe manualeve në ndihmë të qytetarëve për përfitimin e shërbimit.</p> <p>- <i>Promovimi i sistemit të shërbimit të ndihmës juridike falas përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram</i></p> <p>Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët dhe duke marrë parasysh faktin se ky shërbim është relativisht i ri dhe i panjohur për të shumtën e qytetarëve, DNJF është duke punuar në mënyrë të vazhdueshme për promovimin e këtij sistemi përmes rrjeteve sociale Facebook dhe Instagram të cilat janë mjaft të përdorshme nga qytetarët. Kemi vijuar me postime të vazhdueshme informative mbi procedurat që duhen ndjekur për përfitimin e këtij shërbimi si dhe janë mbajtur komunikime të vazhdueshme me qytetarët të cilët na janë drejtuar për të kërkuar informacion.</p> <p>- <i>Përfshirja e sistemit të ndihmës juridike falas si E-shërbim në platformën e-albania</i></p> <p>Duke qenë se sistemi i ndihmës juridike falas është një sistem i lidhur ngushtësisht me qytetarët, promovimi dhe informimi mbi këtë sistem është një element kyç në kuadër të rritjes së aksesit të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë. Si një mjet mjaft i mirë në kuadër të përmbushjes së këtij qëllimi, Drejtoria e Ndhmës Juridike</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

									<p>Falas me shkresën me nr. 371 prot., datë 23.09.2020 i ka propozuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, përfshirjen e ndihmës juridike falas si E-shërbim në Platformën E-ALBANIA. Kjo platformë, sidomos në periudhën aktuale për shkak të pandemisë së Covid-19, ka një përdorim mjaft të gjerë ndaj edhe përfshirja e E-shërbimit “Ndihmë juridike falas” do të ketë një impakt në rritjen e nivelit të informacionit të qytetarëve mbi këtë sistem. Që prej datës 17 Dhjetor 2020, të gjithë shtetasit tashmë mund të përfitojnë shërbimet e këshillimit ligjor direkt nga <i>e-albania</i> bashkë me të gjitha shërbimet e tjera online¹⁰.</p> <p>- <i>Inagurimi i Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Pogradec, Tetor 2020</i></p> <p>Qytetarët që përfitojnë janë ata në pamundësi financiare për të marrë një avokat, qoftë për t'u këshilluar, për t'u përfaqësuar në gjykatë apo për të përgatitur dokumentat për përfaqësim në gjykatë, apo për të ditur kujt t'i drejtohen. Gjithashtu, shërbimet e ndihmës juridike falas ofrohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë për grupet vulnerabël / kategoritë e veçanta të ligjit si: gratë viktime të dhunës në familje, viktime të trafikimit, të miturit, grupet në nevojë, grupet që i përkasin komuniteteve apo pakicave kombëtare etj.</p> <p>- <i>Takim me Shoqatën “Unë, Gruaja” Nëntor 2020</i></p> <p>Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas, si një nga aktorët mbështetës për projektin “Ligji është jetë – Mbrojeni jetën tuaj!” mori pjesë në trajnimin e organizuar nga “Shoqata Unë,Gruaja”, për Vullnetarët e Ligjit me temë: “Rritja e kapaciteteve për grupet mbështetëse në lidhje me informacionin ligjor për publikun dhe qasjen e tij në drejtësi”.</p> <p>Ky trajnim u organizua në kuadër të projektit: “Ligji është jetë- Mbrojeni jetën tuaj!” i cili po zbatohet nga Shoqata “Unë, Gruaja” në Korçë dhe Pogradec me mbështetjen UNDP Albania dhe fonde të Agjencisë Austriake për</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>Zhvillim.</p> <p>Projekti “Zgjerimi i shërbimit të ndihmës juridike falas për gratë dhe burrat në Shqipëri” zbatohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në partneritet me Ministrinë e Drejtësisë dhe financim të Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA)”</p> <ul style="list-style-type: none"> - Afishimi i posterit “Ke nevojë për ndihmë juridike”, në ambientet e pushtetit qendror, lokal dhe sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, Dhjetor 2020 <p>Në përmbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, garantimit të aksesit në drejtësi për çdo qytetar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e qeverisjes të nivelit qendror, lokal dhe sistemin gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka vijuar me komunikimet me qëllim promovimin dhe rritjen e ndërgjegjësimit tek qytetarët në lidhje me sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti duke kërkuar nga institucionet shtetërore afishimin e posterave “Ke nevojë për ndihmë juridike”. Këto postera janë konceptuar nga Ministria e Drejtësisë/Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me Euralius V, ku platforma jurstionline.al dhe numri i gjelbër 0801010 janë financuar nga “Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” dhe kanë për qëllim kryesor ndërgjegjësimin e qytetarëve dhe orientimin e tyre drejt sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, si element thelbësor i aksesit në drejtësi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nënshkrimi i 25 marrëveshjeve “Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” me Gjykatat e Republikës së Shqipërisë, Dhjetor 2020. <p>Në përmbushje të misionit madhor të Ministrisë së Drejtësisë, “Sigurimit të ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike falas në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive, për të gjithë kategoritë përfituese”, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas ka nënshkruar 25 marrëveshje me</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

										<p>Gjykatat e Republikës së Shqipërisë me objekt :“Për sigurimin e aksesit në drejtësi të qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike falas, sipas përcaktimeve të ligjit nr.111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.</p> <p>Duke vlerësuar maksimalisht rolin që kanë Gjykatat në sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, këto marrëveshje janë një vlerë e shtuar në përmbushje të misionit të DNJF.</p> <p>2. Zhvillimi i fushatave të ndërgjegjësimit</p> <p>- <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Fierit, Nëntor 2020</i></p> <p>Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si dhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.</p> <p>Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në qytetin e Fierit ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier; Prokuroria; Bashkia; Shtëpia e të moshuarve; ADISA etj., si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.</p> <p>- <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Lezhës, Nëntor 2020</i></p> <p>Drejtorja e Ndhmës Juridike Falas po vijon me promovimin e shërbimit për qytetarët, si edhe me shpërndarjen e fletëpalosjeve në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit të shtetasve mbi shërbimin juridik falas.</p> <p>Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF ishte në qytetin e Lezhës ku organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u afishuan postera të ndihmës juridike në institucione si: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë; Prokuroria; Bashkia; etj si dhe u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

											<p>juridike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Tiranës, Nëntor 2020</i> <p>Gjatë muajit nëntor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Durrësit, Dhjetor 2020</i> <p>Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Fushata e ndërgjegjësimit në qytetin e Shkodrës, dhjetor 2020</i> <p>Gjatë muajit dhjetor 2020, ekipi i DNJF organizoi një fushatë ndërgjegjësimi gjatë të cilës u shpërndanë fletëpalosje dhe manuale të cilat shpjegojnë se si qytetarët mund të përfitojnë ndihmë juridike.</p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Takim informues me qytetarë të komunitetit Romë dhe Egjiptian në Shkozë, Tiranë mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, Nëntor 2020</i> <p>Ekipi i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas organizoi një takim me qytetarë të komunitetit Rom dhe Egjiptian në zonën e Shkozës, Tiranë, bashkë me përfaqësuesit e Klinikës Ligjore Wisdom, me të cilët është nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p>Pjesëmarrësit, si një ndër kategoritë përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti, u informuan mbi të drejtat që ligji për ndihmën juridike u garanton dhe mënyrën e përfitimit të ndihmës juridike falas.</p> <p>U zhvillua një bashkëbisedim mbi problematikat ligjore të qytetarëve, të cilat do të adresohen për t'u trajtuar në Klinikën e Ligjit Wisdom dhe Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Tiranë.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë Për periudhën raportuese, institucionet arsimore parauniversitare kanë realizuar veprimtaritë e mëposhtme: 1. Zhvillimi i aktivitete sensibilizuese në shkollat e arsimit bazë në lidhje me njohjen e të drejtave të të miturve autorë në konflikt me ligjin, viktima apo dëshmitarë. Temat e këtyre aktiviteteve ndërgjegjësuese me nxënës kanë qenë : <ul style="list-style-type: none">• Të drejtat e fëmijës dhe ndihma në raste abuzimi.• Takime me qëllim ofrim këshillim ligjor mbi kuadrin ligjor për të mitur.</p> <p>2. Përmirësimi i aksesit të fëmijëve në drejtësi, informimi dhe riintegrimi i tyre përmes përfshirjes së moduleve kurrikulare të edukimit ligjor në lëndën Qytetari. Në bashkëpunim me NJMF janë trajtuar dhe kanë përfituar këshillim psikologjik falas nxënës të cilët kanë pasur probleme me drejtësinë.</p> <p>3. Pjesëmarrje në projektet e përbashkëta të shkollës me OJF dhe organeve të vetëqeverisjes vendore në kuadrin e aktiviteteve sensibilizuese mbi menaxhimin e sjelljes agresive, parandalimin e akteve të dhunës, zgjidhjen e konflikteve dhe forcimin e marrëdhënieve mes shkollës, familjes dhe shoqërisë. Janë zhvilluar aktivitete dhe takime në grup të cilat ndihmojnë nxënësit kryesisht për menaxhimin e sjelljes, agresivitetit, zgjidhjen e konflikteve, rregullimin e marrëdhënieve ndërpersonale dhe menaxhimin e emocioneve.</p> <p>Dhoma Kombetare e Avokatisë Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur është pjesë e kurrikulës së Shkollës së Avokatisë prej hyrjes në fuqi të tij. Zhvillohen 2 orë mesimore mbi KDPM në vit.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 1. Nisur nga situata e shkakuar për shkak të fatkeqësisë natyrore nga Covid 19, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ndërmoi një sërë masash, jo vetëm për të parandaluar përhapjen e këtij virusi, por edhe për të ardhur në ndihmë, duke siguruar mbështetjen e nevojshme për njerëzit në nevojë. Të gjitha strukturat spitalore dhe institucionet përgjegjëse për menaxhimin e epidemisë, janë në gadishmëri të plotë dhe të angazhuar maksimalisht për ndjekjen dhe zbatimin e çdo protokollit apo udhëzuesi të miratuar për të përballuar këtë situatë. Këto masa të menjëhershme, kanë për qëllim gjithashtu krijimin e një mjedisi të mundshëm për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve të specializuara të ndihmës për</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

										<p>gratë, fëmijët, si edhe viktimat e dhunës në familje. Protokollet dhe udhëzimet specifike janë përgatitur dhe miratuar në mënyrë që këto shërbime të sigurojnë mbrojtje, mbështetje dhe trajtim profesional për rastet e ndodhura gjatë urgjencës së COVID.</p> <p>Udhëzimi Nr 253, datë 10.04.2020, i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “ Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, ka për qëllim përcaktimin e procedurave dhe veprimeve konkrete të strukturave të mbrojtjes dhe fëmijës, për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.</p> <p>Strukturat e Mbrojtjes së Fëmijës, mbështesin, ndërgjegjësojnë, informojnë fëmijët dhe familjet e tyre, rreth situatës së krijuar nga epidemia e shkaktuar nga COVID-19, për masat parandaluese, shenjat dhe simptomat për identifikimin e sëmundjes, rrugët e referimit tek strukturat shëndetësore, numrat e emergjencës dhe si të aksesojnë shërbimet e ofruara, në territorin ku jetojnë. Gjithashtu Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka udhëzuar Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, mbi masat e reja të mbrojtjes që duhet të aplikojnë vetë punonjësit, në periudhën e COVID -19, gjatë punës në terren me fëmijët dhe familjet.</p> <p>Agjencia, gjatë kësaj kohe ka mbajtur në monitorim situatën dhe ka qenë në kontakt të vazhueshëm me strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në të gjithë vendin, duke ofruar mbështetje teknike për menaxhimin e rasteve, duke koordinuar ndërhyrjet institucionale për marrjen në mbrojtje të çdo rasti të fëmijëve të dhunuar, të abuzuar apo neglizhuar, për të siguruar që fëmijët të marrin shërbimet e nevojshme dhe trajtim psikologjik të specializuar.</p> <p>2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka përgatitur draft raportin përfundimtar dhe vlerësues të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020. Ky raport na ofron një pasqyrë të gjerë të zbatimit të Agjendës për periudhën 2017-2020, përmes një analize të hollësishme të të gjithë punës së kryer nga institucionet përgjegjëse për të zbatuar objektivat dhe masat e vendosura. Raporti paraqet të gjithë progresin e deritanishëm, përmes rezultateve të arritura, sfidave të hasura në zbatimin e masave të parashikuara dhe kostove financiare për arritjen e objektivave. Ministria e Drejtësisë ka dhënë kontributin e saj në kuadër të zbatimit të objektivave lidhur me përmirësimin të aksesit të fëmijëve në drejtësi.</p> <p>3. Me Urdhër të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Nr 367, datë 09.06.2020, është miratuar udhëzuesi për “Kriteret e përgjithshme të pjesëmarrjes në aktivitetet,</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

									<p>proceset konsultuese dhe vendimarrëse, që lidhen me fëmijët dhe për fëmijët”. Gjatë procesit për hartimin e udhëzuesit janë zhvilluar gjithashtu konsultime dhe takime edhe me fëmijët, lidhur me hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes. Pas miratimit të këtij dokumenti, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, në bashkëpunim me organizatat partnere, kanë zhvilluar trajnime me 5 bashki të vendit.</p> <p>4. Plani Kombëtar i De-Institucionalizimit 2020-2023 aktualisht është miratuar nga Këshilli i Ministrave, bazuar në një proces vlerësimi të institucioneve të përkujdesit, të ndërmarra për të planifikuar procesin e transformimit (tranzicionit). Plani i veprimit integron politika dhe programe specifike për të zvogëluar institucionalizimin e sistemit të kujdesit për fëmijë, duke synuar shndërrimin e shërbimeve që ofrohen në institucionet rezidenciale në shërbime multidisiplinare me bazë komunitare, të cilat mund të krijojnë alternativa të specializuara të kujdesit, duke siguruar kështu mundësi për një jetë më të mirë dhe të pavarur për grupin e synuar të fëmijëve bazuar në interesin më të mirë të parimit të fëmijës.</p> <p>Të drejtat e fëmijëve për të jetuar në një mjedis familjar të ngrohtë janë të përcaktuara në instrumentat e Kombeve të Bashkuara dhe Traktatet detyruese juridike Evropiane.</p> <p>Në kuadër të procesit të implementit të Planit Kombëtar të De-I është ngritur, me Urdhër nr. 508/tetor 2020, të Ministrisë të SHMS “Komiteti Drejtues” për të siguruar zbatimin e tij.</p> <p>Disa nga arritjet kryesore, gjatë periudhës së raportimit, në kuadër të zbatimit të planit kombëtar të De-I janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. 3 modele të reja shërbimesh dhe procedurash janë hartuar (Qendra për Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen, Shërbimi i Kujdestarisë Alternative Profesionale si edhe Udhëzues i Procedurave për Deinstitutionalizimin e Fëmijëve) b. Kodi i familjes dhe ligji i birësimit janë në proces rishikimi, ndryshime që përmirësojnë dhe përshpejtojnë procedurat e birësimit, pra shkurtojnë periudhën kohore të qëndrimit të fëmijëve nëpër institucione c. Është parandaluar institucionalizimi i 28 fëmijëve duke fuqizuar/ mbështetur familjet biologjike d. Po mbështeten duke i fuqizuar 41 familje që i kanë fëmijët në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror për të mundësuar ribashkimin me familjet biologjike <p>Nëpërmjet krijimit të një linje buxhetore të vecantë, Fondit Social, dhe alokimit të buxhetit qëndror, mundësohet që çdo bashki të ngrejë shërbime shoqërore në territor për grupet në nevojë duke garantuar shërbimet shoqërore minimale (apo shporta e shërbimeve) si dhe qëndrueshmëri</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

										<p>të shërbimeve aktuale sipas nevojave të specifikuar në Planin Social të cdo bashkie. Sfidë shumë e rëndësishme mbetet aftësia e pushtetit vendor për të planifikuar dhe menaxhuar fondet.</p> <p>Për vitin 2020 me fondin e parashikuar në PBS 2020-2020, Programi “Përfshirja sociale dhe përkujdesi social”, janë financuar 14 bashki për ngritjen e 14 shërbimeve të reja, me një fond 61,412,587 ALL, nga këto 8 shërbime të reja për fëmijë.</p> <p><u>5. Takime dhe trajnime të zhvilluara në kuadër të çështjeve që lidhen me fëmijët në nevojë për mbrojtje</u></p> <p>1.Në datën 10-12 shkurt 2020 u organizua një workshop lidhur me menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin me organizatën Terre des Hommes</p> <p>2.Në datat 28 Maj-16 korrik 2020 u zhvillua një seri trajnimesh me temë “Shëndeti Mendor dhe Mbështetja Psiko-Sociale në Situatë Emergjence” - organizuar në bashkëpunim nga MSHMS, UNICEF dhe OBSH</p> <p>3.Në muajt Qershor-Shtator 2020 u organizuan trajnime mbi projektin “Shëndeti në shkolla”- organizuar në bashkëpunim nga MSHMS, organizata “Save the Children” dhe Agjencia Zviceriane për Bashkëpunim dhe Zhvillim.</p> <p>Avokati i Popullit Gjatë situatës, së pandemisë COVID-19, Avokati i Popullit dhe KMPDF ka luajtur rol proaktiv në drejtim të promovimit të të drejtave të fëmijëve, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e institucioneve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor, në ushtrimin e detyrave të tyre funksionale, në përputhje me legjisllacionin në fuqi. Zhvillimi i veprimtarive promovuese është realizuar nëpërmjet publikimit në faqen zyrtare <i>online</i> të AP dhe KMPDF të deklaratave të përditësuara lidhur me situatën e COVID-19, të karakterit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - informues/këshillues për fëmijët në gjuhë të thjeshtë dhe miqësore; - advokues për ndarjen e praktikave më të mira të punës nga organizata ndëkombëtare; - sugjerues/rekomandues për mënyrën e adresimit dhe zgjidhjes adekuate të problematikave të evidentuara gjatë pandemisë. - <p>Konkretisht, institucioni i Avokatit të Popullit, për t’u ardhur në ndihmë të gjithë institucioneve shtetërore përgjegjëse në ushtrimin e detyrave të tyre funksionale, pjesë e qenësishme e zinxhirit të sistemit të integruar të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>mbrojtjes së fëmijës, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e jetës së fëmijëve, edhe pse në këtë situatë të pazakontë, në përputhje me profilin dhe nevojat e tyre rekomandoi edhe:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Marrjen e masave për dezinfektimin e mjediseve në institucionet e privimit të lirisë a paraburgimit, ku trajtohen të miturit në konflikt me ligjin. ➤ Marrjen e masave për të miturit në konflikt me ligjin, të cilët janë duke vuajtur dënimet në institucionet e privimit të lirisë për të bërë të mundur aplikimin e programeve rehabilituese dhe/ose të ndërmjetësit për dënimet alternative ose aplikimin e dënimeve alternative të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur. Gjithashtu, aplikimin e masave të shmangies alternative nga dënimi. <p>Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve (SMPDF) në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me UNICEF, ka kryer 4 inspektime në komisarate apo Drejtoritë Vendore të Policisë, me qëllim monitorimin e zbatimit të masave anticovid, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - inspektimin e Komisarariatit të Policisë Tropojë; - inspektimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër; - inspektimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë; - inspektimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës. <p>Po kështu, përgjatë periudhës kohore janar-dhjetor 2020, SMPDF, lidhur me rastet e trajtuara “<i>ex-officio</i>” apo edhe për ato të cilat janë realizuar inspektime, e më pas janë hartuar dhe adresuar rekomandime, me qëllim mbrojtjen e fëmijës, si dhe realizimin e ndërhyrjeve për respektimin e të drejtave të fëmijës, duke kërkuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrjen e masave, për organizimin e trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme për punonjësit dhe profesionistët e tjerë, që punojnë në fushat e rendit dhe sigurisë publike, për edukimin mbi/rreth të drejtave të fëmijës. - Marrjen e masave, për hartimin e procedurave standarde operative për punonjësit e Policisë së Shtetit, për qasjen e tyre kundrejt fëmijëve në përputhje me standardet ndërkombëtare të adresuara për këtë qëllim, si dhe aktet ndërkombëtare e kombëtare në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. - Marrjen e masave, për kryerjen e testeve të gjendjes psiko-sociale dhe emocionale në mënyrë të
--	--	--	--	--	--	--	--	--

									<p>herëpashershme, të të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit dhe profesionistëve, që punojnë apo janë në kontakt të drejtpërdrejt me fëmijët.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Marrjen e masave, për rritjen e bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit të punës me strukturat e tjera, të cilat ofrojnë shërbime publike, për të mundësuar mbështetjen e të miturit në konflikt me ligjin në procesin penal. - Marrjen e masave, për kryerjen e intervistave me të miturit në konflikt me ligjin, viktime dhe/apo dëshmitarë, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme të intervistimit, në bazë të gjendjes dhe nevojave specifike të të miturit, ashtu sikundër parashikon edhe shkronja “dh”, të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr.37/2017. - Marrjen e masave, për të siguruar marrjen në pyetje të të miturit në një mjedis miqësor, duke krijuar kushtet e përshtatshme në përputhje me gjininë, gjendjen shëndetësore dhe psikologjike të tij, sipas përcaktimeve në nenin 33, të ligjit nr.37/2017. - Marrjen e masave, nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës, për sigurimin nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, të listës së avokatëve të specializuar në drejtësinë penale për të mitur, në përputhje me ligjin nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”. - Marrjen e masave, nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës në Bashkinë Tropojë, për hartimin e listës së përfaqësuesve proceduralë për të miturit në konflikt me ligjin, viktime dhe/apo dëshmitarë në procesin penal, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” dhe udhëzimit nr.650, datë 13.9.2019, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Drejtësisë “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktime dhe dëshmitarë në procesin penal”. - Marrjen e masave, nga Drejtoria Vendore e Policisë Kukës, për shpërndarjen e informacionit të shpejtë dhe të përditësuar, në lidhje me masat mbrojtëse anticovid, krijimin e infrastrukturës karantinë, dezinfektimin e vazhdueshëm të mjediseve dhe pajisjen me bazën materiale të nevojshme (dezinfektant, alkool etj). - Marrjen e masave, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për organizimin e trajnimeve dhe kualifikimeve të vazhdueshme për punonjësit dhe profesionistë të tjerë, që punojnë në fushat e rendit dhe sigurisë publike, për edukimin mbi/rreth të drejtave të fëmijës.
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

												<ul style="list-style-type: none"> - Marrjen e masave, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për hartimin e procedurave standarde operative për punonjësit e Policisë së Shtetit, për qasjen e tyre kundrejt fëmijëve, në përputhje me standardet ndërkombëtare të adresuara për këtë qëllim, si dhe legjislacionit ndërkombëtar dhe atij të brendshëm në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. <p>Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) ¹¹, gjatë kësaj periudhe në përbushje të funksionit mbrojtës dhe parandalues, e ka ushtruar detyrën e tij duke monitoruar në vazhdimësi institucionet ku privohet liria. Monitorimet dhe kontaktet kanë qenë fizike dhe janë kryer dhe inspektimet <i>online</i>.</p> <p>Nga ana e Mekanizmit Kombëtar, kontaktet me këto institucione kanë qenë të vazhdueshme dhe intensive, përfshirë dhe Institutin e të Miturve Kavajë, që prej fillimit të pandemisë në vend. MKPT-ja si një mënyrë alternative ka zgjedhur kryerjen e inspektimeve online. Është zgjedhur kjo praktikë e re dhe e domosdoshme për të shmangur rrezikun e infektimit dhe parandalimin e përhapjes së mëtejshme të pandemisë, duke pasur në fokusin tonë primar zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe respektimin e akteve ndërkombëtare për parandalimin e torturës, trajtimin të egër, çnjerëzor e poshtërues.</p> <p>Nga data 15 mars deri 25 prill 2020 është marrë informacion nga drejtuesi i IEVP-së Kavajë, ku ndodheshin gjithsej 22 të mitur, nga të cilët 21 të paraburgosur dhe 1 i dënuar. Në datën 8.3.2020, në institucion kanë shkuar dy të paraburgosur, të cilët nuk kanë pasur probleme shëndetësore. Në këtë mënyrë, është evidentuar dhe në kartelën shëndetësore të secilit të mitur të dënuar apo të paraburgosur, në këtë institucion.</p> <p>IEVP Kavajë ka informuar mbi masat e marra për stafin e institucionit në lidhje me mospërhapjen apo parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19. Është ngritur me shpejtësi stafi i shëndetësisë në këtë institucion, që ndjek të gjithë masat e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë, për parandalimin apo mospërhapjen e virusit COVID-19, që nga pritja e personelit dhe deri te familjari apo çdo person tjetër, që futet në IEVP Kavajë, i bëhet i ditur mbi</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

								<p>kontrollin që do i bëhet nga personeli shëndetësor i gatshëm.</p> <p>E njëjta procedurë kryhet dhe me familjarët e të miturve, edhe pse ata nuk kanë kontakte të drejtpërdrejta me fëmijët e tyre. Institucioni ka bërë të mundur kontaktin me Skype, ku janë përshtatur dy dhoma, njëra tek dhoma e takimeve “skype-1”, për familjarët, dhe tjetra të dhoma e pranimit “skype-2”, për të miturit, ku bëhet e mundur dhe biseda me skype prind-fëmijë.</p> <p>Në IEVP Kavajë, është kryer dezinfektimi total nga subjekte të licensuara për DDD (dezinfektim, deratizim, dezinspektim), si dhe me rekomandimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Institucioni i Ekzekutimeve të Vendimeve Penale për të Mitur në Kavajë, në bashkëpunim me stafin e shëndetësisë, edukimit dhe policisë ka realizuar bashkëbisedim testim, me të miturit e parburgosur dhe të dënuar për situatën aktuale dhe kujdesin që duhet të kenë, në ruajtjen e distancës me njëri-tjetrin, etj.</p> <p>Po ashtu, ky institucion ka krijuar tre dhoma observimi, që do shërbejnë për të miturit të parburgosur apo të dënuar, nëse do ketë me vira stinale të shoqëruara me temperaturë ose kollë, në këtë mënyrë këto dhoma do të jenë në dispozicion të tyre dhe kujdesi shëndetësor në 24 orë.</p> <p>Në datë 11.11.2020, Mekanizmi Kombëtar kreu një <i>inspektim periodik online</i> në Institutin e të Miturve Kavajë, Në ditën e monitorimit online në këtë institucion ndodheshin 22 mitur, të gjithë parburgosur. Nga informacioni i marrë, grupi i inspektimit, gjatë videokonferencës kërkoi të informohet në veçanti edhe mbi masat e marra nga ana e këtij institucioni, për parandalimin e sëmundjes infektive Covid-19. Nga informacioni i dhënë nga drejtori dhe stafi, rezultoi se:</p> <p>Është zbatuar protokoli shtesë i shëndetësisë për masat anti Covid-19, në kuadrin e pandemisë, duke i parashikuar ato në një rregullore të veçantë të institucionit. I gjithë personeli zbaton me korrektesë masat mbrojtëse dhe dezinfektuese, si në mjetet e udhëtimit (kolektive dhe personale), por sidomos në ambientet e punës me mbajtjen e maskave, duke ruajtur distancimin social dhe higjienën personale. Janë shmangur ose minimizuar grumbullimet e stafit në rreshtime, mbledhje dhe kontaktet me të dënuarit dhe njëkohësisht janë dhënë porosi të dënuarve dhe të</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

										<p>paraburgosurve, që mos të krijojnë grumbullime gjatë orareve të veprimeve të përbashkëta. Lidhur me këtë inspektim po hartohet raporti dhe do t'u përcillet drejtuesve të burgjeve shoqëruar me rekomandimet përkatëse.</p> <p>Programi Shqiptar-Suedez i Drejtësisë Penale për të Mitur</p> <p>Mjetet, instrumentet, modelet, manualët dhe procedurat që janë zhvilluar së bashku brenda programit suedez të drejtësisë për të mitur shqiptarë do të mbulojnë kërkesat në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe do të përmbushin standardin e burgjeve evropiane dhe rregullat e provës në lidhje me menaxhimin e çështjeve të të miturve. Implementimi i produkteve është duke vazhduar dhe do të përfundojë kur të shpallet miratimi zyrtar nga agjencia përkatëse.</p> <p>Terre des Hommes</p> <p>Ka vijuar me ngritjen e kapaciteteve, ku gjatë kësaj periudhe janë trajnuar 291 nxënës të shkollave dhe mësues mbi parimet e drejtësisë restauruese për të mitur në Tiranë, Korçë, Durrës, etj. Janë trajnuar 20 mediator dhe u janë rritur kapacitetet për trajnimin e çështjeve penale.</p> <p>SIDA</p> <p>Për peridhën raportuese, është përgatitur material informues për shmangien e cili do t'u shpërndahet të miturve.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

Objektivi 2: Garantimi i procesit të rregullt ligjor për të miturit

Nr.	Aktivitete	Afati i realizimit	Institucioni përgjegjës	Indikatorët e zbatimit	Buxheti i parashikuar për vitin 2020	Buxheti i shpenzuar për realizimin e aktivitetit Janar-Dhjetor 2020		Statusi i aktivitetit për periudhën Janar-Dhjetor 2020 (E realizuar/në proces/ porealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën Janar-Dhjetor 2020
						Buxheti Shtetit	Donatorë		
<p>Indikatorët - numri i seksioneve në gjykata dhe prokurori për të miturit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - numri i gjyqtarëve/prokurorëve/oficerëve të policisë/avokatëve/psikologëve/ndërmjetësve/punonjësve të sistemit peniteciar të trajnuar për çështjet e të miturve; - numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe përfaqësuesve procedurale; - numri i institucioneve që hedhin të dhëna në Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur; - numri i akteve ligjore/nënligjore të miratuara me qëllim bashkërendimin e punës në një mjedis të përshtatur për fëmijët; 									
<p>Objektivi Specifik 1: Seksione të specializuara për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të miturit</p>									

1.1	Hartimi dhe miratimi i kuadrit rregullator për ngritjen e seksioneve për të miturit në gjykata dhe prokurori	2019-2020	MD, KM, KLGJ, KLP	Miratimi i 1 (një) vendimi të KM për përcaktimin e hartës së re gjyqësore	0		Realizuar	<p>Këshilli i Lartë Gjyqësor KLGJ, me Udhëzimin nr. 79, datë 30.05.2019, përcakton rregulla mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur. Me anë të këtij udhëzimi <i>detyruet</i> KLGJ udhëzon gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit të juridiksionit të përgjithshëm që të caktojnë së paku 3 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale. KLGJ ngarkon këshillat e gjykatave për zbatimin e udhëzimit, përditësimin e listës së gjyqtarëve që specializohen në fushën e Drejtësisë Penale për të mitur, si edhe përcjelljen te KLGJ të këtyre listave, për të patur në vijimësi informacion të saktë mbi gjyqtarët e specializuar për çështjet me të mitur.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë Prokuroria organizohet dhe funksionon pranë sistemit gjyqësor (neni 12 i Ligjit nr.97/2016). Seksioni i posaçëm për të miturit ngrihet, në çdo rast, në prokuroritë pranë gjykatave në të cilat janë krijuar seksionet përkatëse për gjykimin e të miturve. (neni 21 i Ligjit 97/2016). Me Udhëzimin nr.79, datë 30.05.2019 Këshilli i Lartë Gjyqësor “Mbi caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve të drejtësisë për të mitur”, ka rregulluar gjykimin e çështjeve penale me të mitur. Seksionet pranë prokurorisë funksionojnë sipas organizimit të seksioneve në sistemin gjyqësor. Në prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm janë krijuar gjithsej 11 seksione. Në prokuroritë e tjera, për shkak të numrit të ulët të prokurorëve nuk është e mundur të ngrihen seksione. Bazuar në nenin 29 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ndjekja penale në çështjet e drejtësisë penale për të mitur në këto prokurori bëhet nga prokurorë të trajnuar dhe/ose specializuar në këtë fushë.</p> <p>Prokuroria e Përgjithshme Në zbatim të ligjit për prokurorinë, në çdo prokurori krijohen seksione me jo më pak se tre prokurorë bazuar në numrin dhe specializimin e prokurorëve, llojin e përhapjen e veprave penale, subjekteve e rekomandimeve prioritare. Nga ana</p>
-----	--	-----------	-------------------	---	---	--	-----------	---

									tjetër, ligji parashikon që në strukturën e prokurorisë të përfshihet detyrimisht seksioni për të miturit, në rast se gjykata përkatëse e ka një të tillë.
1.2	Fuqizimi i seksioneve për të miturit në gjykata dhe prokurori	2019 - 2021	KLGI, KLP	Numri i seksioneve në gjykata dhe prokurori për të miturit dhe specializimi 100 -150 magistratë dhe oficerë të policisë gjyqësore për çështjet e të miturve	160,920,000	Advokimi i UNICEF në këtë rast është i pakuantifikueshëm pasi konsiston në kohën e stafit të vet	Proces	<p>UNICEF UNICEF ka advokuar me KLGJ-në dhe KLP-në për nxjerrjen e akteve të nevojshme si dhe zbatimin e tyre lidhur me rritjen e numrit të prokurorëve, punonjësve të policisë, gjyqtarëve, e profesionistëve të tjerë të sektorit të drejtësisë që caktohen për t'u specializuar dhe për të punuar me të miturit. Si rezultat, nga informacionet që disponojmë ky numer eshte rritur nga 12 gjyqtarë dhe prokurorë në vitin 2018 (që ka qënë para fillimit të zbatimit të kesaj Strategjie) në 143 ne 2020.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor Udhëzimi nr. 79, datë 30.05.2019, i sipërcituar, udhëzon gjykatat që të nxisin dhe lehtësojnë ndjekjen e programeve të trajnimeve vazhduese në fushën e Drejtësisë Penale për të Mitur, me qëllim specializimin e gjyqtarëve. Me anë të këtij udhëzimi detyrues KLGJ udhëzon gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit të juridiksionit të përgjithshëm që të caktojnë së paku 3 gjyqtarë për gjykimin e çështjeve penale me të mitur në konflikt me ligjin ose të mitur viktimë nga vepra penale, si edhe ndjekjen e programeve të trajnimeve vazhduese në fushën e Drejtësisë Penale për të Mitur, me qëllim specializimin e gjyqtarëve. KLGJ ngarkon këshillat e gjykatave për zbatimin e udhëzimit, përditësimin e listës së gjyqtarëve që specializohen në fushën e Drejtësisë Penale për të mitur, si edhe përcjelljen te KLGJ të këtyre listave, për të patur në vijimësi informacion të saktë mbi gjyqtarët e specializuar për çështjet me të mitur.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë Këshilli i Lartë i Prokurorisë bashkëpunon me Shkollën e Magistraturës në lidhje me trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe forcimin e seksioneve për të miturit në prokurori. Me vendimin nr. 52 datë 11.02.2020 Këshilli i</p>	

									<p>Lartë i Pokurorisë ka miratuar aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Janar- Mars 2020.</p> <p>Me vendimin nr. 129, datë 19.05.2020 Këshilli i Lartë i Pokurorisë ka miratuar aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Prill- Qershor 2020.</p> <p>Me vendimin nr. 233, datë 27.10.2020 Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka miratuar aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe pjesëmarrjen e prokurorëve në trajnimin vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës, për periudhën Tetor- Dhjetor 2020.</p> <p>Prokuroria e Përgjithshme</p> <p>Janë krijuar seksione në 11 prokurori të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm.</p> <p>Nga ana tjetër, pavarësisht se në prokuroritë e tjera për shkak të numrit të ulët të prokurorëve nuk është e mundur të ngrihen seksione, bazuar në nenin 29 të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ndjekja penale në çështjet e drejtësisë penale për të mitur në këto prokurori bëhet nga prokurorë të trajnuar dhe/ose specializuar në këtë fushë.</p>
Objektivi Specifik 2: Profesionistë të specializuar në drejtësinë për të miturit									
2.1	Specializimi dhe trajnimi i profesionistëve që mbulojnë të drejtat e fëmijëve në çështjet e drejtësisë	2018 - 2021	MD, SHM, ASHMDF, UP/Punonjës Social, DHKA, DHKNd, DPB, Shërbimi i Provës, IML, KSHB, OJF/Donatorët	1. Hartimi i kurrikulave/programe trajnimi për: - oficer policie, - gjyqtarë, - prokurorë, - punonjës të NJMF, - punonjës të shërbimit të provës, - burgjeve, - avokat, - ndërmjetës, - psikolog, - përfaqësuesit proceduralë, - profesionistë të tjerë: 2. Trajnimi/specializimi i 150-200 punonjësve	674,640	0	ALL 716,666	Realizuar	<p>UNICEF</p> <p>UNICEF, në partneritet me Save the Children dhe fonde të MPJ të Norvegjisë ka trajnuar 62 profesionistë të disiplinave të ndryshme lidhur me menaxhimin ndër-sektorial të rasteve të fëmijëve në konflikt dhe në kontakt me ligjin në qarkun e Beratit dhe te Gjirokastres.</p> <p>Shkolla e Magjistraturës</p> <p>1. Aktivitet trajnues datë 4-5 shkurt 2020 me temë “Masat e sigurimit dhe dënimet ndaj të miturve – duke synuar një praktikë të unifikuar bazuar në rastet konkrete” (të trajnuar 8 gjyqtar / 9 prokurorë / 4 këshilltar ligjor pranë PP)</p> <p>2. Aktivitet trajnues online datë 22 prill 2020 me temë “Risite e ligjit nr. 35/2017, lidhur me pozitën (statusin) procedurale të “viktimit”, përfshirë edhe “të miturin viktimë” (sipas ligjit nr. 37/2017 – Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturin” (të</p>

trajnuar 5 gjyqtar dhe 1 prokuror)

3.Aktivitet trajnuar online datë 4-5 qershor 2020 me temë “Sistemi i integruar i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe rëndësia e bashkëpunimit institucional në zbatim të parimeve të KDF-së dhe të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Vlerësimi i riskut nga gjykata dhe zbatimi i masave emergjente të mbrojtjes” (të trajnuar 10 gjyqtar, 1 prokuror, 1 Avokat Shteti dhe 4 koordinatorë)

4.Aktivitet trajnuar online datë 28 tetor me temë “Çfarë ndodh pas dënimit? Roli i prokurorëve dhe gjyqtarëve në ekzekutimin e shmangies, dënimeve penale ndaj të miturve. Orientim për lirim të kusht në rastet me të mitur” (Të trajnuar, 7 Prokurorë, 11 Gjyqtarë, 4 OPGJ)

5.Aktivitet trajnuar online datë 1-2 dhjetor me temë “Aplikimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit – masat e sigurimit, shmangia dhe arsyetimi ligjor i dënimeve penale” (Të trajnuar 22 kandidatë për magjistratë)

6.Aktivitet trajnuar online datë 16 dhjetor me temë “Masat mjekësore dhe edukuese, sipas nenit 46 të Kodit Penal: Problematikat që paraqesin dispozitat e KPP mbi mënyrën e shqyrtimit dhe vendimmarrjen për këto raste. Cila është procedura që duhet ndjekur për caktimin e masave mjekësore dhe edukuese. Çfarë parashikon Kodi i Drejtësisë Penale për të Miturit për masat edukuese. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkeses me objekt caktimin e masës mjekësore Gj.S.P apo Gj.Th? Specifikat e shqyrtimit të saj, zbatimi i diferencuar në praktikën gjyqësore dhe nevoja për trajtim/unifikim në interpretim të dispozitave të K.Pr.Penale” (Të trajnuar 12 Prokurorë, 11 Gjyqtarë, 1 Kordinator, 1 Kandidat për Magjistrat)

Për shkak të situatës së krijuar nga COVID 19, janë anuluar 2 aktivitete trajnuese për të miturit, parashikuar për t'u zhvilluar gjatë muajit mars dhe maj duke e çuar numrin e personave të trajnuar në total për të gjitha aktivitetet në 116 persona.

Prokuroria e Përgjithshme

Komisioni i Policisë Gjyqësore po bashkëpunon me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin vazhduar të oficerëve të policisë gjyqësore. Në këtë kuadër Shkolla, ka parashikuar në kalendarin e trajnimeve tema të posaçme për trajnimin e OPGJ në fushën e drejtësisë për të mitur.

Gjatë vitit 2020, në kuader të projektit në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës, janë zhvilluar aktivitetet e mëposhtme:

*4-5 shkurt 2020

Trajnim i vazhduar:

Masat e sigurimit dhe dënimet ndaj të miturve - praktikë e unifikuar bazuar në çështje reale

*25-26 Mars 2020

Trajnim në fushën e Drejtësisë Penale për të Mitur në Tiranë

Trajnim i vazhduar II:

Çfarë ndodh *në praktikë* pas një vendimi për shmangie ose vendim dënimi? – Roli i prokurorëve dhe gjyqtarëve në ekzekutimin e masës së shmangies, dënimeve ndaj të miturve dhe dënimeve alternative. Një orientim për lirimin me kusht në çështjet me të mitur:

*28 tetor 2020

Trajnim i vazhduar II:

Çfarë ndodh *në praktikë* pas një vendimi për shmangie ose dënim?

– ekzekutimi i shmangies dhe dënimit ndaj të miturit dhe kuptimi dhe zbatimi praktik i RVI-së

*1 dhe 2 dhjetor 2020

Trajnimi fillestar

Zbatimi i Kodit të Drejtësisë Penale për të miturit -shmangia, masat e sigurimit dhe arsyetimi ligjor për dënimet ndaj të miturve.

Komiteti Shqiptar i Birësimeve

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2020, punonjësit e institucionit tonë nuk kanë marrë pjesë në asnjë trajnim mbi fushën e të drejtave të fëmijëve.

Nga ana e stafit të KSHB është paraqitur në rrugë elektronike sugjerim pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për organizimin dhe pjesëmarrjen në trajnime mbi aspekte të ndryshme sociale dhe psikologjike të fëmijët, por nuk kemi marrë dijeni për zhvillimin e trajnimeve mbi këto tema.

Shërbimi i Provës

Shërbimi i Provës është pjesë e Programit Shqiptar-Suedez të Drejtësisë për të Mitur. Kurikulat do të hartohen në vijimësi pas miratimit të akteve nënligjore të Ligjit nr. 78/2020 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit të

Provës”.

17 punonjës kanë qenë pjesë e trajnimeve të avancuara gjatë vitit 2020, të cilat kanë qenë të pakta për shkak të pandemisë së COVID-19

Akademia e Sigurisë

Gjatë periudhës raportuese, me mbështetjen e Projektit Suedez DPM, u krijua një grup pune për hartimin e kurrikulës së trajnimit me temë “Teknikat shkencore të intervistimit të të miturve”. Në këtë grup pune morën pjesë dhe dy specialistë nga Akademia e Sigurisë.

Përshkrimi i arritjeve për periudhën raportuese: Një kurrikulë e plotë për trajnimin me temë “Teknikat shkencore të intervistimit të të miturve”, i parashikuar të zhvillohet me specialistët e hetimit në rolin e oficerit të policisë gjyqësore që angazhohen në sistemin e drejtësisë penale për të mitur.

Në përfundim të procesit, u hartua një kurrikulë e plotë, e cila siguron që përfituesit të pajisen me njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për kryerjen e hetimeve penale me përfshirje të të miturve, me fokus interesin më të lartë të tyre.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

Kurrikula e trajnimit është hartuar me mbështetjen e KiE në vitin 2018 dhe përmban 12 tema specifike mbi:

- sistemin e drejtësisë për të mitur,
- instrumentat ndërkombëtarë mbi administrimin e drejtësisë për të miturit,
- standardet e kujdesit në burg,
- kujdesi pas lirimit dhe ri-integrimit,
- komunikimi dhe parimet e punës me të miturit brenda sistemit penitenciar,
- praktikën e punës në ekip,
- punën individuale-teknikat dhe metodat e punës,
- teknikat e përfshirjes së të miturve,
- klimën e sigurt për ndërhyrje terapeutike,
- vlerësimin e riskut dhe faktorët mbrojtës,
- sigurinë, rendin dhe disiplinën
- shërbimin shëndetësor për të miturit.

Gjatë vitit 2019, kësaj kurrikule i janë shtuar edhe temat mbi intervistimin motivues, modeli RNR (risku-nevoja-reagimi), punën konjitive-bihejviorale, zgjidhjen e problemeve dhe aftësitë sociale. Stafit trajtues në Institucionin për të Mitur në Kavajë, ku ndodhen të gjithë të miturit në sistemin e burgjeve, përbëhet nga 5 punonjës të sektorit social, 7 punonjës së sektorit të

shëndetësisë dhe 47 punonjës të sektorit të sigurisë.

Përgjatë vitit 2020 është bërë e mundur trajnimi i 80% të stafit të këtij Institucioni, sipas kurrikulës së trajnimit për stafin që trajton të miturit.

Trajnimet janë zhvilluar përmes sesioneve online, për shkak të situatës së pandemisë.

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Gjatë kësaj periudhe është punuar për hartimin e një programi mësimor dhe kurrikulës “Për teknikat shkencore të intervistimit të të miturve”. Në këtë kuadër janë realizuar si vijon;

- Janë organizuar dhe zhvilluar dy seminare tre ditore “Për hartimin e kurrikulave mbi teknikat e intervistimit të të miturve”, në të cilën morën pjesë dy eksperte Suedeze, të cilët punojnë në fushën e intervistimit të të miturve, si dhe specialistë nga Akademia e Sigurisë, Specialisti i Sektorit për të Mitur dhe Dhunën në Familje në DPPSH, Specialistë për Hetimin e Krimeve dhe për të Mitur dhe Dhunën në Familje, pranë Komisariateve të Policisë, dhe një psikolog nga DVP - Tiranë.
- Si rezultat seminareve të sipërpërmendur, si dhe ekspertizës dhe kontributit të dhënë nga ana e ekspertëve Suedeze, është mundësuar hartimi i projekt Programit Mësimor, dy javor për “Teknikat e Intervistimit Shkencor të të Miturve”, i cili aktualisht është në fazë konsultimi.
- Gjatë periudhës Janar – Mars 2020 u planifikua dhe organizua një trajnim tre javor, trajnim trajnerësh mbi “Teknikat shkencore të intervistimit për të mitur”. Dy javët e para të trajnimit kanë përfunduar, por java e tretë u pezullua dhe është shtyrë për shkak të situatës COVID-19

Është hartuar dhe miratuar Program Pune Nr.1737, datë 04.03.2020, “Për zbatimin e masave dhe përbushjen e detyrimeve që burojnë nga “Plani Kombëtar i Veprimit për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, përfshirë fëmijët në situatë rruge 2019 – 2021”, në të cilin janë parashikuar detyra konkrete për strukturat qendrore dhe vendore të Policisë së Shtetit.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës

Si rezultat i gjendjes së krijuar nga COVID -19

dhe shpalljes të gjendjes së fatkeqësisë natyrore nga qeveria shqiptare me VKM Nr.243, datë 24.03.2020 “Për shpalljen e gjëndjes së fatkeqësisë natyrore”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka miratuar Udhëzim Nr.253, datë 10.04.2020 “Për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për arsye të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Ky Udhëzim ka për qëllim të përcaktojë procedurat dhe veprimet konkrete të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19.

Janë organizuar takime online në 5 bashki për promovimin e Udhëzuesit për pjesëmarrjen e fëmijëve, të miratuar me Urdhër të Ministrit të MSHMS. Në këto takime kanë marrë pjesë NJMF, mësues, psikologë shkollorë punonjës socialë nga qendrat e ndryshme të shërbimeve sociale në bashki.

Në bazë të këtij Udhëzimi Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës në bashki ose njësi administrative, bashkëpunojnë në mënyrë aktive me punonjësit e shëndetit, psikologët e shkollave për përditësimin e informacionit lidhur me evidentimin dhe trajtimin e rasteve të dyshuara me COVID-19 në territorin e tyre si dhe për referimin dhe trajtimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, duke përfshirë këtu edhe fëmijët në konflikt me ligjin.

Udhëzimi është ndarë me stukturat e mbrojtjes së fëmijëve në bashki, shërbimet sociale rajonale dhe me drejtoritë e policisë vendore në 12 qarqet e vendit. ASHDMF ka udhëzuar që gjatë kësaj periudhe, Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës të bashkëpunojnë ngushtë dhe të ndajnë informacione kryesisht me punonjësit e policisë dhe shëndetësisë.

Gjatë periudhës janar-qershor janë zhvilluar takime periodike javore online mes ASHDMF, UNICEF dhe punonjësve për mbrojtjen e fëmijëve. Në këto takime janë dhënë udhëzime teknike për PMF-të lidhur me rastet që mund të identifikohen dhe procedurat që do të ndiqen.

Gjatë muajit korrik ASHDMF ka organizuar takime online në 5 bashki për promovimin e Udhëzuesit për pjesëmarrjen e fëmijëve, të miratuar me Urdhër të Ministrit të MSHMS. Në këto takime kanë marrë pjesë NJMF, mësues, psikologë shkollorë punonjës socialë nga qendrat e

ndryshme të shërbimeve sociale në bashki.

Dhoma Kombëtare e Avokatisë

Për periudhën raportuese u organizua një takim i përbashkët ndërmjet DHASH dhe Drejtorit të sapoemëruar të DNJF me datë 30 qershor 2020 me qëllim përcaktimin dhe forcimin e bashkëpunimit lidhur me trajnimin e avokatëve të listës së ndihmës juridike dhe hartimin e një programi të veçantë trajnimi për këta të fundit. Janë specializuar 30 avokatë mbi KDPM në 2019. Pavarësisht se lista e avokatëve të specializuar është dërguar në gjykata dhe prokurori si dhe në Ministrinë e Drejtësisë, bazuar në shqetësimet e përcjella nga këta avokatë, caktohen avokatë jo të specializuar për të miturit në konflikt me ligjin. DHASH në bashkëpunim me Programin HELP të Këshillit të Europës kishte parashikuar trajnimin dhe specializimin e avokatëve për të miturit në Prill 2020. Për shkak të situatës së pandemisë ky proces është shtyrë për në vjeshtë 2020.

World Vision

1. Me bashkëpunimin e organizatës Nisma për ndryshim shoqëror - ARSIS, World Vision Albania ka ofruar nga 2 trajnime/sesione për Oficerët e Policisë Gjyqësore që shërbejnë në Komisaritet ku janë ndërtuar Hapësira miqësore: sesioni i parë orientues lidhej me praktikën e përdorimit të sistemit audio-vizual brenda hapësirës miqësore për fëmijët dhe trajnimi tjetër ishte mbi përdorimin e një qasjeje miqësore për fëmijën gjatë ndërveprimit me të. Gjithsej, 15 oficerë të policisë gjyqësore përfituan nga trajnimet e sipërpërmendura. Pjesë integrale e projektit të lartpërmendur ishte gjithashtu edhe prodhimi nga ekspertë të fushës i një dokumenti mbi "Udhëzimet Procedurale për intervistimin e të miturve në kontakt/konflikt me ligjin, brenda Hapësirave miqësore në Komisaritet e Policisë".

2. Përmes marrëveshjes së bashkëpunimit me TLAS, janë organizuar 4 seanca trajnimi për ndërtimin e kapaciteteve të profesionistëve në Kamëz, Korçë, Librazhd, Lezhë & Kurbin) për zbatimin efektiv dhe të saktë të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, Kodin e Drejtësisë Penale për të mitur, Ligjin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, dhe ligji për taksat dhe tarifën gjyqësore. Këto trajnime synojnë në ngritjen e kapaciteteve për profesionistët që punojnë me fëmijët, me përfaqësues të njësive të mbrojtjes së

fëmijëve, shërbimeve sociale dhe përfaqësuesve të World Vision lidhur me sa më sipër.

Terre des Hommes

Në bashkëpunim me DHKA-në janë përgatitur udhëzues dhe trajnime mbi “Drejtësinë Miqësore për të Miturit, dhe veçanërisht rolin e Avokatit në Përdorimin e Programeve të Drejtësisë Restauruese dhe Masave të Shmangies nga procesi penal për fëmijët në konflikt me ligjin”. Janë botuar 200 kopje udhëzues dhe 500 kopje manual trajnimi. Në bashkëpunim me DHKA-në dhe Programin Help të Këshillit të Evropës janë organizuar 2 ditë trajnim për hyrje në kursin online të drejtësisë restauruese. Janë trajnuar 291 nxënës të shkollave dhe mësues mbi parimet e drejtësisë restauruese për të mitur në Tiranë, Korçë, Durrës, etj. Pas organizimit më datë 10-12 shkurt 2020 të workshopit konsultues mbi menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin në bashkëpunim me Strukturat e Mbrojtjes së Fëmijëve, është përfunduar hartimi i **“Protokollit i Punës për menaxhimin e Rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin”**, dhe draft **“Instrumenti i Monitorimit për zbatimin e Protokollit të Punës për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin”**. Të dyja këto dokumenta janë dërguar pranë MSHP-së për zyrtarizim. Ka përfunduar procesi i hartimit dhe akreditimit të moduleve mbi drejtësinë restauruese si pjesë e trajnimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës. Janë botuar 500 kopje të moduleve të hartuara. Në kuadër të specializimit të profesionistëve që mbulojnë të drejtat e fëmijëve në çështjet e drejtësisë, “Terre des Hommes” ka vijuar me hartimin dhe trajnimin për rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile mbi qasjet e drejtësisë restauruese. Ka përfunduar zbatimin e ndërhyrjeve të 10 organizatave lokale të mbështetura nëpërmjet skemës së granteve të vogla nga TDH-ja të zbatuara në Tiranë, Durrës, IEVP Kavajë/seksioni i te miturve, Gjirokastër, Shkodër dhe Vlorë. Janë trajnuar nëpërmjet kësaj skeme dhe këtyre ndërhyrjeve profesioniste në fushën e

drejtësisë për të mitur (punonjës policie, avokatë, psikologë, mësues, psikologë shkollash, mediatorë, punonjës të mbrojtjes së fëmijëve etj), janë organizur aktivitete informuese me fëmije dhe të rinj mbi kuarin e ri ligjor, janë siguruar seanca ndërmjetësimi, mbështetje ligjore dhe keshillim psikologjik për disa raste të indentifikuar në konflikt me ligjin nga nderyrjet në terren duke krijuar mundësinë e hartimit dhe zbatimit të praktikave të mira. Janë *trajnuar 20 mediatorë* dhe u janë rritur kapacitetet për trajtimin e çështjeve penale për të mitur nëpërmjet ndërmjetësimit. Gjithashtu, një seri trajnimesh do të zbatohen në bashkëpunim dhe nën çertifikimin e Dhomës Kombëtare të Mediatorëve. Janë trajnuar mbi konceptet e drejtësisë restauruese, *15 stafe* edukative dhe policë nga Instituti i të miturve në Kavajë, dhe institucionet e vuajtjes së dënimit në Lezhë, Durrës, Rogozhinë, Tiranë dhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Ka përfunduar hartimi i modelit të ri-integrimit për fëmijët në konflikt me ligjin, protokollin e punës dhe procesin e konsultimit. Janë trajtuar me shërbimin e ri-integrimit, punësimin, trajnimin profesional dhe mbështetjes sipas nevojës, në bashkëpunim me Shërbimin e Provës dhe OJF-ve, *25 raste të të miturve* në konflikt ose kontakt me ligjin në Tiranë.

Urdhëri i Psikologut

Për periudhën raportuese pas vijimit me trajnime, UP gjatë periudhës së pandemisë ka hasur vështirësi për vijimin e aktiviteteve për shkak të buxhetit.

SIDA

Për periudhën raportuese, SIDA ka përgatitur instrumente vlerësimi të riskut dhe modelin për planin individual të trajtimit dhe manualin për instrumentin përkatës. Janë trajnuar 9 punonjës të burgjeve, 17 të shërbimit të provës dhe 1 nga MD. Është përgatitur dhe shpërndarë Përmbledhja e Praktikës Gjyqësore për dënimet ndaj të miturve. Kjo përmbledhje titullohet: Praktika gjyqësore në çështjet e drejtësisë penale me të mitur: Zbatimi i KDPM në gjykatat e Tiranës dhe Durrësit gjatë 2018 dhe 2019. Trajnimin e vazhdueshëm për

								<p>gjyqtarët dhe prokurorët e Tiranës dhe Durrësit u zhvillua në Shkurt në bashkëpunim me SHM: masat e sigurimit dhe dënimet ndaj të miturve – praktika e unifikuar bazuar në çështje konkrete. Në këtë trajnim morën pjesë 12 gjyqtarë, 13 prokurorë dhe një këshilltar ligjor.</p> <p>Kurrikul e përgatitur në bashkëpunim me Akademinë e Policisë për Teknikat e Intervistimit Forensik.</p> <p>Një grup i përbërë nga gjashtë punonjës policie dhe psikologë janë identifikuar për t'u bërë trajnerë Brenda policisë për teknikat e intervistimit forensic. Është përgatitur Manuali për hetimin e veprave penale me të mitur i cili do të shpërndahet te punonjësit dhe drejtuesit e policisë. Është analizuar kurrikula e SHM për trajnimin fillestar dhe të vazhdueshëm për gjyqtarë dhe prokurorë – Diskutime me SM dhe UNICEF.</p>
2.2	Zhvillimi i programeve për menaxhimin e rasteve për të miturit nga sistemi i drejtësisë	2019 - 2021	MD, OJF/Donatorët	Hartimi i 1 (një) - 2 (dy) udhërrëfyesve/manualeve për profesionistët që mbulojnë të drejtat e fëmijëve në çështjet e drejtësisë	713,927.5	ALL 716,666	Realizuar	<p>UNICEF</p> <p>UNICEF (me fonde të MPJ të Norvegjisë), në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë, si dhe përfaqësuesit e institucioneve të zbatimit të ligjit, ato të drejtësisë dhe institucione të tjera të kujdesit dhe mbrojtjes ndaj fëmijëve në Berat dhe Gjirokastrë ka hartuar Udhërrëfyesin për ndërveprimin mes institucioneve dhe profesionisteve të disiplinave të ndryshme për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt a në kontakt me ligjin. Udhërrëfyesi është pajisur edhe me një kuadër logjik të thjeshtë që lehtëson përdorimin nga profesionistët e menaxhimit të rastit. Ai është pilotuar për rreth një vit e gjysmë në Berat dhe në Gjirokastrë dhe është plotësuar me reflektime që kanë dalë nga ky pilotim.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p>Ky objektivi është përbushur në vitin 2019 përmes hartimit të “Manualit për Intervistimin Motivues-IM” dhe “Udhëzuesit të përdoruesit për punën konjitive bihejviorale dhe Intervistimin Motivues” të aplikuar në shërbimin e burgjeve në Shqipëri.</p>

								<p>Terre des Hommes</p> <p>Ka përfunduar hartimi i “Protokollit të Punës për menaxhimin e Rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin”, dhe draft “Instrumenti i Monitorimit për zbatimin e Protokollit të Punës për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin”. Të dyja këto dokumenta janë dërguar pranë MSHPS-së për zyrtarizim.</p> <p>Programi Shqiptar-Suedez i Drejtësisë Penale për të Mitur</p> <p>Mjetet, instrumentet, modelet, manualat dhe procedurat që janë zhvilluar së bashku brenda programit suedez të drejtësisë për të mitur shqiptarë do të mbulojnë kërkesat në Kodin e Drejtësisë për të Mitur dhe do të përmbushin standardin e burgjeve evropiane dhe rregullat e provës në lidhje me menaxhimin e çështjeve të të miturve. Implementimi i produkteve është duke vazhduar dhe do të përfundojë kur të shpallet miratimi zyrtar nga agjencia përkatëse. Një instrument i vlerësimit të rrezikut të harmonizuar, me manual, që do të përdoret në burgje si dhe në provën e zhvilluar. 26 praktikues nga të dy agjencitë dhe MD janë trajnuar në instrument. Një model i menaxhimit të çështjeve përmes planeve individuale të trajtimit, me manual, që do të përdoret në burgje, si dhe prova e zhvilluar. 26 praktikues nga të dy agjencitë dhe MD janë trajnuar në instrumente. Katër aktivitete të qëndrueshme të mentorimit u mbështetën për mbështetjen individuale në zbatimin e vlerësimit të riskut dhe rehabilitimin e të miturve për 16 praktikues të zgjedhur. Një manual për Raportin e Vlerësimit Individual (IAR) është hartuar dhe shpërndarë në Shërbimin e Provës për aprovim dhe zbatim. Praktikuesit kanë marrë më parë trajnime në procedurat e IAR.</p>
<p>Objektivi Specifik 3: Shqyrtimi i drejtë dhe në kohë i çështjeve të drejtësisë për të miturit</p>								

3.1*	Krijimi dhe funksionimi i Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur	2018 - 2021	MD, MB, AKSHI, DPB, DPSHP, KLGJ/Gjykata, KLP/Prokurori, UNICEF	1. Ngritja e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur. 2. Zhvillimi i 1 (një) trajnimi për hedhjen e të dhënave në sistem. 3. Raport vjetor 1 (një) vjeçar mbi numrin e çështjeve të hedhura në sistem dhe ecurinë e tyre.	409,500		ALL 5,616,000.00	Proces	<p>Ministria e Drejtësisë Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e UNICEF, ka vënë në funksionim Sistemin e Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, i cili për herë të parë do të sigurojë unifikimin dhe kompjuterizimin e të dhënave për rastet e drejtësisë penale për të mitur në kohë reale, me qëllim krijimin e një baze statistikore, që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave shtetërore për fëmijët. Krijimi i Sistemit të Integruar ishte një detyrim ligjor që rrjedh nga neni 136 i Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, ku përcaktohet se: “Për mbajtjen e të dhënave të çështjeve penale që përfshijnë të miturit në konflikt me ligjin penal, të miturit viktime dhe dëshmitarë të veprave penale, krijohet “Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, Kodi, si edhe VKM nr.149, datë 20.03.2019, ngarkojnë Ministrinë e Drejtësisë për administrimin e të dhënave të këtij Sistemi. Sistemi i Integruar i të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur ka si qëllim mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave të drejtësisë penale për të mitur, nëpërmjet gjurmimit të të dhënave të ndjekjes penale e procedurave gjyqësore, si dhe përmirësimin e cilësisë së statistikave të harmonizuara, të gjeneruara nga institucionet e parashikuara në këtë vendim. Sistemi përmban të dhëna elektronike të përditësuara mbi çdo fazë të procedimit penal, përfshirë edhe ekzekutimin e vendimit penal për të miturit, subjekte të këtij Kodi, të dhëna të cilat mbahen në përputhje me rregullat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Sic u përforcua edhe në dispozitat e Kodit, konkretisht në nenin 136, Sistemi i mundëson Ministrisë së Drejtësisë dhe organeve të tjera publike të mbledhin të dhëna dhe të gjurmojnë rastet e të miturve në konflikt me ligjin si dhe të atyre që janë viktime apo dëshmitare të krimit, që nga casti kur hyjnë në zinxhirin e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë e deri kur dalin prej tij.</p> <p>UNICEF UNICEF (me fonde te MPI te Norvegjise) ka mbështetur Ministrinë e Drejtësisë për ngritjen e infrastruktures së Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur. Për</p>
------	---	-------------	--	---	---------	--	------------------	--------	---

								<p>këtë UNICEF, Ministria e Drejtësisë dhe AKSHI hartuan Termat e Referencës, specifikimet teknike dhe kostuan përshtatjen e prototipit dhe mirëmbajtjen e sistemit. U identifikua një zhvillues, Qendra për Vlerësim, Menaxhim dhe Trajnim, dhe u konsultuan përfaqësues nga të 6 institucionet e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë të cilat do të jenë përdoruesit e sistemit, deri në finalizimin e përmbajtjes së rubrikave sipas kërkesave të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe Strategjisë Kombëtare të Drejtësisë për të Mitur. Sistemi u hostua nga AKSHI dhe është tanimë i vendosur në adresën: www.drejtisipertemitur.gov.al. Gjatë 2021 UNICEF do të mbështesë me trajnimin e trajnerëve nga të 6 institucionet për përdorimin e këtij sistemi, si dhe do t'i asistojë këta të fundit në ofrimin e trajnimit për kolegët e tyre përdorues. Vënia në funksionim dhe popullimi i sistemit me të dhëna gjatë 2021 do të ofrojë për herë të parë të dhëna të hollësishme dhe të rakorduara mes institucioneve lidhur me drejtësinë penale për të mitur, si për fëmijet autorë, ashtu edhe ata dëshmitarë apo viktimë të veprave penale.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor Në kuadër të përgatitjes së raportit vjetor, për vetë sensitivitetin e çështjes, KLGJ kërkon nga gjykatat raportimin për dënimet alternative për çështjet penale me të mitur dhe këto të dhëna janë pjesë e raportit vjetor të KLGJ-së. Me rëndësi për t'u theksuar është fakti që menjëherë me marrjen në administrim nga KLGJ të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, në zbatim të Urdhërit të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 232, datë 4.11.2019 "Për ngritjen e Grupit të Punës, për kryerjen e një studimi, në lidhje me Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve në gjykata", u përpilua një raport i detajuar mbi zhvillimet e mundshme që mund të realizoheshin duke patur parasysh pamundësitë teknike që ka sistemi. Raporti i grupit të punës u përdor si bazë e përgatitjes së dokumentave standarte të tenderit dhe specifikimeve teknike, për kontratën me objekt "Zhvillim, modifikim, përmirësim dhe mirëmbajtje e sistemit të menaxhimit të çështjeve". Për vitin 2020, KLGJ në bashkëpunim më kompaninë fituese, ka bërë të mundur instalimin e versionit të përmirësuar të sistemit të menaxhimit</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	---

									<p>të çështjeve ICMIS, duke shtuar në këtë version 84 zhvillime të reja, disa nga të cilat shumë të rëndësishme për sistemin gjyqësor dhe punën në KLGJ.</p> <p>Ndër këto përditësime është edhe pasqyrimi i ndryshimeve të Kodit Penal për të Mitur. Funkcionalitetet shtesë janë zhvilluar në bazë të ndryshimeve të Kodit Penal dhe K.Pr.Penale në sistemin ICMIS:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Unifikimi i listës për tipet e çështjeve; - Unifikimi i listës për tipet e dispozitiveve; - Evidentimi i çështjeve me të mitur; <p>Këto ndryshime i shërbejnë përpos të tjerave gjenerimit të të dhënave statistikore.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë Për periudhën raportuese Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 149, datë 20.03.2019, ka parashikuar rregullat për krijimin dhe funksionimin të Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur.</p> <p>Institucioni përgjegjës për dhënien e të dhënave është Prokuroria e Përgjithshme, sipas pikës 11 gërma “b” e VKM 149 datë 20.03.2019.</p> <p>Këshilli i Lartë i Prokurorisë është pjesë e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, në rolin e subjektit të interesuar (neni 13 i VKM 149, datë 20.03.2019).</p> <p>Shërbimi I Provës Shërbimi i Provës ngriti grupin e punës mbi dhënien e kontributit për ngritjen e Sistemit. Grupi i Punës ka marrë pjesë në disa takime me ekspertët.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Përgjatë vitit 2020 kemi bashkëpunuar me ekspertë të kontraktuar nga UNICEF për hartimin e formularit të mbajtjes dhe aksesimit të të dhënave për të miturit në sistemin e burgjeve (të paraburgosur dhe të dënuar). Formulari ende nuk është finalizuar dhe hedhur në sistem.</p> <p>Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit Bazuar në ligjin Nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (kreu XV, neni 136 & 137) , VKM-së Nr. 149 datë 20.03.2019 “Për krijimin, organizimin, funksionimin, karakteristikat e përdorimit e aksesimit, të dhënat parësore e dytësore dhe dhënësin e Informacionit të Sistemit</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

									<p>të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur”, si dhe në zbatim të Vendimit Nr. 673 datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar si dhe në kuadër të projektit “Përmirësimi dhe mirëmbajtja e Sistemit të Integruar të të Dhënave të Drejtësisë Penale për të Mitur, u ngrit grupi i përbashkët i punës ndërmjet AKSHI dhe MD-së i cili hartoi Termat e Referencës/specifikimeve teknike me objekt “Përmirësimi i sistemit të integruar të të dhënave të drejtësisë penale për të mitur” gjatë periudhës Janar 2020. Këto terma ju dorëzuan nga ana e AKSHI-t MD-së, e cila më pas ja kaloi UNICEF në mënyrë që ata të procedonin me tej me realizimin e procedurës së prokurimit dhe kontraktimit të ekspertëve që do të bëjnë implementimet e kërkuara.</p> <p>Në këtë kuadër, gjatë muajit Dhjetor 2020 është kërkuar publikimi i domain-it drejtesipertemtur.gov.al, kërkesë e cila është realizuar.</p>
Objektivi Specifik 4:Përmirësimi i kuadrit ligjor që normon të drejtat e të miturve në sistemin e drejtësisë									
4.1	Plotësimi i kuadrit nënligjor në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit	2018	KM, MD, MASR, UNICEF	13 akte nënligjore të miratuara në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit	0			Realizuar	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Udhëzim i përbashkët ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit tëLartë Gjyqësor në muajin qershor 2020 lidhur me "Përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre". Mbetet e pritshme miratimi nga Këshilli i Ministrave edhe i projektvendimit:</p> <p>1. Projektvendimi “Ndryshime në aktet ligjore civile, penale dhe administrative sipas nevojës së identifikuar miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit, të funksionimit të shërbimit të specializuar, të programeve dhe mënyrës së financimit të tyre, për të miturit në konflikt me ligjin”.</p> <p>Ky projektvendim nuk është miratuar ende, për shkak të vakumit në ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, pasi në këtë të fundit nuk është e parashikuar mënyra e licencimit të personave juridikë që do të ofrojnë këtë shërbim. Megjithë përbushjen eventuale të detyrimeve që i përkasin Ministrisë së Drejtësisë konform rregullimeve ligjore, ekzistenca e vakumit ligjor në ligj e bën të paefektshtë dhe të pazbatueshëm projektvendimin në fjalë, nëse eventualisht do të miratohet nga Këshilli i</p>

								<p>Ministrave.</p> <p>MD ka vijuar komunikimin edhe përgjatë vitit 2020 me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke i kërkuar përfshirjen e ndryshimeve në ligjin nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në programin e përgjithshëm analitik të Këshillit të Ministrave për vitin 2021, ndryshime të cilat kushtëzojnë vijimin e procedurave ligjore për miratimin e këtij projektakti në përmbushje të detyrimit ligjor që buron nga dispozita autorizuese e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe implementimin me sukses të parashikimeve përkatëse pas hyrjes në fuqi, duke ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar kuadrin institucional, ligjor dhe infrastrukturor për ofrimin ndaj të miturve të shërbimeve të specializuara, sipas legjislationit në fuqi.</p> <p>UNICEF</p> <p>UNICEF ka realizuar publikimin e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, 500 kopje të të cilit u janë shpërndarë punonjësve dhe profesionistëve që trajtojnë çështje të drejtësisë për të mitur në rrethe të ndryshme të vendit.</p> <p>Terre Des Hommes</p> <p>Ka përfunduar protokollin e punës për CPU për trajtimin e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe pritet miratimi i tyre nga ASHMDF.</p>	
4.2	Ndryshime në aktet ligjore civile, penale dhe administrative sipas nevojës së identifikuar	2019- 2021	Kuvend, KM, MD	1. Hartimi i 2 (dy) studimeve/analizave për identifikimin e ndryshimeve në Kodin e Familjes dhe Kodin Penal; 2. Hartimi i 2 (dy) projektligjeve për ndryshime/shtesa në Kodin e Familjes.	520,060		Analizat janë kryer gjatë periudhës së mëparshme të raportimit, ndaj fondet për realizimin e tyre nuk i përkasin këtij viti.	Realizuar	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Në vijim të Urdhrit Nr. 75, datë 09.06.2020 të Kryeministrit “Për ngritjen e grupit ndërinstucional të punës për përmirësimin e sistemit të parandalimit dhe adresimit të dhunës ndaj të miturve”, Ministria e Drejtësisë ka ngritur dy grupe pune në muajin qershor, lidhur me:</p> <p>1. Analizën e problematikave të dhunës në familje”, si dhe</p> <p>2. Për përmirësimin e sistemit të parandalimit dhe adresimit të abuzimit seksual ndaj të miturve.</p> <p>Në muajin korrik 2020 është finalizuar analiza/studimi nga grupet e punës, ku është analizuar legjislationi në fuqi, bazuar dhe në rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë, si dhe hapat që do ndiqen në vijimësi të këtij procesi.</p>

								<p>UNICEF Ka realizuar dy analiza, një lidhur me mekanizmat ligjore dhe institucionale lidhur me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi, veçanërisht ai online, si dhe një tjetër lidhur me kuadrin ligjor që ndikon në institucionalizimin apo deinstitutionalizimin e fëmijëve. Këto analiza kanë informuar punën e Ministrisë së Drejtësisë si dhe të Komitetit të Birësimeve lidhur me disa propozime ligjore që ndikojnë në të drejtën e fëmijes për familje. Janë zhvilluar aktivitete sensibilizuese me Deputetët e Parlamentit të Shqipërisë dhe organizatat partnere për të rritur bazën advokuese për adresimin e fenomenit të martesave të fëmijëve, veçanërisht lidhur me rritjen e pritshme të këtij fenomeni gjatë pandemisë, si pasojë e mbylljes së shkollave për një periudhë të gjatë dhe vështirësive të shtuara ekonomike të grupeve më të rrezikuara.</p> <p>Kuvendi Gjatë vitit 2020, vijoi puna për realizimin e objektivave të parashkuara në <i>Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e punës së grupit të deputetëve “Miq të fëmijëve” për vitin 2019 dhe për planin e veprimit për vitin 2020</i>, ku GDMF vazhdoi të kontribuojë në përmirësimin e të drejtave të fëmijëve në kontekstin e ri të kufizimeve, nëpërmjet kontrollit të ushtruar mbi institucionet që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me zbatimin e të drejtave të fëmijëve. U miratuan gjithashtu, shtesa e ndryshime në disa akte ligjore, vijoi monitorimi i zbatimit të politikave të qeverisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe organizoi dëgjesa me të rinj dhe fëmijë në lidhje me të drejtat dhe nevojat e tyre.</p> <p>· GDMF kontribuoi në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve përmes miratimit të legjislationit kontrollit të qeverisë për zbatimin efektiv të masave për mbrojtjen e fëmijëve.</p> <p>· U angazhua duke organizuar dëgjesa me Institucionet si Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit, Avokati i Popullit, për të vlerësuar në këtë mënyrë ndikimin e pasojave të pandemisë dhe tërmetit të Nëntorit 2019 në situatën e fëmijëve dhe të familjeve të varfëra duke nxitur vijimin e pandërprerë të shërbimeve tek fëmijet lidhur me shëndetësinë, arsimin dhe mbrojtjen shoqërore.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

									<ul style="list-style-type: none"> · GDMF shqyrtoi ecurinë e mësimit online për nxënësit e nivelit parauniversitar dhe mbështetjen e nxënësve nga familjet në nevojë. · Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut zhvilluan një diskutim mbi ndryshimet në Kodin Penal për të adresuar dhunën me bazë gjinore dhe dhunën seksuale ndaj fëmijëve. · Gjatë vitit 2020, GDMF vijoi bashkëpunimin me institucione të administratës publike, institucionet e pavarura të të drejtave të njeriut, partnerë ndërkombëtarë, shoqërinë civile vendase dhe ndërkombëtare, botën akademike, median, grupet e fëmijëve dhe të rinjve, si dhe ekspertë apo grupe interesi në fushën e të drejtave të fëmijëve.
--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

Objektivi 3: Parandalimi i ri-përfshirjes të të miturve/të rinjve në krime

Nr.	Aktivitetet	Afati i realizimit	Institucioni përgjegjës	Indikatorët e zbatimit	Buxheti i parashikuar për vitin 2020	Buxheti i shpenzuar për realizimin e aktivitetit Janar-Dhjetor 2020		Statusi i aktivitetit për periudhën Janar-Dhjetor 2020 (E realizuar/në proces/parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën Janar-Dhjetor 2020
						Buxheti i Shtetit	Donatorë		
Indikatorët - ngritja e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve; - numri i fëmijëve të përfshirë në programet e parandalimit									
Objektivi Specifik 1: Parandalimi i kriminalitetit dhe të shkeljeve të ligjit									
1.1	¹² Krijimi dhe funksionimi i Qendrës për parandalimin e krimeve të të miturve dhe të rinjve	2019	MD, DAP, MFE, KM	Ngritja e Qendrës për Parandalimin e Krimeve të të miturve dhe të rinjve	4,156,632		ALL 660,000.00	Proces nga 2019	<p>Ministria e Drejtësisë Edhe përgjatë vitit 2020 ka vijuar komunikimi ndërmjet MD dhe DAP për shpalljen e vendeve vakante për Qendrën e Parandalimit të Krimeve për të Miturit dhe të Rinjtë, si dhe përshkrimet e punës sipas formatit të përcaktuar.</p> <p>Aktualisht, MD ka përfunduar dokumentacionin i cili normon funksionimin e brendshëm të këtij institucioni si dhe në bashkëpunim me DAP ka vijuar procedurat e rekrutimit të stafit të tij.</p> <p>Në dhjetor të vitit 2020, ka filluar shpallja e vendeve vakante në DAP për rekrutimin e stafit të qendrës. Në muajt në vijim pritet të vazhdojë procesi i rekrutimit të punonjësve të qendrës.</p> <p>UNICEF UNICEF (me fonde të MEPJ të Norvegjisë) ka</p>

mbështetur Ministrinë e Drejtësisë për hartimin e disa dokumentave bazë qëdo të orientojnë punën e Qendres për Parandalimin e Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve. Ato do të shërbejnë si themeli i ngritjes së këtij institucioni dhe realizimit të misionit të saj gjatë viteve të para të ekzistencës së tij. Aktualisht po vijon procesi i rekrutimit të punonjësve të kësaj Qendre.

Departamenti i Administratës Publike

Departamenti i Administratës Publike me anë të shkresës nr 2777/1 prot., datë 24.09.2020, shkresës nr. 2777/3 prot., datë 16.10.2020 ka miratuar përshkrimet e punës për 15 pozicione pune në strukturë të Qendrës Për Parandalimin e Krimeve për të Mitur dhe të Rinjte (QPKMR qendra e miratuar me urdher të Kryeministrit Nr. 115, datë 04.09.2019). Me miratimin e përshkrimeve të punës, Departamenti i Administratës Publike ka hartuar metodologjinë e klasifikimit për 15 pozicionet e punës të QPKMR në përputhje me VKM Nr.142 datë 12.3.2014, i ndryshuar. Deri në fund të Dhjetorit 2020, Dap ka shpallur në faqen zyrtare 13 pozicione pune sipas strukturës së QPKMR (3 përgjegjës sektori dhe 10 specialist).

Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale

Për periudhen raportuese Zyra e Komisionerit në kuadër të fushës së veprimtarisë së tij, përsa i përket aktiviteteve ndërgjegjësuere për çështje që lidhen me të miturit, Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale TIK “Hermann Gmeiner”, organizuan në muajin janar konkursin me temë “*Të rinjtë dhe privatësia*”. 10 grupe nxënësish të viteve të 3-ta dhe 4-ta të kësaj shkolle prezantuan projekt-aplikacione, ku “*politikat e privatësisë*” ishin elementi kryesor i vlerësimit nga ana e një jurie profesioniste. Për përgatitjen e këtyre punimeve Zyra e Komisionerit dhe stafi i shkollës realizuan një cikël trajnues gjatë muajit janar 2020, për njohjen me parimet kryesore të garantimit të privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

1.2	Vlerësimi i kriminalitetit të të miturve nën moshën e përgjegjësishë penale	2019 - 2021	MD/QPKMR, OJF/Projekte	Hartimi i 1 (një) raporti vjetor mbi kriminalitetin e të miturve nën moshën e përgjegjësishë penale dhe grupeve në risk	105,000			Parealizuar	Nuk ka zhvillime, pasi ky aktivitet është vendosur që do të ndiqet nga Qendra e Parandalimit të Krimeve për të Miturit/Rinjët në momentin që do të ngrihet.
1.3	Identifikimi i grupeve në risk të të miturve të moshës së përgjegjësishë penale	2019 - 2021			0			Parealizuar	Nuk ka zhvillime, pasi ky aktivitet është vendosur që do të ndiqet nga Qendra e Parandalimit të Krimeve për të Miturit/Rinjët në momentin që do të ngrihet.
1.4	Sigurimi i kuadrit infrastrukturor dhe institucional për zbatimin e programeve të parandalimit	2019 - 2021	MD/DPKMR, OJF/Projekte	Zbatimi i 2 (dy) programeve për veprimtari rehabilituese që lidhen: a) me mbështetjen pas lirimit dhe b) me mbikëqyrjen pas kryerjes së dënimit.	4,467,432			Realizuar	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Më parë MD ka miratuar draft programe rehabilituese, edukuese, integruese për trajtimin e të miturve 6 muaj para përfundimit të lirimit dhe ndjekja 6 muaj pas lirimit. Në momentin e ngritjes së QPKRM, Qendra do të vazhdojë me hartimin e programeve të tjera bashkekohore në bashkepunim me OJQ në vend për rehabilitimin e të rinjve dhe të miturve në shoqëri të cilët kanë qënë në konflikt me ligjin.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p>Për të miturit në sistemin e burgjeve zbatohen programet rehabilituese “Prezantimi i të menduarit” dhe “Aftësitë Sociale”. Në funksion të adresimit dhe referimit për ri-integrim të të miturit pas lirimit zbatohet “Protokolli i Mekanizmit të Sistemit të Referimit”, përmes të cilit çdo i mitur në prag lirim adresohet si rast pranë Zyrate të Mbrojtjes së Fëmijëve në Bashki.</p>

Objekti 4: Rishoqërimi, riintegrimi dhe rehabilitimi i të miturve në kontakt ose konflikt me ligjin

Nr.	Aktivitetet	Afati i realizimit	Institucioni përgjegjës	Indikatorët e zbatimit	Buxheti i parashikuar për vitin 2020	Buxheti i shpenzuar për realizimin e aktivitetit Janar-Dhjetor 2020		Statusi i aktivitetit për periudhën Janar-Dhjetor 2020 (E realizuar/në proces/parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën Janar-Dhjetor 2020
						Buxheti i Shtetit	Donatorë		
<p>Indikatorët - Numri fëmijëve dhe prindërve të përfshirë në programet e ri-integrimit; - Numri i fëmijëve të dënuar me burgim dhe me masa alternative;</p>									

Objektivi Specifik 1: Aplikimi i programeve të drejtësisë restauruese/ndërmjetësimit

1.1	Përmirësimi i kuadrit institucional për zbatimin e programeve të drejtësisë restauruese dhe të ndërmjetësimit	2018 - 2020	MD, DPSHP, ASHMDF, NJMF, DHKNd, Gjykata/KLGJ, Prokurori/KLP, OJF/Projekte	Zbatimi i 2 (dy) programeve për: i) drejtësinë restauruese dhe ii) ndërmjetësimin për të miturin dhe viktimën	407,520		Duke qenë pjesë e një ndërhyrjeje të integruar, fondet për këtë aktivitet janë paraqitur të grupuara një rresht më poshtë të Obj Strategjik 4, Obj. Specifik 2, Aktiviteti 2.1	Proces	<p>UNICEF</p> <p>UNICEF (me mbështetjen financiare të MPJ të Norvegjisë) dhe në partneritet me Save the Children ka mbështetur 97 fëmijë për realizimin e proceseve të ndërmjetësimit viktimë-dëshmitar në Berat dhe Gjirokastër. Ndërkaq 375 fëmijë të tjerë, kryesisht nxënës të shkollave të mesme dhe të ciklit të lartë të shkollave 9-vjecare në Berat dhe Gjirokastër kanë marrë pjesë në sesione informuese lidhur me drejtësinë restauruese si metodë për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Ky informim është një investim direkt me uljen e kriminalitetit ose të konflikteve të dhunshme.</p> <p>Pjesëmarrës në këto trajnime ishin profesionistë që marrin pjesë në proceset e drejtësisë penale për të mitur: përfaqësues të strukturave të mbrojtjes së fëmijës, punonjës të shërbimit të provës, oficerë të policisë, ndërmjetës, psikologë, prokurorë, dhe punonjës të qendrave sociale në bashki. Krahas kuadrit ligjor dhe praktikave për këto dy tema të ndërlidhura, pjesëmarrësve u janë vënë në dispozicion materiale burimore të përgatitura nga UNICEF përfshirë edhe Manualin mbi Drejtësinë Restauruese dhe Ndërmjetësimin për të Miturit në Kontakt me Ligjin, i cili trajton, ndër të tjera, bashkëpunimin midis Shërbimit të Provës dhe Shërbimit të Ndërmjetësimit.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor</p> <p>CSSP - Berlin Center for Integrative Mediation, në bashkëpunim të ngushtë me KLGJ (bazuar në Memorandumin e Bashkëpunimi të datës 20.01.2020) ka ngritur dy Qendra Ndërmjetësimi, në kuadër të projektit "Forcimi i Sistemit të Ndërmjetësimit në Shqipëri", financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme.</p> <p>Qendra e Ndërmjetësimit në Durrës është hapur në nëntor 2019. Gjatë vitit 2020, 1 çështje është referuar pranë Qendrës nga Gjykata dhe është zgjidhur me sukses. Asnjë rast i referuar nuk ka pasur të mitur të përfshirë. 3 workshope referimi (takime informuese për të shpjeguar mënyrën e referimit të çështjeve në ndërmjetësim) janë organizuar me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Prokurorinë e Durrësit.</p> <p>Qendra e Ndërmjetësimit në Tiranë është hapur në maj 2020. Dhe gjatë vitit 2020 janë vetë-referuar 2 raste në Qendër nga privatët dhe janë zgjidhur me</p>
-----	---	-------------	---	---	---------	--	--	--------	---

									<p>sukses. Asnjë rast i referuar nuk ka pasur të mitur të përfshirë.</p> <p>1 workshop referimi (takime informuese për të shpjeguar se si të referohen çështjet në ndërmjetësim) është organizuar me gjyqtarët e seksionit penal/për të mitur të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.</p> <p>Këshilli I Lartë I Prokurorisë Këshilli i Lartë i Prokurorisë nuk disponon të dhëna për zbatimin e programeve për drejtësinë resaturuese dhe ndërmjetësimin. Në lidhje me statistikat për zbatimin e këtyre programeve, në nenin 38 gërma “h” e ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se : “Prokurori i Përgjithshëm i dërgon Ministrisë së Drejtësisë të dhënat statistikore të ndjekjes penale, për hartimin e statistikës së njësuar në fushën e drejtësisë”.</p> <p>Shërbimi i Provës Shërbimi i Provës gjatë vitit 2020 ka trajtuar vetëm 1 të mitur ndaj të cilit është aplikuar masa e drejtësisë restauruese dhe ndërmjetësimi.</p> <p>Prokuroria e Përgjithshme Qendra (Zyra) e Zhvillimit për drejtësinë penale për të miturit në prokurori, në vijim të punës orientuese e unifikuese për gjithë prokuroritë dhe me mbështetje të programit të bashkëpunimit me Qeverinë e Mbretërisë së Suedisë, përmes Agjencisë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar, "Sida", po përgatit një manual udhëzues për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore për çështjet penale me të miturit në konflikt me ligjin si dhe modele të unfikuara aktesh proceduriale. Në këtë kuadër, është draftuar edhe një material informues për njohjen e të miturit me masën alternative të shmangies, material që është duke u diskutuar me ekspertët e projektit “Sida”.</p> <p>Të dhënat vjetore për të gjitha prokuroritë e shkallës së parë do t’ju vihen në dispozicion në fund të muajit janar pas përpunimit të tyre.</p> <p>Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës Bazuar në Ligjin Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) raportojnë pranë Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

									(ASHDMF) periodikisht të dhënat statistikore që kanë përpunuar për fëmijët në nevojë për mbrojtje në territorin e bashkisë dhe njësisë administrative përkatëse. Deri në shtator 2020 nga NJMF në bashki raportohet se <i>janë marrë në mbrojtje 38 raste</i> të fëmijëve në konflikt me ligjin. Të dhënat vjetore për 2020 janë duke u mbledhur dhe përpunuar.
Objektivi Specifik 2: Zhvillimi i planeve të këshillimit për të miturit dhe/ose familjen e tij									
2.1	Ngritja e kuadrit institucional për zbatimin e planeve të këshillimit për të miturit dhe familjen	2019 - 2021	MD, DPSHP, ASHDMF, NJMF, DPB, MASR, OJF/Projekte	1. Zbatimi i 1 (një) programi këshillimi për të miturit dhe familjen	2,400,000	ALL 8,595,833. 38	Proces	<p>UNICEF UNICEF (me mbështetjen financiare të MPJ të Norvegjisë) dhe në partneritet me Save the Children ka bërë 296 fëmijë të Beratit dhe Gjirokastrës, të cilët ishin në konflikt ose kontakt me ligjin, pjesë të një serie shërbimesh këshillimi dhe mbështetjeje në procesin e tyre të mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegritimit në komunitet. Kështu, 79 prej tyre kanë marrë këshillim dhe përfaqesim ligjor; 113 kanë marrë këshillim ose ndjekje terapeutike me psikolog. Nga një mentore me përvijë shumë prej këtyre fëmijëve janë riangazhuar në procesin mësimor ose janë orientuar drejt formimit profesional, punësimit apo hapjes së veprimtarive të vogla tregtare. Si rezultat, veç pjesëmarrjes së shumë prej këtyre fëmijëve në kurse publike të formimit profesional, bazuar mbi interesat e tyre specifike, 5 fëmijë janë mbështetur për kurse më të posaçme formimi profesional, 5 janë mbështetur për hapjen e një aktiviteti privat, si dhe 10 të tjerë për ndërmjetësimin me punëdhënësit dhe kryerjen e një stazhi të paguar pranë qendrave të punës. Pas përfundimit të stazhit, këta të rinj punojnë normalisht pranë këtyre punëdhënësve. Po në Berat dhe Gjirokastrë, UNICEF me Save the Children kanë realizuar programe prindërimi për 204 prindër dhe kujdestarë të fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin. Duke patur parasysh edhe sfidën e pandemisë gjatë 2020, këto programe kanë integruar edhe elementë të rëndësishme informacioni për prindërit që t'i ndihmonin ata për njëprindërim sa më efektiv edhe gjatë masave anti-COVID-19.</p> <p>Shërbimi i Provës Shërbimi i Provës gjatë vitit 2020 ka trajtuar tre të mitur ndaj të cilëve është aplikuar masa e këshillimit për të miturin dhe familjen.</p>	
Objektivi Specifik 3: Nxitja e aplikimit të masës alternative të shmangies nga ndjekja penale									

3.1	Ngritja e kuadrit infrastrukturor për zbatimin e masës së shmangies	2018 - 2021	MD, DPSHP, NJMF, OJF/Projekte	Funksionimi i 10 (dhjetë) ambienteve pranë qendrave komunitare për zbatimin e masës së shmangies.	3,500,000		Duke qenë pjesë e një ndërhyrjeje të integruar, fondet per këtë aktivitet janë paraqitur të grupuara një rresht më lart, të Objektivit Strategjik 4, Obj. Specifik 2, Aktiviteti 2.1	Realizuar	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Në kuadër të reformës së drejtësisë miqësore për të miturit, Ministria e Drejtësisë ka vijuar me procesin për nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me pushtetin vendor. Gjatë vitit 2020, konkretisht në muajin janar - 4 marrëveshje bashkëpunimi me Bashkinë Sarandë, Përmet, Mat dhe Lezhë. Në muajin qershor është nënshkruar marrëveshja me Bashkinë Belsh dhe Librazhd. Në muajin korrik është nënshkruar marrëveshja me Bashkinë Vau i Dejës, Himarë, Roskovec, Polican. Në muajin gusht është nënshkruar marrëveshja me Bashkinë Maliq, Klos. Në muajin shtator është nënshkruar marrëveshja me Bashkinë Shijak. Në muajin tetor është nënshkruar marrëveshja me Bashkinë Rogozhinë dhe Tepelenë. Pra, gjatë vitit 2020 janë nënshkruar gjithsej 15 marrëveshje. Ministria e Drejtësisë është duke vijuar e bashkërenduar punën edhe me bashkitë e tjera në vend, me qëllim nënshkrimin e marrëveshjeve edhe me këto bashki për trajtimin e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin, ndaj të cilëve është dhënë masa alternative e shmangies nga dënimi dhe ndjekja penale. Ministria e Drejtësisë.</p> <p>UNICEF</p> <p>Në bashkëpunim me Bashkinë Berat dhe Gjirokastrë, UNICEF dhe Save the Children identifikuan dy qendra komunitare të cilat të mund të përdroeshin edhe për të lehtësuar masën e shmangies për disa të mitur. Po ashtu, UNICEF advokoi vazhdimisht gjatë zbatimit të ndërhyrjes në Berat dhe Gjirokastrë që këto mjedise neutrale, jofrikësuese dhe jostigmatizuese të përdroeshin edhe si vendtakime mes fëmijëve në konflikt/kontakt me ligjin dhe profesionistët e ndryshëm që merreshin me menaxhimin e rasteve të tyre, nëvend që takimet të kryheshin në zyrat përkatëse të këtyre profesionisteve. Ndonëse, fillimisht, profesionistët e kundërshtonin këtë ide, dalëngadalë përgjatë zbatimit të ndërhyrjes, disa prej tyre, si: avokatët, ndërmjetësit, psikologët, punonjësit e sherbimit te proves, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, etj, nisën të mësoheshin dhe ta praktikonin këtë mënyrë. Nga kjo pikëpamje, mund të themi që në Berat dhe Gjirokastrë u dukën embrionet e para të konceptit të Barnahus-it, ndonëse për të patur një Barnahus të mirëfilltë (si njëone-stop-shop veçanërisht për fëmijët viktime</p>
-----	---	-------------	-------------------------------	---	-----------	--	--	-----------	--

									<p>tëkrimit), rruga vijon të mbetet e gjatë dhe kërkon përfshirjen e gjykatës, prokurorisë, policisë, mjekësisë, etj. Po ashtu, shpesh, të njëjtat qendra, u përdorën edhe si vendtakime për seancat e programeve të prindërimit, apo për mbledhjet e grupeve teknike ndërdisiplinore për trajtimin e rastit, duke u dhënë kështu jetë dhe domethënie praktike marrëveshjeve përkatëse mes Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkive Berat e Gjirokastër për trajtimin e fëmijëve nëkonflikt/kontakt me ligjin.</p> <p>Shërbimi i Provës</p> <p>Shërbimi i Provës ka qenë pjesë e zbatimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit mes MD dhe bashkive të cilat kanë qendra komunitare. Nga 9 të mitur me masa shmangie, SHP ka bashkëpunuar me qendrat sociale për trajtimin e 6 prej tyre sipas masave të dhëna nga prokuroria/gjykata. Gjithashtu, SHP ka marrë pjesë në GTN të ndryshme.</p>
Objektivi Specifik 4: Inkurajimi i aplikimit të masave alternative të dënimit									
4.1	Fuqizimi i mekanizmave dhe strukturave për zbatimin e masave alternative të dënimit	2018 - 2021	MD, DPSHP, Polici, OJF/Projekte	Numri i strukturave organizative/punonjësve të caktuar në shërbim prove që mbulojnë çështjet e të miturve.	30,071,901		Duke qenë pjesë e një ndërhyrjeje të integruar, fondet për këtë aktivitet janë paraqitur të grupuara dy rreshta me lart te Obj Strategjik 4, Obj. Specifik 2, Aktiviteti 2.1	Proces	<p>UNICEF</p> <p>Gjatë ndërhyrjes së UNICEF dhe Save the Children në Berat dhe Gjirokastër (fonde të MPJ të Norvegjisë), 6 punonjës të zyrave vendore të shërbimit të provës janë ndihmuar për ndjekjen e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin, qoftë gjatë masave të shmangies, qoftë gjatë zbatimit të dënimeve alternative.</p> <p>Shërbimi i Provës</p> <p>Shërbimi i Provës ka caktuar 25 punonjës të cilët trajtojnë çështjet e të miturve në konflikt me ligjin.</p>
Objektivi Specifik 5: Garantimi i një kuadri institucional që nxit dhe lehtëson edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e të miturve në institucionet e paraburgimit dhe burgimit									
5.1	Krijimi i kuadrit infrastrukturor për zbatimin e masave të kufizimit të lirisë	2019 - 2020	MD, DPB, OJF/Projekte	Pilotimi i 1 (një) qendre edukuese/rehabilituese për të miturit me kufizim lirie	4,500,000			Realizuar	<p>Ministria e Drejtësisë</p> <p>Krijimi i institucioneve të reja në zbatim të Kodit të Drejtësisë Penale për të Miturit, si kusht për plotësimin e infrastrukturës së nevojshme për të vënë në zbatim aktet nënligjore, masat alternative të dënimit si dhe riintegrimin e të miturve në shoqëri, është një nga hallkat më të rëndësishme për t'u realizuar. Për këtë qëllim, Ministria e Drejtësisë është</p>

									<p>angazhuar në ngritjen e institucioneve të reja si: Institucioni i Kufizimit të Lirisë do të funksionojë si një institucion gjysëm i hapur, ku të miturve do t'iu kufizohet liria e veprimit/lëvizjes në atë masë që parandalohet kryerja e veprave penale prej tyre dhe veçanërisht synohet riintegrimi dhe rishoqërimi i të miturit në komunitet. Lidhur me funksionimin e këtij institucioni MD ka përfunduar procedurat që lidhen me pjesën arkitekturore të projektit dhe vendit ku do të ngrihet ky institucion. Gjithashtu janë përfunduar draft dokumentacioni i brendshëm për vënien në funksion të këtij institucioni. Ngritja dhe funksionimi i këtij institucioni do t'i shërbejë trajtimit të të miturve në përputhje me standardet më të larta të mbrojtjes së të drejtave të tyre, duke synuar edukimin, rehabilitimin dhe ri integrimin e të miturve në konflikt me ligjin. Përsa i përket Institutit është ngritur grupi i punës i cili ka hartuar termat e references per zhvillimin dhe projekt dizenjimit e institutit.</p> <p>Gjatë 6 mujorit të parë të 2020, grupi i punës ka vijuar punën me hartimin e pjesës narrative të projektit, si dhe pjesën teknike arkitekturore në bashkëpunim me studion e arktiekteve dhe inxhinierëve. Projekti është paraqitur tek donatorët e huaj dhe pranë Ministrisë së Financave për mundësi financimi.</p> <p>Në vijim është mbyllur procedura e tenderimit dhe është shpallur fitues bashkimi i operatorëve “D& C Partners + Net Group” Shpk.</p> <p>Qëllimi i këtij institucioni është që të miturit në konflikt me ligjin, të trajtohen pa u izoluar përmes programeve të përshtatshme për edukimin, rehabilitimin dhe riintegrimin në komunitet dhe në shoqëri dhe shmangien e përfshirjes së rishit të tyre në rrugën e kriminalitetit dhe uljen e recidivizimit.</p>
5.2	Përmirësimi i praktikës në zbatimin masave të dënimit me burgim	2019 - 2021	MD, DPB, OJF/Projekte	Standardizimi i 3 (tre) formateve të planeve që hartojnë punonjësit e IEVP/paraburgimit.	2,607,328				<p>UNICEF UNICEF për periudhen raportuese në bashkëpunim me ‘Aleancën për Mbrojtjen e Fëmijës gjatë Veprimeve Humanitare’ kanë publikuar një Notë Teknike lidhur me situatën e fëmijëve të privuar nga liria gjatë emergjencës COVID-19. Nota është përkthyer në gjuhën shqipe dhe është ndarë me autoritetet në vend duke i shërbyer si udhërrëfyes për: 1.Vendosjen e një moratoriumi për hyrjet e reja të të miturve në mjediset të privimit të lirisë; 2.Lirimin e të gjithë atyre të miturve që mund të lirohen në siguri të plotë; dhe</p>

									<p>3.Mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies së gjithë atyre të miturve që iu duhet të mbeten në burgim.</p> <p>Në shkurt 2020, Zyra Rajonale e UNICEF-it organizoi në Sarajeve, Bosnje Hercegovinë Konferencën Rajonale për Qasjen e Fëmijëve në Drejtësi, ku Shqipëria u paraqit në mënyrë dinjitoze duke prezantuar rezultatet e reformimit të sistemit të drejtësisë drejt një sistemi më miqësor ndaj fëmijëve.Në parathënien e raportit të konferencës, vendi ynë ishte veçuar si një shembull pozitiv për lirin e shumë të miturve të privuar nga liria, gjatë periudhës së pandemisë, dhe kjo është vënë re si nga qeveritë donatore ashtu edhe qeveri të tjera mike të Shqipërisë që e kanë nënshkruar atë parathënie.</p> <p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Gjatë vitit 2019 me mbështetjen e projektit suedez “Rritja e kapaciteteve të institucioneve ligjzbatuese shqiptare dhe gjykatave për përmbushjen e standardeve të drejtësisë për të mitur- një qasje e integruar e zinxhirit të drejtësisë” janë standardizuar në përputhje me kërkesat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Formati i vlerësimit të riskut dhe nevojës sipas modelit RNR (risku-nevoja-reagimi). 2. Formati i Planit Individual të Trajtimit, mbështetur në rezultatet e RNR; 3. Formati i mekanizimit të referimit për ri-integrim. <p>Edhe gjatë vitit 2020 këto formate janë aplikuar për të gjithë të miturit në IM Kavajë (aktualisht 23 të mitur).</p> <p>Programi Shqiptar-Suedez i Drejtësisë Penale për të Mitur Një format i përbashkët për planin individual të trajtimit që do të përdoret në burgje dhe në mjediset e provës të zhvilluara. 26 praktikues u trajnuan, të ndjekur nga aktivitete mentorimi.formati i është dorëzuar agjencisë përkatëse për aprovim të brendshëm.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--	---

5.3	Përmirësimi i programeve që lidhen me arsimimin, formimin profesional, punësimin, sportin, argëtimin dhe programe të tjera	2018 - 2021	MD, DPB, MASR, MFE, OJF/Projekte	Zbatimi i 10 (dhjetë) i programeve/aktiviteteve në institucionet e sistemit penitenciar: - arsimimit; - formimit profesional; - punësimin; - menaxhimi i sjelljes e agresivitetit, përmes promovimit të aftësive pro-sociale; - zgjidhje e konflikteve dhe parandalimi i dhunës; - forcimit të mardhënieve me familjen; - program për parandalimin e bulizmit; - ndërhyrjes gjithëpërfshirëse të komunitetit; - rekreative dhe sportive; - eukuese, kulturore dhe fetare; - radikalizimit dhe terrorizmit.	4,800,000			Realizuar	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve</p> <p>Për të gjithë të miturit në IM Kavajë zbatohen:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Program Individual Trajtimi; 2. Program arsimor për arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm 3. Program i aftësimin profesional përmes kurseve profesionale dhe punësimin 4. Program i zhvillimit të aftësive pro-sociale dhe menaxhimit të agresivitetit 5. Program i prezantimi të të menduarit 6. Program i terapisë së artit dhe sportit 7. Programi i prindërimit në distancë për forcimin e lidhjeve me familjen 8. Program për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe parandalimin e dhunës 9. Programi You-Turn për krjimin e rrjeteve mbështetëse në komunitet, për të parandaluar recidivizmin e mundshëm 10. Program për parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm <p>Programi Shqiptar-Suedez i Drejtësisë Penale për të Mitur</p> <p>Zbatuar është prekur nga pandemia aktuale, por do të theksohet më tej gjatë 2021.</p> <p>Katër aktivitete të qëndrueshme të mentorimit për zbatimin e teknikave të rehabilitimit si në burg ashtu edhe në kushtet e provës të kryera për 16 praktikues të zgjedhur. Aktivitetet e mentorimit u bazuan në trajnime mbi 1) Agresivitetin dhe menaxhimin e sjelljes përmes promovimit të aftësive pro-sociale, 2) Zgjidhja e konflikteve dhe parandalimi i dhunës, 3) Forcimi i lidhjeve me familjen (të gjitha të dorëzuara në 2019)</p> <p>Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trajnime/seminare me tryeza të përbashkëta me aktorët përgjegjës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. • Hartimi i hartës sociale e shkollave me qëllim evidentimin e grupeve të rrezikuara. • Funksionimi i grupeve të punës përgjegjëse për monitorimin, identifikimin dhe referimin e rasteve.(Mësues, psikolog, prindër dhe antarë të qeverisë së nxënësve) • Njohja e nxënësve me drejtesinë për të mitur nëpërmjet orëve edukative.
-----	--	-------------	----------------------------------	--	-----------	--	--	-----------	--

									<ul style="list-style-type: none"> • Informimi i mësuesve mbi procedurat e raportimit dhe referimit të rasteve. • Nxitjen dhe promovimin e gjithëpërfshirjes në shkollë. • Njohjen me format e trafikimit (në bashkëpunim me komitetin antitrafik). • Gjithëpërfshirje dhe mosdiskriminim, kjo dhe në kuadër të projektit “Jemi dhe nëpërfshirja sociale për fëmijet romë dhe Egjyptian” që janë realizuar përmes një cikli trajnimesh me aktorë të ndryshëm pjesëmarrës në edukimin e fëmijeve. • NJSHP përmes workshop-ve ka realizuar takime me nxënës prindër dhe mësues ku është informuar rreth dhunës dhe formave të referimit të saj. • Funksionimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të shoqërisë civile për mbrojtjen e të drejtave të të miturve dhe krijimi i një klime mikpritëse dhe jo diskriminuese në shkollë. • Realizimi i një cikli trajnimesh me Bordin e shkollës mësues dhe NJSHP. “Per qasjen e Disiplines Pozitive”. • Takime informuese me perfaqësues të të gjitha institucioneve me qëllim dokumentimin dhe referimin e rasteve potenciale të shkeljes së të drejtave të të miturve. • Për “Fuqizimin e zbatimit efektiv të mekanizmit Kombëtar të referimit në nivel lokal”. • Bashkëpunimi mes shkollave dhe qendrave Komunitare Multifunkionale me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për të parandaluar fenomenin e dhunës kundër të miturve dhe grave në grupet vulnerablë përmes përfshirjes në aktivitetet artistike. <p>Janë realizuar aktivitete informuese me nxënës, për të rritur mirëqenien e tyre dhe parandalimin e problematikave të mundshme duke patur në fokus :</p> <ul style="list-style-type: none"> • Seminare informuese Komunikimin e shëndetshëm dhe menaxhimin e konflikteve mes bashkëmoshatarët • Seminare ndërgjegjësuese me Qeverinë e nxënësve “Ndërmjetësimi dhe zgjidhja e konflikteve që ndodhin në ambientet e shkollës dhe ato online”Si të japim
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

									<p>ndihmën një bashkëmoshatar i në nevojë.”</p> <ul style="list-style-type: none"> • Takime informuese me prindër për “Karakteristikat e zhvillimit në adoleshencë, vetvlerësimi dhe menaxhimi i agresivitetit” • Seminare ndërgjegjësuese me nxënës “Rolet gjinore. Pse ndodh dhuna me bazë gjinore” Si mund të parandalohet dhuna? • Seminare ndërgjegjësuese me nxënës, senatorë dhe me mësues “Bullizmi dhe efektet negative në adoleshencë.” “Elementët e bullizmit dhe viktimës, parandalimi i fenomenit ” • Takim informues me prindër të nxënësve me nevoja të vecanta “Diversiteti dhe toleranca”. • Seminare sensibilizuese “Komunikimi dhe marrëdhëniet me të tjerët gjatë adoleshencës”. • Seminare ndërgjegjësuese me nxënës “Trafikimi i qënieve njerëzore, kujdesi i madh në moshën e adoleshencës” • Seminare ndërgjegjësuese me nxënës “Bullizmi dhe efektet negative në adoleshencë.” • Seminare ndërgjegjësuese me nxënës “Komunikimi dhe konflikti”.
5.4	Përgatitja e materialeve informuese për të drejtat e të miturve në institucionet e sistemit penitenciar	2018 - 2021	MD, DPB, OJF/Projekte	Përgatitja e 2 (dy) formateve pamflete/dokumente informuese në vit për të miturin dhe prindin/të afërmin	156,000			Realizuar	<p>Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Janë përgatitur materiale informuese për miturit dhe prindërit e tyre mbi të drejtat dhe mundësitë që mund t’u ofrohen për rehabilitim dhe riintegrim të miturve.</p> <p>UNICEF Për periudhën raportuese ka mbështetur edhe Urdhrin e Psikologut, për të hartuar një seri prej 4 broshursh informuese për gjyqtarët dhe prokurorët, lidhur me rolin e psikologut në proceset penale, civile apo familjare në të cilat përfshihet i mituri. Këto broshura synojnë të lehtësojnë bashkëveprimin mes</p>

									magjistratëve dhe psikologëve dhe të krijojnë pritshmëri të qarta për punën e këtij profesionisti. Ato janë shpërndarë pranë çdo gjykate dhe prokurorie si dhe mund të gjenden në faqen Web: https://www.unicef.org/albania/sq/raporte/pies%C3%ABmarrja-e-psikologut-n%C3%AB-procese-t%C3%AB-drejt%C3%ABsis%C3%AB-p%C3%ABr-t%C3%AB-mitur
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

Objektivi 5: Forcimi i bashkëpunimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë për të mitur

Nr.	Aktivitetet	Afati i realizimit	Institucioni përgjegjës	Indikatorët e zbatimit	Buxheti i parashikuar për vitin 2020	Buxheti i shpenzuar për realizimin e aktivitetit Janar-Dhjetor 2020		Statusi i aktivitetit për periudhën Janar-Dhjetor 2020 (E realizuar/në proces/parealizuar)	Përshkrimi i arritjeve për periudhën Janar-Dhjetor 2020
						Buxheti Shtetit	Donatorët		
Indikatorët - Numri i institucioneve dhe përfaqësuesve të angazhuar në nivel qendror dhe vendor në çështjet e drejtësisë për të miturit									
Objektivi Specifik 1: Forcimi i bashkëpunimit ndërinstytucional									
1.1	¹³ Ngritja dhe funksionimi i rrjetit ndërinstytucional në nivel qendror për çështjet e drejtësisë për të miturit	2018 - 2021	MD, MB, MFE, MASR, MSHMS, ASHDMF, PP (prokuroria), KLGJ (gjykata), KDIMDHP, KMK, Avokati I Popullit, UP, UNICEF, OJF/Projekte	Krijimi i 1 (një) rrjeti funksional ndërinstytucional për çështjet e drejtësisë për të miturit	222,840			Realizuar	<p>Ministria e Drejtësisë Më datë 17.12.2020 është organizuar Konferenca “Fuqizimi i sistemit të drejtësisë miqësore për të miturit në Shqipëri”. MD ka hartuar një plan pune të përbashkët me OJF dhe donatorë të ndryshëm të cilët ofrojnë shërbime të specializuara dhe trajnime në fushën e drejtësisë penale për të mitur me qëllim mbulimin dhe rakordimin e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në këtë strategji.</p> <p>UNICEF Mbështetja e UNICEF-it për këtë komponent, është përmendur gjatë raportimit të mëparshëm vjetor.</p> <p>Këshilli i Lartë Gjyqësor KLGJ ka nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi me Administratën e Gjykatave Kombëtare në Suedi (projekt i financuar nga</p>

								<p>Agjencia Suedeze për Zhvillim Sida për mbështetjen e drejtësisë penale për të miturit në Shqipëri. Projekti shtrihet nën programin “Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese dhe gjykatave shqiptare për të përmbushur standardet ndërkombëtare të drejtave të njeriut lidhur me drejtësinë për të miturit-një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë”.</p> <p>Ky Memorandum është nënshkruar në muajin janar 2020 me qëllim krijimin e një rrjeti gjyqtarësh dhe rritjen e kapaciteteve për drejtësinë për të mitur. KLGJ mbetet e gatshme për bashkëpunime në krijimin e rrjetit funksional ndërinstitucional.</p> <p>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është Sektori i Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, në të cilin hartohen edhe politikat dhe programet për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.</p> <p>Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Zyra e Komisionerit ende nuk ka patur ndonjë komunikim nga institucioni lider përgjegjës për fillimin e këtij aktiviteti me qëllim bashkëpunimin për realizimin e tij. Megjithatë në kuadër të fushës së veprimtarisë së tij, përta i përket aktiviteteve ndërgjegjësuere për çështje që lidhen me të miturit, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim dhe koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, zhvilluan Fushatën Kombëtare “Luaj dhe mëso–Happy Onlife” që prej muajit tetor 2020 e në vijim. Përgjatë periudhës tetor-dhjetor 2020 u zhvilluan 22 takime në shkolla 9-vjeçare në 21 qytete të vendit. Pritet që faza e dytë e Fushatës të vijojë në 6-mujorin parë të vitit 2021, në funksion të masave shëndetësore për përballimin e pandemisë Covid-19. Fushata bazohet te loja Happy Onlife e ideuar dhe përgatitur nga Qendra Kërkimore Evropiane (JRC) e Komisionit Evropian. Kjo është një lojë interaktive, me karakter informative dhe ndërgjegjësuere për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale gjatë përdorimit të internetit dhe sidomos të rrjeteve sociale nga fëmijët dhe të rinjtë.</p>
--	--	--	--	--	--	--	--	--

									<p>SIDA Për peridhën raportuese, rezulton se është ngritur GP me përfaqësues nga Shërbimi i Provës, Gjykatat dhe Prokuroria i fokusuar në çështje me të mitur: formati i urdhër ekzekutimit, formati i kërkesës për RVI dhe formati i përmbajtjes/kapakut të fashikullit të prokurorisë për në gjykatë. Janë përgatitur disa drafte.</p>
1.2	Ngritja e komunitetit të praktikantëve në nivel vendor	2018 - 2021	Polici, Gjykata, Shërbim Prove, IEVP, NJMF, OJF/Projekte	Funksionimi i 10 (dhjetë) grupeve të komunitetit të praktikantëve në nivel vendor	956,640		ALL 716,666	Realizuar	<p>UNICEF (me mbështetjen financiare të MPJ te Norvegjisë) dhe në partneritet me Save the Children, ka mbështetur krijimin e dy grupeve të komunitetit të praktikantëve, përkatesisht në Berat dhe në Gjirokastrë, për t'u bërë bashkë për trajtimin e rasteve të fëmijeve në konflikt ose në kontakt me ligjin. Në mbështetje të kësaj praktike të punës ndër-sektoriale, ndër-institucionale dhe nder-disiplinore, UNICEF ka mbështetur trajnimet e përbashkëta të këtyre profesionistëve si dhe udhërrëfyesin, por edhe modele të Planit Individual të Trajtimit për fëmijet në konflikt/kontakt me ligjin, modele për shkëmbimin e informacioneve, si dhe modelin e një marrëveshjeje bashkëpunimi mes tyre. Para përfundimit të mbështetjes së UNICEF-it, institucionet e pranishme në Berat dhe Gjirokastrë nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi, e cila synon ta bëjë të qëndrueshëm këtë komunitet, qoftë në nivelin teknik, qoftë edhe në nivelin drejtues të titullarëve të 13 institucioneve dhe organizmave publike edhe më tej. Për përhapjen e mësimëve të nxjerra nga ky bashkëpunim në nivel vendor, Ministria e Drejtësisë, UNICEF, Save the Children dhe MPJ e Norvegjisë, Bashkitë dhe institucionet e tjera në Berat dhe Gjirokastrë organizuan në dhjetor 2020 një konferencë kombëtare dedikuar këtyre praktikave të mira bashkërendimi ndër-institucional. Konferenca u ndoq nga 100 pjesëmarrës.</p>